

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK  
ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ  
FACULTY OF LAW

**FAKULTETI JURIDIK  
STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**“VEPRA PENALE E DHUNIMIT NË RRETHIN E  
GJYKATËS SË APELIT NË GOSTIVAR NË PERIUDHËN  
KOHORE 2014-2018”**

**KANDIDATI :**

**Fjolla Ejupi**

**MENTORI:**

**Prof.Dr. Ismail Zejneli**

**Tetovë, shtator 2019**

## **DEKLARATË MBI ORGJINALITETIN E PUNIMIT**

Me anë të kësaj deklarate, unë Fjolla Ejupi, deklaroj se punimi i tezës së magistraturës është rezultat i punës sime origjinale dhe është bërë personalisht nga vetë unë.

Asnjë pjesë e këtij punimi nuk është marrë nga askush pa qenë e cituar sipas standardeve të pranuara.

Po ashtu, vërtetoj se ky punim apo pjesë e tij nuk janë botuar apo publikuar më parë në ndonjë aktivitet, qoftë nga unë apo dikush tjetër.

Ky material është ideuar dhe dizajnuar duke u bazuar nga burimet e cituara duke i shfrytëzuar dhe duke u bazuar në burimet e cekura në referenca dhe në literaturën e shënuar.

Gjithashtu e bëj të qartë se, në bazë të njohurive të mia, punimi im i magistraturës nuk cenon të drejtat e asnjë autorit, në asnjë rast. Dhe për të kundërt të saj, pranoj përgjegjësitë e mia të cilat do të më ngarkohen nga cilido komision apo organ që eventualisht do të shqyrtojë ndonjë rast ankese apo mosmarrëveshje lidhur me përmbajtjen e punimit, dhe në të njëjtën kohë pranoj të gjykohej në bazë të rregullores dhe statutit të Universitetit dhe ligjit mbi të drejtën e autorit.

## FALËNDERIM

### *Falënderimet i takojnë Krijuesit të qiejve e të tokës!*

Kam nderin dhe kënaqësinë, që me këtë rast të shpreh falënderimet e thella dhe të sinqerta për mentorin tim *Prof.Dr. Ismail Zejneli*, për përkrahjen dhe mbështetjen që më ka dhënë gjatë gjithë rrugëtimit tim, si në studimet deridiplomike po ashtu edhe në studimet e masterit, e veçanërisht gjatë ndihmës dhe sugjerimeve lidhur me punimin e tezës së masterit, që do t'i jem gjatë gjithë jetës mirënjohëse dhe falënderuese.

Falënderime të mëdha shpreh ndaj z. *Velko Strashevski*, gjykatës në Gjykatën e Apelit në Gostivar, për kontributin dhe ndihmën e dhënë me të cilat u bë i realizueshëm dhe u finalizua punimi im i masterit.

Gjithashtu, falënderimet e paskajshme për këshillat dhe sugjerimet e tezës sime të masterit ia kushtoj mikes sime më të mirë, *Doc.Dr. Liza Alili Sulejmani*.

Së fundi, meritat dhe falënderimet e mia të sinqerta, si dhe të gjitha arritjet e mia ua dedikojë prindërve të mijë fisnik, babait *Nazifit* dhe nënës *Mimoza*.

*E juaja, Fjolla!*

## PARATHËNIE

Tema e punimit të masterit është realizuar në bazë të metodologjisë hulumtuese-shkencore me karakter teorik dhe analizë empirike krahasuese. Qëllimi kryesor ishte që të trajtohen të gjitha aspektet e parapara deri në arritjen e mbrojtjes së tij para komisionit vlerësues. Këto objektiva janë të cekura në pjesën e hyrjes të këtij punimi, objektiva të cilat me plotë përgjegjësi mendoj që kam arritur t'i përmbush në shkallë të kënaqshme.

Gjatë hartimit të këtij punimi është shfrytëzuar një literaturë e mjaftueshme, duke përfshirë libra si burime të drejtpërdrejta, pastaj punime shkencore të ndryshme dhe të dhëna të grumbulluara nga institucionet zyrtare përkatëse në Republikën e Maqedonisë dhe të qytetit të Gostivarit. Punimi është ndarë në gjashtë kapituj duke përfshirë edhe hyrjen dhe përfundimin. Në kapitullin e parë është trajtuar pjesa hyrëse e punimit. Në kuadër të këtij kapitulli janë dhënë edhe sqarime në lidhje me lëndën e hulumtimit, qëllimet, pyetjet kërkimore, hipotezat dhe përshkrimin e metodologjisë hulumtuese. Në kapitullin e dytë shtjellohet vështrimi i përgjithshëm i veprës penale. Kapitulli i tretë i dedikohet veprës penale të dhunimit sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë, kurse kapitulli i katërt trajton veprat penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar për periudhën kohore 2014-2018. Kapitulli i pestë përfshin politikën ndëshkimore të veprave penale kundër integritetit seksual, kurse në kapitullin e fundit paraqitet pjesa e përfundimit dhe rekomandimeve të caktuara.

## **ABSTRAKT**

Dhunimi si një akt kriminal i ndërlikuar që në vete përfshinë përdorimin e forcës, kërcënimin apo premtimin, paraqet një dukuri me të cilën përballet çdo shoqëri dhe e cila ndikohet nga shumë faktorë shoqëror, ekonomik dhe kulturor. Edhe përkundër rëndësisë që në vete ngërthen një problematikë të tillë në suaza botërore, hulumtimet dëshmojnë nënvlerësimin e rasteve të këtij problemi të rëndësishëm.

Qëllimi kryesor i këtij punimi të magjistraturës është që të hulumtoj dukurinë e dhunimit si një fenomen që paraqet një krim tejet të rëndë nga aspekti i të drejtës penale dhe të njëjtën të trajtoj në një aspekt krahasues rajonal dhe si një dukuri bazuar në aspekt multidimensional me të cilën përballet gjithë shoqëria në aspekt global.

Për më tepër, ky punim do të analizojë rastet e dhunimit seksual në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar për periudhën kohore 2014–2018, me ç’rast do të analizohen dhe krahasohen verdiktet gjyqësore të Gjykatës së Apelit në territorin e Gostivarit.

**Fjalë kyçe:** dhunimi seksual, e drejta penale, analizë krahasuese, territori i Gostivarit.

## PËRMBAJTJA

Deklaratë mbi origjinalitetin e punimit .....	I
Falënderim .....	II
Parathënie .....	III
Abstrakt.....	IV
HYRJE .....	1
<b>Kapitulli i I-rë</b>	
<b>Vështrim i përgjithshëm i veprës penale të dhunimit .....</b>	<b>3</b>
1. Kuptimi i veprës penale të dhunimit .....	3
2. Teoritë lidhur me veprën penale të dhunimit .....	7
3. Aspekte krahasuese të veprës penale të dhunimit .....	14
3.1 Aspekte krahasuese me Republikën e Kosovës .....	20
3.2 Aspekte krahasuese me Republikën e Shqipërisë .....	23
<b>Kapitulli i II-të</b>	
<b>Nocioni, figura ligjore, objekti dhe subjekti i veprës penale të dhunimit .....</b>	<b>26</b>
1. Vepra penale e dhunimit sipas Legjislacionit të Republikës së Maqedonisë .....	26
2. Nocioni i veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë .....	28
3. Figura e veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë .....	31
4. Objekti i veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë .....	32
5. Subjekti i veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë .....	34
<b>Kapitulli i III-të</b>	
<b>Veprat penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar për periudhën kohore 2014-2018 .....</b>	<b>36</b>
1. Format e veprës penale të dhunimit .....	36
2. Kryerësit e veprave penale të dhunimit .....	45
a. Mosha e kryerësve të veprës penale të dhunimit .....	46

b. Gjinia e kryerësve të veprës penale të dhunimit .....	49
c. Përgatitja shkollore e kryerësve të veprës penale të dhunimit .....	51
d. Nacionaliteti i kryerësve të veprës penale të dhunimit .....	53
3. Karakteristikat e veprës penale të dhunimit .....	54
4. Mjetet që përdoren për kryerjen e veprës penale të dhunimit .....	56
5. Viktimat e veprave penale të dhunimit .....	58
<b>Kapitulli IV-të</b>	
<b>Politikat ndëshkimore të veprave penale kundër integritetit seksual .....</b>	<b>61</b>
1. Masat parandaluese të krimeve të dhunimit dhe roli i organeve të judikaturës .....	61
2. Roli i policisë në parandalimin e veprave penale të dhunimit .....	65
3. Roli i prokurorisë publike në parandalimin e veprave penale të dhunimit .....	71
4. Roli i gjykatave në parandalimin e veprave penale të dhunimit .....	76
5. Rëndësia preventive e ekzekutimit të sanksioneve penale .....	82
<b>Përfundim .....</b>	<b>85</b>
<b>Literatura .....</b>	<b>93</b>
<b>Shkurtesa .....</b>	<b>99</b>

## **HYRJE**

Kohëve të fundit dhunimi paraqitet si një fenomen mjaftë shqetësues dhe i shpeshtë në suaza botërore edhe si i tillë ka arritur të tërheq vëmendjen e shumë hulumtimeve të realizuara në këtë drejtim. Edhe pse dhunimi trajtohet si një fenomen që është analizuar dhe studiuar mjaftë, prapë se prapë e njëjta kërkon një trajtim të veçantë dhe të vazhdueshëm në aspekt global dhe rajonal.

Ekzistojnë një numër i madh faktorësh dhe shkaqesh të cilat ndikojnë në paraqitjen e dhunimit si fenomen, por thuajse është e pamundur të numërosh të gjitha shkaqet që ndikojnë në paraqitjen e dhunimit, pasi që edhe vet rasti nga rasti ndryshon si për nga karakteristikat e dhunuesit ashtu edhe për nga mënyra e kryerjes. Nga ana tjetër, është më se e rëndësishme të theksohet që baza konceptuale e Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë konsiston në idenë sipas së cilës ligji penal është instrument themelor i shtetit juridik në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut nga kufizimi i dhunshëm i tyre që mund të paraqitet në formë të kriminalitetit apo dhunës shtetërore.

Me zhvillimin dhe ndryshimet e shoqërisë ndryshohen edhe botëkuptimet lidhur me faktin se çka është e pranueshme e çka jo në sferën seksuale, përkatësisht çka është morale e çka jo. Botëkuptimet e këtilla ndikojnë edhe në ligjdhënësin për të përcaktuar se cilat vepra t'i penalizojë dhe cilat vepra t'i depenalizojë, të mos i konsiderojë vepra penale. Së këndejmi, ky lëmë është një ndër lëmenjtë më dinamike, më të ndryshueshëm në legjislacionet penale të shteteve. Për dallim nga nocioni i përgjithshëm i veprës penale si veprim i kundërligjshëm, i shtrembëruar dhe ndëshkues i paraparë në ligj, në realitet vepra penale paraqitet si vepër konkrete e vjedhjes, dhunimit, mashtrimit etj. Çdo vepër penale në vete i sublimon elementet e përgjithshme të veprës penale, por njëkohësisht që të dallohet si vepër e posaçme që është objekt i gjyqimit, ato elemente patjetër të marrin përmbajtje konkrete!

Duke pasur parasysh natyrën e këtij punimi, dhe rëndësinë e veprës penale si një vepër mjaftë e rëndë dhe nënçmuese, për të pasqyruar në formë më të detajuar dhe rrënjësore janë hulumtuar dhe analizuar të dhëna statistikore për periudhën kohore 2014-2018 në Gjykatën Themelore në Gostivar dhe në Gjykatën e Apelit në Gostivar, gjithashtu në mënyrë të veçantë analizohen vendimet gjyqësore, apo më mirë thënë dosjet apo lëndët që kanë arritur në Gjykatën e Apelit në Gostivar, me të gjitha shkresat për periudhën kohore 2014-2018. Nga ky hulumtim numri i



ankesave kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë rezultojnë kështu: **në vitin 2014**, janë paraqitur tre raste, **në vitin 2015**, janë paraqitur tre raste, **në vitin 2016**, janë paraqitur shtatë raste, **në vitin 2017**, janë paraqitur dy raste, dhe **në vitin 2018**, janë paraqitur pesë raste. Me më shumë raste të paraqitura rezultojnë viti 2016-(7) raste, më pas viti 2018-(5) raste, vitet 2014 dhe 2015 me nga (3) raste, dhe me më pak raste viti 2017 edhe atë (2) raste.

Për më tepër, i është kushtuar edhe një analizë në nivel republikan, që rezultojnë se: dyzet e nëntë (49) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor janë hasur në vitin 2014, ku pesëmbëdhjetë (15) raste kanë qenë të veprës penale të dhunimit, nga pesëdhjetë e gjashtë (56) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor në vitin 2015, njëzet e katërt (24) janë raste të veprës penale të dhunimit, në vitin 2016 tridhjetë e tetë (38) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, ku katërmëdhjetë (14) raste të veprës penale të dhunimit dhe në vitin 2017, janë kryer tridhjetë e tetë (38) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, ku tremëdhjetë (13) janë raste të veprës penale të dhunimit.

Për më tepër, me qëllim të analizimit dhe përmbushjes së objektivave kryesore të këtij punimi, i njëjti është strukturuar si në vijim: në kapitullin e parë është trajtuar pjesa hyrëse e punimit. Në kuadër të këtij kapitulli janë dhënë edhe sqarime në lidhje me lëndën e hulumtimit, qëllimet, pyetjet kërkimore, hipotezat dhe përshkrimin e metodologjisë hulumtuese. Në kapitullin e dytë shtjellohet vështrimi i përgjithshëm i veprës penale. Kapitulli i tretë i dedikohet veprës penale të dhunimit sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë, kurse kapitulli i katërt trajton veprat penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar për periudhën kohore 2014-2018. Kapitulli i pestë përfshin politikën ndëshkimore të veprave penale kundër integritetit seksual, kurse në kapitullin e fundit paraqitet pjesa e përfundimit dhe rekomandimeve të caktuara.

## KAPITULLI I PARË

### VËSHTRIM I PËRGJITHËSHËM I VEPRËS PENALE TË DHUNIMIT

#### 1. Kuptimi i veprës penale të dhunimit

Dhunimi, si një fenomen mjaftë shqetësues dhe i shpeshtë në mbarë botën paraqitet në qendër të vëmendjes së hulumtimeve të shumta të realizuara në këtë drejtim. Edhe përkundrejt faktit që e njëjta trajtohet si një fenomen mjaftë i analizuar dhe studiuar, prapë se prapë paraqet një çështje që ka nevojë për një trajtim të veçantë dhe të vazhdueshëm në aspekt global dhe rajonal.

Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta, asnjë qenie njerëzore nuk është e privilegjuar me më shumë ose më pak të drejta .

Përdhunimi nënkupton marrëdhënien seksuale pa pëlqimin dhe miratimin e femrës, me anë të dhunës fizike dhe psikike, kanosjes, torturës, premtimit të rrejshëm e një sërë veprimesh tjera çnjerëzore dhe poshtëruese.

Çdo akt dhe veprim seksual pa dëshirën e femrës cenon dhe shkel thellësisht lirinë gjinore dhe shkatërron denjësisht moralin e saj, secila femër ka të drejtë të pakufizuar të vendos personalisht dhe të zgjedhë vet për veten e saj partnerin me të cilin do të kryejë marrëdhënie seksuale.

Në të kaluarën përdhunimi konsiderohej si një e keqe kundrejt burrit, babait ose vëllait të viktimës. Ndaj përdhunimi mbron të drejtat e burrit për të siguruar një linjë legjitime familjare.

Rrënjët e dhunës seksuale datojnë qysh në kohërat e lashta, si pasojë e degradimit të femrës dhe mosbarazisë ndërmjet gjinive, duke mbivlerësuar gjininë mashkullore dhe nënçmuar gjininë femërore. Andaj këto marrëdhënie ia zgjasin jetën dhunës seksuale, e sidomos dhuna seksuale brenda familjes.

Dhuna seksuale, gjatë decenieve të fundit ka tejkaluar kufijtë e përkatësisë gjinore, sot si viktimë e dhunës seksuale mund të jenë gratë, burrat, djemtë dhe vajzat.

Rregullorja bashkëkohore penalo-juridike kufizohet në veprime të integritetit seksual, të cilat ndërmerren duke kundërshtuar vullnetin e tjetrit, apo veprime të cilat cenojnë integritetin seksual si pjesë përbërëse e integritetit personal dhe lirisë dhe të drejtës për të zgjedhur partnerin.

Mbrojtje penalo-juridike më specifike dhe më të fuqishme kemi atëherë kur veprimet e tilla godasin fëmijët, duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të fëmijëve dhe pasojat të cilat ndikojnë tek ata në zhvillimin normal, duke mos përfshirë vetëm atë seksual, por edhe në zhvillimin psikofizik.

Çështja e lirisë seksuale dhe e moralit në sferën seksuale janë të rregulluara dhe mbrohen me katër lloje të normave: me normat e së drejtës zakonore, me norma morale, me normat juridike të shtetit dhe me norma ndërkombëtare.

Gjithashtu, të drejtat e njeriut janë të mbrojtura edhe ndërkombëtarisht duke përfshirë një sërë konventash të ndryshme, me ç'rast si pasojë e këtyre konventave kanë pësuar ndryshime edhe legjislacionet nacionale.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut<sup>1</sup> proklamon, neni 1 Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave. Ato janë të pajisura me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë njëra ndaj tjetrës në një frymë vëllazërie. Neni 2 i Deklaratës, ndalon në çdo mënyrë diskriminimin apo mosnjohjen e të drejtave në bazë të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik ose çdo opinionit tjetër të personit.

***“Gruaja lind e lirë dhe gëzon të drejta të barabarta me mashkullin në çdo aspekt.”***<sup>2</sup> Deklarata për të Drejtat e Gruas dhe Qytetares Femër, mbron fuqishëm dhe zëshëm të drejtat e gruas dhe femrës në përgjithësi, gjë që nuk lejon hapësirë për asnjë lloj diskriminimi apo përbuzje dhe nënçmimi të gjinisë femërore.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 9, garanton liritë dhe të drejtat e njeriut dhe ndalon diskriminimin pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pasurore dhe shoqërore. Ndërkaq në nenin 25 çdo qytetari i garanton respektimin dhe mbrojtjen e privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, dinjitetin dhe autoritetin.

---

<sup>1</sup> Deklarata universale e të drejtave të njeriut , e aprovuar nga Ansambleja e Përgjithëshme e OKB'së , dhjetorë 1948

<sup>2</sup> Deklarata për të Drejtat e Gruas dhe Qytetares Femër, 1798.

Andaj Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, rregullon në mënyrë të hollësishme konceptet bashkëkohore lidhur me të drejtën e njeriut që të vendos lirisht për jetën e tij seksuale, edhe atë kjo është paraparë në Kreun XIX: “Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor“. Veprat të cilat parashihen në këtë kapitull për objekt mbrojtës kanë lirinë e personit në marrëdhëniet gjinore. Veprat penale të cilat i përmban ky kapitull janë: Dhunimi neni 186; Kryerja e aktit seksual me person të paafte (të pafuqishëm) neni 187; Sulmi seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet neni 188; Kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës neni 189; Kënaqja e epsheve seksuale para tjetërkujt neni 190; Ndërmjetësimi në kryerje të prostitucionit neni 191; Pornografia fëmijërore neni 192-a; Ekspozimi i materialit pornografik fëmijës neni 193; Prodhimi dhe distribuimi i pornografisë fëmijërore neni 193-a; Joshja në akt seksual apo në veprim tjetër seksual e fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet neni 193-b; Incesti neni 194; Shpallja e aktgjykimit gjyqësor neni 194-a.<sup>3</sup>

Më poshtë në mënyrë të përgjithshme do të trajtohet kuptimi i veprës penale të dhunimit në aspekt ligjor.

Marrëdhënia seksuale është ajo marrëdhënie e cila kryhet me dëshirën dhe me vullnetin e të dy partnerëve, në momentin që e njëjta ndodh pa dëshirën e njërit partner kemi të bëjmë me dhunim/përdhunim. Dhunimi seksual nënkupton kryerjen e marrëdhënies seksuale pa dëshirën, pëlqimin dhe vullnetin e njërit partner me ç’rast cenon dhe shkel dinjitetin dhe integritetin seksual të partnerit.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë<sup>4</sup> ka inkriminuar dhe sanksionuar një numër të madh të veprimeve dhe sjelljeve në këtë sferë, të cilat dëmtojnë lirinë e vendosjes në rrafshin e marrëdhënies seksuale. Dhunimi neni 186 paragrafi 1 i KPRM-së<sup>5</sup> Ai i cili tjetrit me përdorim të forcës ose kërcënimit se drejtpërdrejtë do të atakojë ndaj jetës apo trupit të tij, ose ndaj jetës dhe trupit të ndonjë të afërmi të tij, do ta detyrojë në kryerje të aktit seksual do të dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

---

<sup>3</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.142, datë 13.11.2012. , Kreu XIX- “Veprat Penale Kundër Lirisë Gjinore dhe Moralit Gjinor”.

<sup>4</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.142, datë 13.11.2012. , Kreu XIX- “Veprat Penale Kundër Lirisë Gjinore dhe Moralit Gjinor”.

<sup>5</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.142, datë 13.11.2012. , Kreu XIX- “Veprat Penale Kundër Lirisë Gjinore dhe Moralit Gjinor”.

Ligjvënësi si rrethana rënduese të cilat e ashpërsojnë dënimin ka paraparë një sërë veprimesh, edhe atë: nëse vepra është kryer ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet kryerësi do të dënohet me së paku me dhjetë (10) vjet burgim; nëse si pasojë e veprës nga paragrafi 1 (Dhunimi neni 186) është paraqitur lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja tjera të rënda, ose vepra është kryer nga ana e më shumë personave ose në mënyrë të vrazhdë apo të përbuzur kryerësi do të dënohet me së paku katër (4) vjet burgim; nëse me kryerjen e aktit seksual tjetërkënd do ta detyrojë me kërcënim serioz se për të apo për ndonjë të afërm të tij do të zbulojë diçka çka do ta kishte dëmtuar nderin dhe autoritetin e tij apo se do të shkaktojë ndonjë të keqe tjetër të rëndë, do të dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet; nëse dikush kryen akt seksual duke keqpërdorur sëmundjen shpirtërore, çrregullimin shpirtëror, pafuqinë, zhvillimin e ngecur shpirtëror apo ndonjë gjendje tjetër për të cilën ai person është i paaftë për rezistencë, do të dënohet me së paku tetë (8) vjet burgim; nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 (Kryerja e aktit seksual me person të paaftë (të pafuqishëm) neni 187) shkaktohet lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasojë tjetër e rëndë ose vepra është kryer nga më shumë persona, në mënyrë posaçërisht të vrazhdë apo nënçmuese, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm; ai i cili do të kryejë akt seksual apo veprim tjetër seksual ndaj fëmijës që nuk i ka mbushur 14 vjet do të dënohet me së paku dymbëdhjetë (12) vjet burgim; nëse si pasojë e veprës penale nga paragrafi 1 dhe 2 (Sulmi seksual ndaj fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet neni 188) shkaktohet lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasojë tjetër e rëndë ose vepra është kryer nga më shumë persona, në mënyrë posaçërisht të vrazhdë apo nënçmuese, kryerësi do të dënohet me së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim apo me burgim të përjetshëm; nëse akti seksual kryhet nga i afërmi nga gjaku në vijë të parë ose vëlla, përkatësisht motër, arsimtar, edukues, adoptues, tutor, njerë, njerë, mjek apo person tjetër me keqpërdorim të pozitës së tij ose gjatë kryerjes së dhunës familjare do të kryej akt seksual ose veprim tjetër seksual me fëmijë i cili ka mbushur 14 vjet, i cili i është besuar për shkak të mësimit, edukimit, ruajtjes apo kujdesit, do të dënohet me së paku dhjetë (10) vjet burgim; ai i cili furnizon pornografi fëmijërore për vete apo për tjetër kë, apo posedon pornografi fëmijërore, do të dënohet me dënim me burgim prej pesë (5) deri në tetë (8) vjet.

Nga këto dispozita ligjore, mund të përfundoj se Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë apo legjisllacioni ynë penal i kushton vëmendje të veçantë veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, me këtë mbron liritë dhe të drejta e njeriut dhe qytetarit duke paraparë vepra

penale të një numri të madh që mbrojnë sferën e jetës seksuale. Nga kjo mund të konkludojmë se sanksionet për këto vepra penale janë të duhura si për nga pragu minimal ashtu edhe për nga kufiri maksimal. Ajo që ngelet për t'u diskutuar është paragrafi i tretë (3) i nenit 186, ku thuhet: nëse është paraqitur lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja tjera të rënda, ose vepra është kryer nga ana e më shumë personave ose në mënyrë të vrazhdë apo të përbuzur kryerësi do të dënohet me së paku katër (4) vjet burgim, është e paqartë në këtë pjesë se deri në sa lartësi mund të arrihet dënimi për kryerësin. Por, ky rast është lënë në duar të gjykatës që të vendos veçanërisht për çdo rast duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si dhe kushtet tjera që duhet marrë parasysh gjatë shqiptimit të dënimit.

Në hetimin e krimeve seksuale, duke ndjekur një radhë të caktuar, kryhen këto veprime hetimore: pyetja e së dëmtuarës, këqyrja e vendit të ngjarjes; ekspertimi mjekoligjor dhe psikiatrik ligjor i së dëmtuarës, pyetja e dëshmitarëve, ekzaminimi mjekoligjor i personit të dyshuar, pyetja e personit të dyshuar (të pandehurit)<sup>6</sup>. Pra për të arritur deri në zbulimin e plotë dhe zbardhjen e rastit konkret duhet marrë një sërë veprimesh procedural të parapara me ligj, përcaktimin e saktë të figurës ligjore dhe së fundi marrjen e një verdikti gjyqësor .

## **2. Teoritë lidhur me veprën penale të dhunimit**

Ekzistojnë një numër i madh faktorësh dhe shkaqesh të cilat ndikojnë në paraqitjen e dhunimit si fenomen, por thuhet se është e pamundur të numërosh të gjitha shkaqet që ndikojnë në paraqitjen e dhunimit, pasi që edhe vet rasti nga rasti ndryshon si për nga karakteristikat e dhunuesit ashtu edhe për nga mënyra e kryerjes. Studimet krimologjike si dhe autorë të ndryshëm janë munduar të zbulojnë dhe të nxjerrin në pah disa nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë dhe nxisin aktin e dhunimit, cilësitë personale të dhunuesve dhe të viktimave. Është gati se e pamundur të përcaktosh një dhunues tipik, çdo dhunues thuhet se ka modelin unik të tij gjë që vështirëson parandalimin dhe përcaktimin e shenjave standarde që posedon një dhunues tipik.

Çdo dhunues ndryshon nga tjetri dhe nuk kanë veti të njëjta, por mund të përshkruajmë disa nga to, disa dhunues përdorin forcën fizike, disa prej tyre dhunojnë vetëm në rrethana të

---

<sup>6</sup> Latifi, Vesel, Kriminalistika, Prishtinë, 2014, fq. 436.

caktuara, disa dhunime kryhen vetëm nga një kriminel, ndërkaq në disa dhunime marrin pjesë më shumë persona. Deri më tash janë vërejtur disa shenja të përgjithshme tek kryerësit (dhunuesit) së pari, këta persona vuajnë nga kompleksi për tu dalluar nga të tjerët duke shprehur dëshirën për dominim dhe pushtet me anë të kërcënimit dhe detyrimit dhe së dyti mungesë respekti ndaj femrës duke mos e llogaritur si qenie njerëzore, por në sy të tyre femra është e barabartë me një skllave.

Është e ditur se familja luan rol kryesor në pikëpamje të edukimit dhe paraqitjes për jetë të njeriut që nga lindja – duke filluar nga fëmijëria e hershme e tij në aftësimin e personalitetit ndaj kriminalitetit. Fiton përvojat e veta të para jetësore dhe parafytyrimet për jetën, pikëpamjet e veta, normat morale si formë e vetëdijes shoqërore të personalitetit, por edhe si vlerë e përhershme, shprehitë dhe prirjet të cilat ndikojnë në sjelljet e tij të mëvonshme. Familja, ajo e para i jep vulën e vet të personalitetit në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit. Mirëpo, roli familjar, përveç ndikimeve pozitive, mund ta luajnë edhe ndikimet negative ndaj kriminalitetit te ato familje, të cilat nuk realizojnë edukim pozitiv pa bazat e nevojshme të edukimit moral, në të cilët jeta e prindërve dhe atmosfera familjare në përgjithësi mund të shërbejë vetëm si shembull negativ me sjellje antishoqërore dhe të prirur me sjellje kriminale sidomos te ato familje me kushte të vështira materiale, alkoolizmi, prostitucioni, grindjet dhe zënka familjare e mospajtimi, braktisja, aventurizmit që veprojnë pa parime, familje që kryejnë veprime të papeshuara, të rrezikshme e të pandershme për rrethin shoqëror me aktivitete kriminale dhe dukuritë e ngjashme të patologjisë shoqërore familjare dhe si të tilla ato familje janë edhe të degraduara ose të shkatërruara me prirje dhe sjellje kriminale.

Fëmijët të cilët rriten në një mjedis të tillë familjarë, janë dëshmitarë të ushtrimit të dhunës familjare e sidomos dhunës ndaj nënës së tyre ose dhunës që ushtrohet ndaj gjinisë femërore në të shumtën e rasteve paraqiten si dhunues, për arsye se për ta dhuna është një veprim shumë normal të cilin e ka trashëguar si model nga prindërit dhe anëtarët e familjes.

Sipas autorit Siegel, sjellja njerëzore e cila mund të jetë kriminale (e papranueshme), apo konform (e pranueshme) varet nga mundësitë e tij që të mësojë dhe të arrijë qëllimet të cilat janë rezultat i veprimit të dy grupeve të mëdha faktorësh. Grupi i parë i faktorëve përfshin vetitë personale të njeriut, e të cilat çdo person e bëjnë unikat e që kanë të bëjnë me strukturën biokimike, kodin gjenetik dhe gjendjen neurologjike dhe i cili krijon personin e brendshëm që

kërkon veprime të caktuara njerëzore. Në anën tjetër në sjelljen e njeriut në veprimin e vetive personale dukshëm ndikon edhe grupi i faktorëve të rrethit social ndër të cilët rolin themelues e luan ndikimi i prindit, grupet e vogla shoqërore, shkolla dhe rrethi.<sup>7</sup>

Të qënurit dëshmitar i dhunës nuk është e vetmja mënyrë që mësojnë fëmijët, ata shpesh vet janë ballafaquar me dhunë dhe e kanë përjetuar të njëjtën.

Dhunuesi nëpërmjet dhunimit kënaq nevojat e tij/saj, vetë akti i dhunës i krijon kënaqësi për të vetmen arsye se ai/ajo është në pozitën e viktimës në të njëjtën kohë.

Legjislacioni penal i Republikës së Maqedonisë mbron fuqishëm lirinë gjinore (seksuale) dhe dënon ashpër dhunimin dhe krimet tjera seksuale, të përfshira në KPM, kreu XIX, “Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor”.

TEORIA E DIZAJNIT TË MJEDISIT<sup>8</sup> në esencë në suazat e klasifikimit mund të renditet në teori, d.m.th në kriminologjinë e mjedisit. Arsyeja pse kjo teori ka marrë trajtim të veçantë qëndron në specifikën e saj, nga njëra anë, dhe në përdorimin e saj në praktikën e deritanishme preventive, nga ana tjetër. Përveç kësaj, teoria e dizajnit në aspektin sinkronik i paraprinte kriminologjisë së mjedisit dhe teorive situacionale, dhe në vështrimin epistemologjik mund të pranohet fakti se pikërisht kjo qasje përbën esencën e teorive që janë zhvilluar prej saj.

Teoria e dizajnit është inspiruar me konstatimet e *Shkollës së Çikagos* që vënin në dukje se ekziston një lidhje e caktuar midis zonave përkatëse urbane dhe shkallës së kriminalitetit. Në këtë gjurmë teoricienët e dizajnit të mjedisit kanë vazhduar me hulumtimet dhe kanë vënë në dukje faktin që midis dizajnit të caktuar fizik të mjedisit dhe të kriminalitetit ekziston lidhja. Kjo e dhënë ishte arsye e mjaftueshme që teoricienët e dizajnit të argumentojnë se si shkaqet themelore të kriminalitetit janë karakteristikat fizike të asaj pjese të hapësirës urbane ku paraqitet kriminaliteti. Prandaj, vetë ideja e veprimit preventiv në esencë është e thjeshtë dhe kufizohet në konstatimin se është e domosdoshme të ndryshohet dizajni fizik në ato pjesë të qytetit në të cilat

---

<sup>7</sup> Siegel, J.L., “Criminology Thomson Learning”, Belmont (USA), 2006, p. 136-139, sipas Sabani, Alisabri, Budimilic, Muhamed, Kriminologjia, (Përktheu nga kroatishtja: Mustafë Reçica), Sarajevë, Prishtinë, 2007, fq. 68.

<sup>8</sup> Muratbegović, Elmedin, Parandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë, Prishtinë, prill 2007, fq 41.



është përgjegjëse për shkallën e lartë të kriminalitetit. Nga ky qëndrim fillestar mund të shihet se teoria e dizajnit në praktikën preventive aplikon risi të shumta. Ajo teori nuk interesohet për kryerësin dhe sjelljen e tij, as për sjelljen e viktimës. Kryerësi dhe viktimë kushtëzohen me vetë hapësirën fizike në të cilën marrin statusin e kryerësit përkatësisht të viktimës. Me këtë në konceptonet që i kemi dhënë në fillim të këtij teksti, fokusin e teorisë së dizajnit e paraqet pikërisht vetë mjedisi në të cilin ndodhë veprimi kriminal. Risia tjetër që mund të kualifikohet si revolucionare, e të cilën e ka aprovuar kjo teori, është apelimi që me anë të dizajnit fizik të vetë vendbanimit të mundësohet që opinioni të kontrollojë dhe t'i mbikëqyrë aktivitetet kriminale. Në këtë mënyrë në strategjitë preventive për herë të parë në kriminologji inkuadrohet edhe opinioni, e jo vetëm shërbimet kompetente shtetërore.

Idea kryesore e veprimit preventiv ndaj kriminalitetit në këtë teori përbëhet prej katër modusesh:

- Mjedisi fizik mund të veprojë në mënyrë preventive ndaj delinkuentëve, ashtu që do t'iu zvogëlojë mundësinë për kryerjen e veprës kriminale me vendosjen e barrierave të caktuara që kryerësit do t'ia vështirësojë realizimin e qëllimit.
- Mjedisi fizik mund ta pengojë delinkuentin ashtu që do t'ia marrë mundësinë e ikjes së sigurt marshutave të sigurta.
- Mjedisi fizik mund të shtojë probabilitetin që delinkuenti të vërehet gjatë kryerjes së veprimit kriminal ose gjatë ikjes.
- Mjedisi fizik mund të përmirësojë karakterin social të mjedisit ashtu që do të veprojë në mënyrë stimulative në interaksionin social dhe bashkimin e qytetarëve në një zonë të caktuar me qëllim të kontrollit më efikas të kriminalitetit.

Është e qartë se çelësi për të kuptuar teorinë e dizajnit është pikërisht të kuptuarit specifik të hapësirës. Kështu në radhët e teoricienëve të dizajnit mund t'i gjejmë disa nocione të hapësirës që shfrytëzohen me domethënie të ndryshme. Ato janë:

- hapësira publike, d.m.th hapësira që është e arritshme për të gjithë dhe shërben për përdorim të ndryshëm,
- hapësira gjysmë publike, d.m.th. hapësira që është e paraparë për të gjithë, por e shfrytëzojnë një numër i kufizuar njerëzish (p.sh. ndërtesa),

- hapësira gjysmë private, d.m.th. hapësira që është restriktive, d.m.th. parashihet për një numër të madh njerëzish, e të cilën nuk mund ta shfrytëzojnë njerëzit e rëndomtë (p.sh. apartamentet në ndërtesa të veçanta),
- hapësira private, d.m.th. hapësira që është paraparë vetëm për shfrytëzues të caktuar (p.sh. banesa).

Oskar Njuman zhvillon një qasje të veçantë në premisat që i përshkruan, e që quhet “hapësira e mbrojtur”. Koncepti i hapësirës së mbrojtur mbështetet në kritikën e dizajnit modern urbanistik i cili sipas mendimit të O.Njuman, është fajtor kryesor për shkallën e lartë të kriminalitetit në disa zona urbane. Hapësira e mbrojtur përfaqëson qëndrimin që dizajni hapësinor duhet të ketë aso pamje që do të mundësojë mbikëqyrjen më të lehtë të veprimeve kriminale, dhe në këtë mënyrë të ndikojë qenësishëm në zvogëlimin e kriminalitetit. Kjo është hapësirë që “vetë mbrohet”, dhe që për nga pamja e vet vepron në mënyrë mjaft destimulative ndaj delinkuentit dhe qëllimit të tij. Hapësira e mbrojtur duhet ti posedojë katër karakteristika themelore: - Definicionin territorial të hapësirës, - Realizimin e mbikëqyrjes më të madhe të mundshme natyrore, - Dizajni i vendbanimit banesor që nuk është i ngjeshur, dhe – Vendosja e projekteve ose lagjeve banesore në zona “të sigurta” të qytetit.<sup>9</sup>

Problemi më të madh lidhur me karakteristikat e cekura të hapësirës së mbrojtur e ka paraqitur shkalla e pamjaftueshme e elaborimit teorik. Njuman nuk i ka definuar në mënyrë precize nocionet territorialiteti, ngjeshmëria dhe siguria. Në këtë vështrim i tërë koncepti i hapësirës së mbrojtur përmban në vete një dobësi të madhe epistemologjike, prandaj edhe vlerën instrumentale.

Përveç kësaj, teoria e dizajnit të mjedisit kishte edhe shumë dobësi të tjera të cilat i vënin në dukje me kujdes teoricienët përkatës të teorisë së mjedisit dhe të teorisë sociale të kriminalitetit. Një prej dobësive të teorisë së hapësirës së mbrojtur është edhe revitalizimi i nocionit të vjetër kriminelit racional. Pra, edhe pse pozitivizmi tregon qartë se sjellja e kriminelëve nuk është e kushtëzuar me gjykimin racional, në idenë e mbrojtjes nga kriminaliteti me ndryshimin e pamjes fizike të mjedisit, supozohet se hapësira e mbrojtur do të “frikësojë”

<sup>9</sup> Muratbegović, Elmedin, Parandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë, Prishtinë, prill 2007, fq 42

kryesin potencial në atë mënyrë që ai do të shohë në mënyrë “racionale” se shanset për veprim efikas kriminal janë të vogla. Problemi tjetër, dhe sipas të gjitha gjasave më i rëndësishmi, i kësaj teorie qëndron në vetë premisën teorike që konsiston në konstatimin se pamja fizike e mjedisit është variabli i vetëm, ose kyç nga e cila varet lindja e kriminalitetit. Njuman, e as teoricienët e tjerë të mjedisit, nuk merrnin në konsiderim disa variabla të tjera që janë potencialisht të rëndësishme për sqarimin shkakor të kriminalitetit. Ato janë në radhë të parë karakteristikat sociale të mjedisit. Kështu, mund të pasqyrohet në mënyrë statistikore se si mjediset që kanë karakteristika “të mungesës së dizajnit”, kryesisht i banojnë grupacionet sociale me rrezik dhe grupet margjinale shoqërore. Në kuadër të këtyre karakteristikave sociale të grupeve dhe të individëve, shkalla e kriminalitetit është në mënyrë standarde shumë më e lartë sesa tek kategoritë e tjera të banorëve, pa marrë parasysh veçoritë fizike të mjedisit në të cilat kanë jetuar ato grupacione. Përveç kësaj, është dëshmuar se disa variabla të thjeshta caktojnë disa dukuri kriminale. Kështu, p.sh., ekziston lidhja e thjeshtë statistikore midis numrit të fëmijëve që jetojnë në ndonjë mjedis dhe dukurisë së vandalizmit. Ky fakt, gjithashtu, nuk lidhet domosdo me faktorët e mjedisit.

Në fund të dhënave statistikore vejnë në dukje edhe faktin që në praktikë ekziston një numër i madh vendbanimesh që nuk kanë karakter të hapësirës së mbrojtur, e megjithatë shkalla e kriminalitetit në ato zona është shumë më e vogël në krahasim me disa zona të qytetit që kanë karakteristika të shprehura të hapësirës së mbrojtur.<sup>10</sup>

TEORIA E KONTROLLIT<sup>11</sup> është një nga teoritë më të rëndësishme të veprimeve kriminale, e megjithatë dy versionet e saj më të njohura dallohen. Arsyetimi më i njohur mbi teorinë e kontrollit është dhënë në librin “Shkaqet e delikuencës” të Travis Hirschit, 1969. Hirschi thekson se kriminalitetit nuk i nevojitet ndonjë motivim i veçantë: nuk është problem të sqarohet pse njerëzit bëjnë vepra kriminale, por pse nuk i bëjnë. Përgjigjja në pyetjen e dytë

---

<sup>10</sup> Korjaliç, Nedžad, Metodika Kriminalistike (deliktet e gjakut, seksuale, pasurore), Sarajevë, Prishtinë, 2007, FSK/S-15/06, fq.43.

<sup>11</sup> Muratbegović, Elmedin, Parandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë, Prishtinë, prill 2007, fq 61-62.

qëndron në kontrollin shoqëror, ashtu që shoqëria më e madhe e shtyn individin të heq dorë nga qëllimet e veta dhe t'u përmbahen rregullave.

Shumë teoricienë të kriminalitetit theksojnë rregullat dhe sa i mësojnë ose nuk i mësojnë njerëzit mirë. Hirschi haptas i shmanget kësaj teorie duke thënë në mënyrë të qartë se secili i di rregullat dhe i ka bërë pjesë të sjelljes së vet, e megjithatë i cenon duke shkuar pas dobësive themelore njerëzore. Lidhjet shoqërore ndihmojnë që të mposhten ato dobësi dhe të sillen në pajtim me konventat shoqërore, e atyre që u mungojnë kontrollet e tilla synojnë kryerjen e veprave kriminale dhe delikuate. Dy decenie pasi që ishte paraqitur kjo vepër, Michael Gottfredson dhe Travis Hirschi më 1990 kishin botuar “Teorinë e përgjithshme mbi kriminalitetin”. Kjo vepër theksonte konceptin që kriminalitetit nuk i nevojitet ndonjë motivacion i veçantë. Ajo shkon mjaft më larg nga vetë kriminaliteti, duke sqaruar kontrollet shoqërore që u ndihmojnë njerëzve; p.sh. që të kryejë punën mirë, të mësojnë mirë në shkollë, të ngasin në mënyrë të sigurt automjetin, të funksionojnë si prindër të mirë dhe të shpenzojnë me maturi. Shumë shkencëtarë shoqërorë dhe bihejvioristë duke i vërejtur korrelacionet midis atyre tendencave njerëzore, i kishin quajtur disa njerëz si pjesëtarë të kategorisë së përgjithshme “të personave devijantë” ose “të personave antisocial”. Mirëpo, Gottfredson dhe Travis Hirschi iu shmangnin termave të tillë duke cekur se njerëzit nuk dallohen vetëm nga motivacioni, por më tepër nga vetëkontrolli. Ata të cilët e kanë vetëkontrollin mjaft të ulët, më shpesh kanë hyrë në probleme të mëdha, por jo edhe të vetmit. Njerëzit e tillë i hyjnë kriminalitetit nëse për të ekzistojnë rrethanat ose shkojnë pas sprovave themelore njerëzore që të bëjnë probleme ose dëme kur për këtë i tërheqin rrethanat.

Psikologjia sociale gjithashtu definojnë konstruksionin e përgjithshëm në bazë të vetë rregullimit (rregullimit të sjelljes së vet), duke marrë parasysh sjelljet siç janë humbja e përqendrimit, mosuksesi në parashtrimin e qëllimeve, shtyrja e asaj që duhet ta bëjnë, keq menaxhimi i parave, duke rënë në procese të padëshiruara mendore dhe duke iu nënshtruar impulseve, apetiteve dhe disponimeve. Gottfredson dhe Travis Hirschi e veçojnë vetëkontrollin si diçka që është mbi ndër raportet e veta, sepse ajo mund të mbledhë më së tepërmi informata dhe mund ta bëjë teorinë të qëndrueshme. Vetëkontrolli ishte në pajtim me supozimin paraprak se secili ka dëshirë të ndaluar, por që disa njerëz kanë më tepër probleme që t'u përballojnë dëshirave të tilla.

Teoritë psikologjike mbi sjelljen e autorit:

TEORIA FEMINISTE<sup>12</sup> sipas së cilës përdhunimi nuk motivohet thjesht nga një dëshirë erotike, por nga një dëshirë për të kontrolluar, dominuar dhe përlulur viktimën përballë autorit mashkull. Kjo teori i referohet rasteve kur autori është i gjinisë mashkullore ndërsa viktima është e gjinisë femërore. Ndërkohë nuk pohon asgjë për rastet tjera dhe si e tillë konsiderohet e paplotë.

TEORIA E NXËNIES SOCIALE<sup>13</sup> sipas së cilës përdhunimi konsiderohet që i ka rrënjët në një traditë represive përballë femrës. Autori ka mësuar të sillet sipas një modeli që e bën atë më pak të ndjeshëm ndaj pasojave të dëmshme dhe që e lidh dhunën me kënaqësinë seksuale. Ky është një model i cili i përket shoqërive patriarkale të së kaluarës dhe që me evoluimin e shoqërisë njerëzore nuk mund të konsiderohet më edhe aq i pranishëm.

TEORIA E EVOLUCIONIT<sup>14</sup> që është edhe më e reja në terma kohorë, referon që dhuna seksuale është një faktor thuajse gjenetik, një impuls mashkullor për të fekunduar sa më shumë gra. Edhe kjo teori i referohet rasteve të autorit të gjinisë mashkullore dhe viktimës së gjinisë femërore.

### **3. Aspekte krahasuese të veprës penale të dhunimit**

Çdo shoqëri bashkëkohore që pretendon mbrojtjen e individit gjithashtu, në plan të parë ka edhe mbrojtjen e moralit dhe dinjitetit të cilëve, njëkohësisht shteti kujdeset t'u ofrojë edhe mbrojtjen juridiko-penale nëpërmjet parashikimit të veprave penale që e cenojnë moralin dhe dinjitetin.<sup>15</sup>

---

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Kjo teori mbrohet nga Brownmiller S., Against our will. Men, women and rape. Ballantine Publishing group, 1975.

<sup>14</sup> Kjo teori mbrohet nga Malamuth M., Rape proclivity among males, in Journal of social issues, volume 57, no.4, 1981.

<sup>15</sup> Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e posaçme (Cikël leksionesh), Tetovë, 2007, fq.79.

Më poshtë do të paraqesim veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor (kundër integritetit seksual) të Kodeve penale të vendeve si: Republikës së Maqedonisë, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Pas pasqyrimit të plotë të tyre të marra nga materialet gjegjëse, sa i përket kreut të veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, veprat penale që i përmbajnë, emërtimit të veprave penale si dhe sanksioni i paraparë për këto vepra penale të tre shteteve Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë. Me ç'rast do të bëhet analizë dhe studim i përgjithshëm specifik dhe krahasues, sa i përket ngjashmërive, dallimeve dhe mangësive eventuale që do të hasen. Krahasimi që do të aplikohet ka të bëjë me studim krahasues të tre shteteve të lartpërmendura, duke u përkufizuar vetëm në kreun përkatës, apo ku objekti mbrojtës është liria e personit në marrëdhëniet gjinore. E tërë kjo së pari do të bëhet duke u bazuar në dispozitat ligjore, me të cilat rregullohet mbrojtja e lirisë së personit në marrëdhëniet gjinore / integritetit seksual.

Çështjet ligjore dhe institucionale lidhur me dhunën seksuale në Maqedoni-Kosovë-Shqipëri: Në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri, krimet seksuale, tradicionalisht, janë konsideruar shkelje ligjore veçanërisht të rënda, të papajtueshme dhe skajshmërisht kundër nderit, moralit dhe respektit ndaj individit, veçmas ndaj gjinisë femërore. Këto vepra janë konsideruar si shkelje ligjore edhe në ligjet e mëparshme që kanë qenë në fuqi si, Ligji penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

**Tabela 1.** Përmes të tabelës që do të paraqesim në vazhdim do të prezantojmë kërret e Kodeve Penale të Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë që si objekt mbrojtës kanë lirinë e personit në marrëdhëniet gjinore/integritetin seksual, duke parashikuar figurat ligjore të veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor/ integritetit seksual dhe sanksionin penal.<sup>16</sup>

---

<sup>16</sup> Surdulli, Zejnullah, Studime të Doktoratës, Vepra Penale e Dhunimit në territorin e Gjykatës themelore në Gjilan 2004-2013.

<b>MAQEDONIA<sup>17</sup></b>	<b>KOSOVA<sup>18</sup></b>	<b>SHQIPËRIA<sup>19</sup></b>
<b>Dhunimi</b>	<b>Dhunimi</b>	<b>Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur</b>
<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.  <b>Me pasojë vdekje:</b> dënohet me dhjetë (10) vjet burgim ose burgim i përjetshëm.	<b>Dënohet</b> me burgim prej shtatë (7) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.  <b>Me pasojë vdekje:</b> jo më pak se tridhjetë (30) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.
<b>Kryerja e aktit seksual me person të paaftë (të pafuqishëm)</b>	<b>Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit</b>	<b>Marrëdhënie seksuale ose seksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjet</b>
<b>Dënohet</b> me së paku tetë (8) vjet burgim.  <b>Me pasojë vdekje :</b> me së paku dhjetë (10) vjet burgim ose burgim i përjetshëm.	<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.  <b>Me pasojë vdekje:</b> dënohet me dhjetë (10) vjet burgim ose burgim i përjetshëm.	<b>Dënohet</b> me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.  <b>Me pasojë vdekje:</b> dënohet me burgim jo më pak se njëzet (20) vjet.
<b>Sulmi seksual ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet</b>	<b>Sulmi seksual</b>	<b>Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura</b>
<b>Dënohet</b> me së paku dymbëdhjetë (12) vjet burgim.  <b>Në goftë se:</b> shkaktohet lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja tjera të rënda ose vepra është kryer nga më shumë persona apo në mënyrë posaçërisht të vrazhdë dhe nënçmuese, kryerësi do të dënohet me së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim apo burgim të përjetshëm.	<b>Dënohet</b> me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.  <b>Me pasojë vdekje:</b> dënohet me burgim nga dhjetë (10) gjer në njëzet (20) vjet.
<b>Kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës</b>	<b>Degradimi i integritetit seksual</b>	<b>Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur</b>
<b>Dënohet</b> me së paku pesë (5) vjet burgim.	<b>Dënohet</b> me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në një (1) vit.	<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.
<b>Kënaqja e epsheve seksuale para tjetërkujt</b>	<b>Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale</b>	<b>Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë pët t'u mbrojtur</b>

<sup>17</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.142, datë 13.11.2012, Kreu XIX- “Veprat Penale Kundër Lirisë Gjinore dhe Moralit Gjinator”.

<sup>18</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës-2013, Kodi nr. 04/L-082, Kapitulli XX-“Veprat Penale Kundër Integritetit Seksual”.

<sup>19</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, (i përditësuar) janar 2016, Seksioni VI-“Krime Seksuale”.

<b>Dënohet</b> me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.  <b>Me pasojë vdekje:</b> dënohet me burgim nga dhjetë (10) gjer në njëzet (20) vjet
<b>Ndërmjetësimi në kryerjen e prostitucionit</b>	<b>Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet</b>	<b>Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës</b>
<b>Dënohet</b> me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet burgim.	<b>Dënohet</b> me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet burgim.	<b>Dënohet</b> me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
<b>Pornografia fëmijërore</b>	<b>Nxitja e akteve seksuale, prekjes apo aktiviteteve nga personat nën moshën 16 vjet</b>	<b>Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën</b>
<b>Dënohet</b> së paku katër (4) vjet burgim.  <b>Fëmijës i cili nuk i ka mbushur 14 vjet :</b> dënohet deri në dhjetë (10) vjet burgim.	<b>Dënohet</b> me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim deri në tre (3) vjet.
<b>Ekspozimi i materialit pornografik fëmijës</b>	<b>Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën 16 vjet</b>	<b>Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari</b>
<b>Dënohet</b> me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim deri në shtatë (7) vjet.
<b>Prodhimi dhe distribuimi i pornografisë fëmijërore</b>	<b>Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi</b>	<b>Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike</b>
<b>Dënohet</b> me së paku pesë (5) vjet burgim.	<b>Dënohet</b> me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.	<b>Dënohet</b> me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
<b>Joshja në akt seksual apo në veprim tjetër seksual e fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjet</b>	<b>Keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin</b>	<b>Dhuna seksuale</b>
<b>Dënohet</b> me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet burgim.	<b>Dënohet</b> me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.  <b>Me pasojë vdekje:</b> dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë (25) vjet burgim
<b>Incesti</b>	<b>Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës</b>	<b>Vepra të turpshme</b>



<b>Dënohet</b> me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet burgim	<b>Dënohet</b> me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.
<b>Shpallja e aktgjykimit gjyqësor</b>	<b>Mundësimi ose detyrimi në prostitucion</b>	<b>Ngacmimi seksual</b>
Mbrojtja e të dhënave personale të viktimës <b>(14 vjet)</b> .	<b>Dënohet</b> me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.	<b>Dënohet</b> me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
	<b>Ofrimi i lokaleve për prostitucion</b>	
	<b>Dënohet</b> me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.	
	<b>Marrëdhëniet seksuale brenda familjes</b>	
	<b>Dënohet</b> me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.	

Nga tabela e mësipërme dalin në pah disa dallime jo dhe aq të mëdha por, në disa pjesë mund të llogariten edhe si dallime esenciale që e bëjnë të dallojë veçanërisht shumë një legjislacion penal nga tjetri. Dallimi i parë që bie në sy është numri i veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor/integritetit seksual, në këtë pikë prinë Kosova me më shumë figura veprash penale edhe atë katërbëdhjetë, më pas vjen Shqipëria me dymbëdhjetë figura veprash penale, dhe së fundi Maqedonia me njëmbëdhjetë figura veprash penale.

Në veprën penale të dhunimit sipas KPRM-së, kryerësi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet, Maqedonia dhe Shqipëria minimumin ligjor e kanë të përbashkët d.m.th. nga tre (3) vjet, të përbashkët kanë dhe kufirin e lartë, maksimumin ligjor deri në dhjetë (10) vjet. Kosova minimumin ligjor e ka më të ulët se sa Maqedonia dhe Shqipëria, edhe atë prej dy (2) vjet burgim. Legjislacioni penal i Maqedonisë dhe Kosovës dallon për nga ai i Shqipërisë edhe në emërtimin e veprës penale, ku në vend të emërtimit dhunim është “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”. Dallimi tjetër i legjislacionit të Shqipërisë nga legjislacioni i Maqedonisë dhe Kosovës, është mungesa e veprës penale e marrëdhënies seksuale-homoseksuale.

Të gjitha rrethanat tjera të veçanta në të cilat mund të kryhen marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë, si dhe veprat e turpshme, klasifikohen si figura krimi të posaçme e jo si rrethana të cilësuar (rënduese) të kryerjes së krimit. Në Kodin Penal të Shqipërisë vërejmë mungesën e disa figura veprash penale që duhet të mbrojnë marrëdhëniet juridike në mbrojtje të

integritetit fizik dhe moral të fëmijës, edhe atë p.sh: sulm seksual, nxitje e aktit seksual, degradim i integritetit seksual, ushtrim prostitucioni në afërsi të ambienteve shkollore, turizëm seksual, posedim i materialit pornografik me të mitur etj, gjë kjo që përmban Kodi Penal i Maqedonisë dhe ai i Kosovës.

Vepër penale e veçantë vërehet në Kodin Penal të Kosovës, “Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës<sup>20</sup>”, gjë kjo që mungon në legjislacionin e Maqedonisë dhe atë të Kosovës, por vepër kjo që është e domosdoshme të inkorporohet edhe në legjislacionet përkatëse pasi që jemi dëshmitar që lartë poshtë ky fenomen është i pranishëm edhe në vendin tonë.

Nga ky krahasim vërejtëm që dispozitat tjera që posedojnë Kodi Penal i Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë përgjithësisht janë në vijë të njëjtë, ku kemi të bëjmë me një harmonizim të legjislacioneve penale, me disa dallime të vogla të përcaktimit të disa prej figurave të veprave penale në nene të veçanta apo të inkorporuar në paragrafë.

Në tre legjislacionet përkatëse (Kodet Penale), jeta, shëndeti, dinjiteti dhe integriteti seksual i grave dhe femrës në përgjithësi mbrohet nga krimet seksuale me një sërë dispozitash ligjore, gjithashtu duke mos përfshirë fëmijët apo të miturit/miturat të cilët gëzojnë një mbrojtje më të theksuar, e cila para së gjithash vërehet në përcaktimin e lartë të kufirit ligjor (sanksionit). Marrëdhënia seksuale me madhorë (dhunimi), në Kodet Penale të analizuara është e paraparë si figurë e veçantë krimi. Figura e veprës penale të dhunimit, shihet me prezencën e dhunës e cila është njëra ndër karakteristikat e saj, që e shoqëron gjatë gjithë kohës, por që duhet të vërtetohet me anë të fakteve dhe provave. Dhuna është elementi kryesor dhe specifik i veprës penale të dhunimit dhe ku është i domosdoshëm kundërshtimi dhe mospajtimi i viktimës. Dhuna fizike manifestohet me anë të disa veprimeve si: rrahja, goditja, shkelmimet, dridhjet, ngufatjet, gjuajtjet, helmimi, djegia, hedhja e ujit të nxehtë apo eksplorimi i individit në avull të valuar etj<sup>21</sup>, por krahas kësaj jurisprudenca njih edhe dhunën psikike. Dhuna psikike pranohet si provë vetëm në ato raste kur ka kanosje serioze për vrasje apo plagë të rënda. Nga rastet praktike

---

<sup>20</sup> Në nenin 240 të KPRK-së përcaktohet: “Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës” Kushdo që premtim të rrejshëm martesën në mënyrë që të nxisë personin i cili është në mes të moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet që të përfshihet në akt seksual, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

<sup>21</sup> Protokoll i përbashkët në raste të dhunës në familje.

rezulton, se vepra penale konsiderohet e mbetur në tentativë, vetëm atëherë kur subjekti i veprës nuk ka mundur të mposht viktimën.

Ashtu siç e sqaruam në tekstin e lartë cekur, në rrethanat e zakonshme, dhunimi seksual/marrëdhënia seksuale me dhunë dënohet me burgim nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet burgim. Dënimi rritet atëherë kur vepra penale kryhet në bashkëpunim apo nga ana e më shumë personave, në mënyrë të vrazhdë apo nënçmuese, lëndimi i rëndë apo plagosja e viktimës. Nga kjo vërehet që Shqipëria ka paraparë dënim më të rëndë për subjektin që kryen veprën, që është nga dhjetë (10) gjer në njëzet (20) vjet burgim dhe jepet kur si pasojë e veprës penale ka rezultuar vdekja apo vetëvrasja e viktimës. Kur si pasojë të veprës penale të dhunimit kemi vdekjen, Maqedonia parasheh: nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 është paraqitur lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja tjera të rënda, ose vepra është kryer nga ana e më shumë personave ose në mënyrë të vrazhdë apo të përbuzur, kryerësi do të dënohet me së paku katër vjet burgim<sup>22</sup>, që është për tu diskutuar dhe jo aq precize pasi që ligjvënësi ka përcaktuar vetëm pragun e poshtëm apo minimumin ligjor, ndërsa caktimin final e ka lënë në dorë të organeve gjyqësore për çdo rast që do të ballafaqohet, por kjo na lë të kuptojmë se dënimi maksimal mund të arrijë deri në burg të përjetshëm, pasi që është kufiri i fundit i dënimeve që përmban Kodi Penal i Maqedonisë.

Është e rëndësishme të theksohet se baza konceptuale e Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë konsiston në idenë sipas së cilës ligji penal është instrument themelor i shtetit juridik në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut nga kufizimi i dhunshëm i tyre që mund të paraqitet në formë të kriminalitetit apo dhunës shtetërore.

### **3.1. Aspekte krahasuese me Republikën e Kosovës – Vepra penale e dhunimit sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës**

Me zhvillimin dhe ndryshimet e shoqërisë ndryshohen edhe botëkuptimet lidhur me faktin se çka është e pranueshme e çka jo në sferën seksuale, përkatësisht çka është morale e çka jo. Botëkuptimet e këtilla ndikojnë edhe në ligjdhënësin për të përcaktuar se cilat vepra t'i penalizojë dhe cilat vepra t'i depenalizojë, të mos i konsiderojë vepra penale. Së këndejmi, ky

---

<sup>22</sup> Neni 186 paragrafi 3 i KPRM-së.

lëmë është një ndër lëmenjtë më dinamike, më të ndryshueshëm në legjislacionet penale të shteteve.<sup>23</sup>

Në legjislacionin penal i cili u zbatua në Kosovë deri në hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Kosovës më 6 prill të vitit 2004, ky kapitull mbante titullin “Veprat penale kundër dinjitetit dhe moralit”. Në Kodin Penal të Kosovës, tani ky grup i veprave penale është emërtuar me titull shumë më adekuat dhe më preciz. Lidhur me këtë, jo vetëm në titull, por edhe në të gjitha veprat penale të këtij kapitulli, në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, janë bërë ndryshime konceptuale dhe përmbajtësore. Rrjedhimisht, në përpilimin e këtij kapitulli, në të cilin krahas ekspertëve kosovarë kanë marrë pjesë edhe ekspertë amerikanë dhe ekspertë të Këshillit të Europës, në mënyrë maksimale dhe mjaft gjithëpërfshirëse, në dymbëdhjetë inkriminime dhe në shumë paragrafë dhe nënparagrafë, në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, janë paraparë shumë vepra penale të reja me të cilat janë penalizuar edhe format më të lehta të cenimit të integritetit seksual dhe të lirive në sferën e jetës seksuale.<sup>24</sup> Sot Kodi Penal i Kosovës përmban një numër më të madh të veprave penale nga sfera e jetës seksuale, edhe atë katërbëdhjetë inkriminime.

Krimet seksuale në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, rregullohen në kapitullin XX, “Veprat penale kundër integritetit seksual”, ku përfshihen veprat penale: Dhunimi-(neni 227), Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit-(neni 228), Sulmi seksual-(neni 229), Degradimi i integritetit seksual-(neni 230), Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet-(neni 231), Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi-(neni 232), Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës-(neni 233), Mundësimi ose detyrimi në prostitucion-(neni 234), Ofrimi i lokaleve për prostitucion-(neni 235), Marrëdhëniet seksuale brenda familjes-(neni 235).

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, është më i qartë dhe përshkruan në mënyrë më të detajuar veprën penale të dhunimit, duke mos lënë që të ketë hamendje apo kundërthënie, kjo shprehet me dispozitën “Përkufizimet lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual- neni 225”: 1. Shprehja “pëlqim” nënkupton: 1.1. pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën

---

<sup>23</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme, Prishtinë, shtator, 2009, fq.205.

<sup>24</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme, Prishtinë, shtator, 2009, fq.206.

gjashtëmbëdhjetë (16) vjet për të kryer aktin seksual. 1.2. marrëveshja vullnetare e dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmëdhjetë (14) vjet dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon dy (2) vjet, për të kryer aktin seksual në fjalë. 2. Nuk ekziston pëlqimi nëse: 2.1. personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë; 2.2. pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës; 2.3. pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin siç është paraparë në nenin 227 paragrafi 3. të këtij Kodi; ose 2.4. personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera. 3. Asnjë veprim nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nuk duhet të interpretohet si kufizim i rrethanave në të cilat nuk ekziston pëlqimi. 4. Shprehja “akt seksual” nënkupton penetrim sado i vogël i organit seksual ose i objektit për qëllime seksuale në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale, orale apo gjenitale të personit me ndonjë send për qëllim seksual ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit, ose me cilëndo pjesë të kafshës. 5. Shprehja “detyrim i personit tjetër në kryerjen e aktit seksual” nënkupton kryerjen e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryesi ose cytja e personit tjetër në kryerjen e aktit seksual me kryesin apo me personin e tretë ose cytja e personit të tretë për kryerjen e aktit seksual në personin tjetër.<sup>25</sup>

Vepra penale e dhunimit në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, parashihet në nenin 227 ku thuhet: Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.<sup>26</sup> Forma më e rëndë apo e cilësuar e kësaj vepre është kur vepra rezulton me vdekjen e viktimës, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Për dallim nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmban më shumë figura veprash penale, ose thënë më ndryshe disa vepra penale të cilat janë të kohës bashkëkohore dhe që është e udhës të inkorporohen edhe në legjisllacionin tonë, disa nga ato vepra janë: sulmi seksual (neni 229), degradimi i integritetit seksual (230), nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës ( neni 230) etj.

---

<sup>25</sup> Neni 225 i KPRK-së.

<sup>26</sup> Neni 227 i KPRK-së.

Këto dhe disa inkriminime tërësisht të reja, jo vetëm për teorinë, por edhe për praktikën gjyqësore, do të paraqesin sfida për interpretimin dhe aplikimin e drejtë në praktikë. Shpjegimi dhe përkufizimi i këtyre inkriminimeve ka paraqitur vështirësi dhe, veçmas nga fakti se në legjislacionin dhe në literaturën e praktikën gjyqësore, jo vetëm të shteteve të rajonit, por edhe më gjerë, nuk janë të njohura disa nga këto inkriminime dhe si të tilla nuk janë të studiuara dhe as që janë ndërtuar përvoja gjyqësore, por me siguri do të kontribuojë praktika e gjykatave të Kosovës dhe shkenca e së drejtës penale.<sup>27</sup>

Përgjithësisht mund të themi që ajo që vërehet më së shumti është lartësia e dënimeve në Republikën e Maqedonisë, që janë më rigoroze në krahasim me Republikën e Kosovës sa ju përket krimeve të integritetit seksual.

### **3.2. Aspekte krahasuese me Republikën e Shqipërisë – Vepra penale e dhunimit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë**

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë përmban disa karakteristika kryesore që përfaqesin atë me standardet e Kodeve Penale demokratike bashkëkohore.

Së pari, Kodi Penal është ndërtuar sipas modeleve të Kodeve penale të shteteve demokratike (Francë, Holandë, Gjermani, Suedi, SHBA, Itali) me pjesëmarrje direkte të specialistëve të huaj në bashkëpunim me ata shqiptar, së dyti Kodi Penal u përgadit duke pasur si bazë “Dispozitat kryesore kushtetuese” me orientim filozofik liberal-demokratik për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që përshkon tej e ndanë dispozitat e tij dhe sanksionon parimin bazë të shtetit të së drejtës-ligjshmërinë.<sup>28</sup>

Kodi i Republikës së Shqipërisë, mbron integritetin seksual me një sërë dispozitash, të cilat janë të rregulluara dhe parashihen në Seksionin e VI të Kodit Penal , edhe atë të titulluar “Krime Seksuale”. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë për dallim nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë përmban në vete më pak figura të veprave penale, gjithsej nëntë.

---

<sup>27</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale- Pjesa e posaçme, Prishtinë, shtator, 2009, fq.206.

<sup>28</sup> Elezi, Kaçupi, Haxhia, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë – Pjesa e Përgjithëshme, Azhornuar e plotësuar me shtesat e ndryshimet e bëra me reformat ligjore të viteve 2001, 2003, 2004, 2007, 2008, 2012,2013, e 2014 si dhe me praktikën gjyqësore, Tiranë, 2014, fq.15.

Ajo që është për tu diskutuar është mangësia në parashikimin e krimeve seksuale dhe veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit të të miturve. Në një shikim të thjeshtë të ligjit, doktrinës, dhe realitetit që na vjen nga pasqyrimi mediatik i rasteve, mund të konstatojmë lehtësisht dhe shumë bindshëm se Drejtësia në Shqipëri në rastet e krimeve seksuale të të miturve është ende larg modelit të një drejtësie parandaluese, rehabilituese dhe së fundi ndëshkuese.

Kodi Penal i Shqipërisë në seksionin e VI ku rregullohen veprat penale kundër integritetit seksual parasheh nëntë vepra penale të kësaj natyre, edhe atë: Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur-(neni 100), Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç- (neni 101), Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura- (neni 102), Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur-(neni 102/a), Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur-(neni 103), Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës-(neni 104), Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën- (neni 105), Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari-(neni 106), Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike-(neni 107), Dhuna seksuale-(neni 107/a), Vepra të turpshme-(neni 108), Ngacim seksual-(neni 108/a). Në Kodin Penal të Shqipërisë vërehet një mungesë, ku tek disa nene ku parashihen krimet seksuale mungon norma përshkruese.

Në asnjë prej neneve nuk kemi përkufizim për “marrëdhënie seksuale” apo “marrëdhënie homoseksuale”, pra jemi përpara mungesës së normave përshkruese. Seksioni “Krime Seksuale” në KPRSH-së nuk ka asnjë normë përshkruese duke cenuar efijencën e ligjit penal, i cili duhet të jetë sa më abstrakt dhe i detajuar<sup>29</sup>.

Vepra penal e dhunimit siç është e emërtuar në Kodin Penal të Maqedonisë, në Kodin Penal të Shqipërisë është e emërtuar ndryshe edhe atë “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura neni 102”, ku thuhet: Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre

---

<sup>29</sup> Cipi, Bardhyl dhe Meksi, Sokrat, Mjekësia Ligjore, Tiranë, 2005, fq.145.

gjer në dhjetë vjet<sup>30</sup>. Forma më e rëndë e kësaj vepre është atëherë kur si pasojë kemi vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, ku është paraparë burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Shqipëria dhe Maqedonia kanë të përbashkët ashpërsinë në përcaktimin e sanksionit penal, ku në rastin e veprës penale të dhunimit kemi një dënim identik sa i përket minimumit dhe lartësisë maksimale të dënimit në të dyja vendet.

Është për t'u diskutuar rasti i veprës penale "Vepra të turpshme", gjë kjo që mungon në Kodin Penal të Maqedonisë, por që në kohën bashkëkohore ka qenë një vepër që ka pasuruar legjislacionin shqiptar për arsye të aktualitetit të saj. Mangësia e saj përsëritet prapë mungesa e një definicioni apo norme përshkruese, por parashikohet si nen blanket.

Duke u bazuar në doktrinën juridike fitojmë një pasqyrim dhe një shpjegim sa i përket kësaj norme: Me veprime të turpshme (luksuri) kuptohen ato mënyra të të kënaqurit të epshit seksual, që nuk përmbajnë element të ndonjë krimi tjetër seksual dhe si vepra të tilla janë prekja e organeve seksuale të të miturve (vajza e djem) me dorë ose me ndonjë pjesë tjetër të trupit nga të rriturit etj<sup>31</sup>.

Nga e gjithë kjo analizë dhe krahasim i legjislacioneve penale të tre shteteve Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri mund të konkludojmë që Kodet Penale janë të pasura dhe spikasin çdo aspekt që mund të jetë mënyrë e veprimit apo pjesë e një aktiviteti kriminal në rastet e veprës penale të dhunimit. Edhe pse në pamje të parë kodet mund të duken më se të ngjashme, por çdo normë dallon nga tjetra kur i jepet një përshkrim adekuat dhe një interpretim logjik, ngjashmëria më e madhe theksohet sa i përket sanksionit penal që kanë në mes një vijë të hollë ndarëse. Së fundi mund të themi se të tre vendet si Maqedoni, Kosova dhe Shqipëria kanë legjislacion me frymë demokratike dhe të harmonizuara në bazë të standardeve evropiane.

---

<sup>30</sup> Neni 102 i KPRSH-së.

<sup>31</sup> Korjaliç, op. cit., FSK/S-15/06.



## KAPITULLI I DYTË

### NOCIONI, FIGURA LIGJORE, OBJEKTI DHE SUBJEKTI I VEPRËS PENALE TË DHUNIMIT

#### 1. Vepra penale e dhunimit sipas Legjislacionit të Republikës së Maqedonisë

E drejta penale mund të thuhet dhe të shqyrtohet në kuptim të dyfishtë – si degë e së drejtës pozitive juridike dhe si degë e shkencës juridike. Kuptuar mënyrën e parë e drejta penale është sistem i të drejtave dhe rregullave ligjore me të cilin përcaktohen veprat penale dhe sanksionet penale si dhe kushtet për zbatimin e tyre ndaj kryerësve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së të mirave materiale të vlerave më të rëndësishme të shoqërisë. Një definicion i atillë sipas të cilit e drejta penale është sistem i të gjitha dispozitave ligjore me të cilat një shtet i rregullon dhe përcakton sjelljet që konsiderohen vepra penale, dhe cilat dënime dhe sanksione të tjera penale, dhe në çfarë kushtesh mund të zbatohen ndaj kryerësve të tyre. Nga këto definicione del se nocioni i së drejtës penale përmban elementin formal dhe material. Elementin material, respektivisht përmbajtjen e së drejtës penale e përbëjnë definimi i veprës penale, përgjegjësisë penale dhe sanksionit penal, me qëllim të realizimit të mbrojtjes – funksionit garantues. Elementi formal na pasqyrohet që vepra penale si dhe sanksioni penal bashkë me kushtin për zbatimin e tyre mund të definohen vetëm me ligj, që do të thotë se e drejta penale është e drejtë ligjore. Pasi që rregullimi juridik është i definuar me një varg ligjesh që me tërësinë e tyre e përbëjnë legjislacionin e një shteti, dhe se edhe e drejta penale si e drejtë ligjore mund të vështrohet si degë e legjislacionit, respektivisht si degë e së drejtës pozitive të një shteti.<sup>32</sup>

E drejta penale si shkencë juridike dhe degë e së drejtës pozitive ndahet në dy pjesë: në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme. Lënda e pjesës së posaçme konsiston në analizimin dhe shpjegimin e veprave penale veç e veç. Këtë funksion, pjesa e posaçme e së drejtës penale e ushtron duke i ndarë, analizuar dhe interpretuar elementet e figurës ligjore të çdo veprave penale dhe duke bërë sintetizimin e tyre si dhe duke përcaktuar nocionin e veprës penale. Duke marrë parasysh çështjet që rregullohen, pjesa e posaçme e së drejtës penale mund të

---

<sup>32</sup> Petroviq, Borislav, E Drejta Penale, Sarajevë, Prishtinë, FSK/S -14/06, 2006, fq.8.

përkufizohet si një sistem i normave penalo-juridike me të cilat parashihen veprat penale veç e veç, sanksionet penale dhe masat që mund t'i shqiptohen kryerësit.<sup>33</sup>

Pjesa e posaçme është repertori i formësuar në mënyrë sistematike të veprave penale të ndara në më shumë grupe, që fillon me vepra penale kundër jetës dhe trupit, kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, si dhe mbaron me kreun për veprat penale kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare. Strukturën formale të dispozitave të pjesës së posaçme e përbëjnë dy elemente: dispozitivi dhe sanksioni.

Dispozitivi është ajo pjesë e dispozitës ligjore, në të cilin është përshkruar sjellja e cila është ndaluar apo është urdhëruar. Çdo dispozitiv së pari përmban norma ndaluese (prohibitive) apo urdhëruese (imperative). Gjithashtu, çdo dispozitiv përcakton kryerësin e veprës si dhe sjelljen e tij që paraqet shkelje të ndalesës apo urdhëresës. Pjesa e dytë e dispozitave të pjesës së posaçme përfshinë sanksionin, respektivisht formën penalo-institucionale të represionit shtetëror për shkeljen e normës së përfshirë me dispozitivin ligjorë<sup>34</sup>.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor i rregullon me kreun XIX, të cilat për nga rëndësia renditen menjëherë pas veprave penale kundër jetës dhe trupit. Me vepra penale të drejtuara kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor nënkuptohen ato vepra të kundërligjshme të kryera me faj të cilat cenojnë moralin dhe lirinë gjinore. Objekt mbrojtës i këtyre veprave penale, janë dy vlerat më të çmueshme njerëzore liria seksuale dhe morali gjinor, të cilat janë të lidhura ngushtë mes veti dhe është e pamundur ndarja e tyre në pjesë të mëvetëshme, andaj edhe trajtohen në një kapitull të përbashkët.

Kodi Penal fokusin e vendos në disa forma të marrëdhënieve seksuale të cilat kryhen me anë të dhunës, mashtrimit, kërcënimit, premtimit të rrejshëm etj apo thënë më ndryshe në ato raste ku cenohet dhe nuk përfilllet vullneti i personit tjetër, sepse vet marrëdhënia seksuale nuk paraqet veprë penal. Vepra penale e dhunimit është një veprë klasike dhe historikisht e njohur, dhe si e tillë është e radhitur e para, më pas pasojnë disa vepra amorale dhe nënçmuese si: kënaqja e

---

<sup>33</sup> Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme, Tetovë, 2007, fq.11-12.

<sup>34</sup> Osmani, Afrim, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (Teksiti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi analfabetik), Shkup, 2010, fq.33-34.

epsheve seksuale parat tjetërkujt, ndërmjetësimi në kryerjen e prostitucionit, pornografia fëmijërore, ekspozimi i materialit pornografik fëmijës, incesti etj.

Duke paraparë sanksionet penale për këto vepra penale dënohet: dhuna, keqpërdorimi i pozitës dhe shfrytëzimi i personit të paafte, mbrohet liria e vendosjes se kur dhe me kënd do të ketë marrëdhënie seksuale një person. Veçanërisht gjatë përcaktimit juridiko-penal të veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, mbrojtje e posaçme është paraparë për personat e mitur. Këto vepra penale mund të kryhen vetëm me dashje.<sup>35</sup>

Motivi i kryerjes të këto vepra penale është kënaqësia e epshit seksual, impulsit të plotë. Dhunimi dhe veprat penale të tilla si: kënaqja e pasionit të plotë para të tjerëve, trafikimi i personave për qëllime prostitucioni, shfrytëzimi i fëmijëve dhe të miturve për pornografi, prodhimi dhe shfaqja e pornografisë së fëmijëve, për të cilat ka shumë qëndrime se po dëmtojnë qëndrimet morale dhe normat morale për shumicën e njerëzve të cilat përfaqësojnë moralin publik të shoqërisë në periudhë të caktuar.<sup>36</sup>

## **2. Nocioni i veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë**

### ***Dhunimi ( neni 186 )***

*(1) Ai i cili tjetrit me përdorim të forcës ose kërcënimit se drejtëpërdrejtë do të atakojë ndaj jetës apo trupit të tij, ose ndaj jetës dhe trupit të ndonjë të afërmi të tij, do ta detyrojë në kryerje të aktit seksual do të dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.<sup>37</sup>*

Sipas paragrafit 1, vepra penale e dhunimit kryhet në rastet kur ndokush e detyron personin tjetër të kryejë akt seksual pa pëlqimin e atij personi. Kjo formë e parë e veprës penale, edhe pse jo sa duhet e përkufizuar, duhet të konsiderohet se kryhet në situatë kur nuk përdoret dhuna apo kanosja, por marrëdhënia seksuale kryhet pa pëlqimin e viktimës, kundër vullnetit të viktimës.<sup>38</sup>

<sup>35</sup> Zejneli, Ismail, E Drejta Penale- Pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq.79.

<sup>36</sup> Stankoviç, Nedeljko, Krivçeno Pravo-Posebni dio, Brčko,2017,fq.179.

<sup>37</sup> Neni 186 i KPRM-së.

<sup>38</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2009, fq.207.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, nuk është edhe aq decid sa i përket përkufizimit të disa thënieve nga ky kapitull, mungon një dispozitë me karakter shpjegues sa ju përket disa nga shprehjet që përmban ky nen (neni 186). Nga këtu nisemi me mungesën e një përkufizimi më të përpiktë sa i përket termit “akt seksual”, duke qenë dëshmitar që në kohën bashkëkohore jemi të njohur edhe me disa marrëdhënie tjera seksuale, përveç asaj që është e natyrshme ndërmjet burrit dhe gruas.

Gjithashtu, hasim mungesën dhe mos ekzistencën e termit “pëlqim” në të gjitha dispozitat që rregullojnë kreun e veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor. Mospëlqimi i shprehur nga viktima çdoherë ia jep karakterin e dhunimit, marrëdhënies seksuale qoftë ai i shprehur edhe në mënyrën më të thjeshtë verbale. Në këtë rast Kodi Penal krijon një konfuzion dhe lë hapësirë për një interpretim më të gjërë, ajo që na vije në mend është çka do të ndodhë në rastet që viktima e ka shprehur mospëlqimin e saj, a do të konsiderohet edhe atëherë dhunim?

Kjo na lë të kuptojmë që është i nevojshëm inkriminimi i një dispozite të re, siç është rasti me Republikën e Kosovës, për të mos pasur kundërthënie në mes veti dhe të përfshihen edhe ato raste ku mjafton që cenohet vetëm vullneti i viktimës.

Për këtë veprë penale është paraparë burgim prej tre deri në dhjetë vjet. Forma më e rëndë apo e klasifikuar e kësaj veprë penale është paraparë në paragrafin 2 dhe 3, ku thuhet:

*(2) Nëse vepra nga paragrafi (1) të këtij neni është kryer ndaj fëmijës i cili ka mbushur 14 vjet, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.*

*(3) Nëse për shkak të veprës nga paragrafi 1 është paraqitur lëndim i rëndë trupor, vdekje apo pasoja tjera të rënda, ose vepra është kryer nga ana e më shumë personave ose në mënyrë të vrazhdë apo të përbuzur, kryerësi do të dënohet me së paku katër vjet burgim.<sup>39</sup>*

Veprimi i kryerjes qëndron në përdorimin e forcës (dhunës) apo të kanosjes me qëllim të kryerjes së aktit seksual. Përdorimi i forcës shprehet duke ushtruar forcën fizike. Si veprime të forcës mund të jenë grushtimi i viktimës, asfiksioni, zhveshja e rrobave, mbyllja e gojës, tërheqja zvarrë e viktimës, tërheqja për flokë etj. Lidhur me këtë veprë penale, dhuna dhe kanosja shërbejnë si mjet për kryerjen e aktit seksual. Kjo veprë penale ekziston edhe në rastet kur dhuna

---

<sup>39</sup> Neni 186 i KPRM-së.

apo kanosja nuk janë të drejtuara në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj viktimës, por edhe ndaj të afërmeve të viktimës. Kështu p.sh. dhuna apo kanosja e drejtuar ndaj fëmijës apo ndonjë personi të afërm mund të ndikojë në vullnetin e viktimës që të thuhet rezistenca e saj<sup>40</sup>.

Dhuna e ushtruar me këtë qëllim duhet të jetë e papërballueshme. Dhuna konsiderohet e papërballueshme (absolute) në rastet kur subjekti pasiv (viktima) është e privuar në tërësi nga të bërit rezistencë. Dhuna mund të jetë kompulsive (e pa përballueshme) në rastet kur viktima nuk është privuar nga mundësia që të rezistojë, por nën ndikimin e dhunës ka qenë i detyruar të tolerojë.

Kanosja duhet të jetë e drejtpërdrejtë. E kështu konsiderohet në rastet kur subjekti pasiv formon bindje se sulmi mund të fillojë në çdo moment ndaj jetës apo integritetit të tij, ndaj jetës apo integritetit të personave të afërm të tij. Persona të afërt me viktimën konsiderohen fëmijët, prindërit, vëllai dhe motra, gjyshi dhe gjyshja, bashkëshorti apo bashkëshortja dhe personi me të cilin jeton në bashkësi jashtëmartesore.<sup>41</sup>

Tipare klasike të veprës penale të dhunimit paraqiten dhuna dhe kanosja, qëllimi i të cilave përdoren si forca të shtrëngimit më qëllim të realizimit të marrëdhënies seksuale. Në rastet kur nuk ekzistojnë dy format themelore dhuna dhe kanosja vepra penale e dhunimit nuk do të konsiderohet e kryer.

Vepra penale konsiderohet se është kryer nëse me ushtrimin e dhunës apo kanosjes është kryer marrëdhënia seksuale. Marrëdhënia seksuale konsiderohet se është përfunduar nëse ka ndodhur penetrimi i organit seksual të kryerësit në organin seksual të subjektit pasiv, të viktimës. Marrëdhënia seksuale nuk konsiderohet se është kryer nëse ka pasur vetëm tangim, prekje të organeve seksuale.<sup>42</sup>

---

<sup>40</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2009, fq.209.

<sup>41</sup> Po aty.

<sup>42</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2009, fq.201.

### **3. Figura e veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë**

Për dallim nga nocioni i përgjithshëm i veprës penale si veprim i kundërligjshëm, i shtrembëruar dhe ndëshkues i paraparë në ligj, në realitet vepra penale paraqitet si vepër konkrete e vjedhjes, dhunimit, mashtrimit etj. Çdo vepër penale në vete i sublimon elementet e përgjithshme të veprës penale, por njëkohësisht që të dallohet si vepër e posaçme që është objekt i gjykimit, ato elemente patjetër të marrin përmbajtje konkrete! P.sh. veprimi si element material në nocionin e përgjithshëm të veprës penale është konkretizuar nëpërmjet veprimit të përshkruar ligjor të kryerjes, veprimit kompleks, veprimit dhe mosveprimit etj. Përcaktueshmëria e veprës në ligj konkretizohet nëpërmjet përshkrimit ligjor dhe figurës ligjore të veprës!<sup>43</sup>

Nocioni i figurës ligjore i përfshin veçoritë ligjore me të cilët vepra penale përcaktohet si entitet i posaçëm dhe dallohet nga veprat tjera penale. Figurën ligjore e përbëjnë vetëm veçoritë e koncentruara rreth shkeljes të së mirës juridike! Ajo jep definimin e jo të drejtës objektive materiale të çdo vepre penale që e inkuadron normën penalo-juridike (ndalesë apo urdhër), e mirën juridike që mbrohet dhe që është objekt i sulmit dhe forma konkrete e sulmit ndaj asaj të mire juridike! Figura ligjore i konkretizon elementet e përgjithshme të nocionit të veprës penale sipas kriterit vlerësues të shkeljes së normës konkrete, respektivisht të së mirës juridike në mbrojtjen e së cilës është vendosur ajo! Ashtu e padrejta material e vjedhjes sipas veçorive ligjore dallohet nga dhunimi.<sup>44</sup>

Funksioni themelor i figurës ligjore është ta definojë të padrejtën objektive materiale të veprës penale, ashtu që e njëjta nuk i përfshinë elementet e fajit, i cili është element i posaçëm subjektiv i veprës penale. Përcaktimi i këtillë i të padrejtës objektive, materiale të çdo vepre konkrete dhe dallimi i saj nga e padrejta subjektive e veprës (faji si element i posaçëm) ka edhe konsekuenca tjera të rëndësishme penalo-juridike! E para, realizimi i figurës ligjore e veprës penale në mënyrë të kundërligjshme është e mjaftueshme që ai veprim të trajtohet si vepër penale në kuptimin objektiv. Në të drejtën penale bashkëkohore është i pranueshëm nocioni objektiv-subjektiv, ashtu që për ekzistimin e veprës penale nuk mjafton realizimi i figurës ligjore të veprës. I nevojshëm është edhe faji nga ana e kryerësit! E dyta, figura ligjore ka domethënien e bazës së gjykimit të

<sup>43</sup> Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010, fq.171.

<sup>44</sup> Baçiq, dr Frawo, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, fq.220.

kundërligjshmërisë së veprës dhe fajit të kryerësit: objekti i vlerësimit të tillë mund të jetë vetëm sjellja e kryerësit, me të cilën realizohet figura ligjore e veprës penale, respektivisht të padrejtën objektive, materiale të veprës.<sup>45</sup>

Figura ligjore përfshinë fotografinë e të padrejtës materiale që duhet të projektohet në një ngjarje kriminale! Me fjalë tjera, nuk ka vepër penale nëse sjellja njerëzore nuk i konkretizon veçoritë e caktuara të figurës ligjore! Format reale të konkretizuara të atyre veçorive janë rrethanat relevante penalo-juridike që duhet të vërtetohen në rastin konkret që ai të kualifikohet si vepër e caktuar penale. Ngjarja në të cilën, sipas argumentimit në procedurë penale, është vërtetuar se personi A me veprimin e tij ka shkaktuar vdekjen e personit B, fiton kualifikim të veprës penale, vrasje për shkak të asaj se i plotëson të dy veçoritë nga të cilat përbëhet figura ligjore e veprës, vrasje (n.123 p.1 “ai që do të privojë tjetrin nga jeta”).<sup>46</sup>

Nga kjo që cekëm më lartë shihet që vepra penale i ka elementet e saja të posaçme. Elementet e përgjithëshme në bashkëveprim me elementet e posaçme, paraqesin një konkretizimi të nocionit të veprës penale, gjithashtu elementet e posaçme bëjnë plotësimin e elementeve të përgjithëshme. Në mungesë të përcaktimit të elementeve të posaçme, do të mungojë edhe kualifikimi i veprës penale konkrete. Kur gjykata të konstatojë elementet e posaçme të rastit konkret, ajo do të bëjë kualifikimin e veprës penale sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal apo të ndonjë dispozite tjetër penale.

#### **4. Objekti i veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë**

Funksioni mbrojtës i së drejtës penale drejtpërdrejtë implikon edhe objekt të caktuar të mbrojtjes së tillë, i përfshirë me nocionin e së mirës juridike! Sipas qasjes formale-materiale, vepra penale është sjellje e njeriut që është e ndaluar me ligj për shkak të asaj se paraqet cënim apo kërcënim i vlerave dhe të mirave individuale dhe shoqërore! Nocioni i së mirës juridike mund të definohet në kuptimin formal dhe material. Në kuptimin formal, me të mirë juridike kuptohet ai interes, vlerë apo e mirë, që drejtpërdrejtë mbrohet me normën penalo-juridike. Në kuptimin material, e

---

<sup>45</sup> Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010, fq.171-172.

<sup>46</sup> Po aty.

mirë juridike është diçka çka i paraprijnë ndalesë penalo-juridike, që e motivon, duke paraqitur kriter vlerësues i ligjdhënësit në vënien e tij.<sup>47</sup>

Shtrohet pyetja se çka konsiderohen në të drejtën penale objekte të veprës penale? Objekte të veprës penale janë të mirat apo vlerat vitale të njeriut, të popullit të një vendi dhe të komunitetit ndërkombëtar. Këto janë jeta e njeriut, integriteti trupor, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit, siguria, paqja, barazia, prona, rregullimi shoqëroro-politik dhe siguria e vendit, martesë, familja, nderi, autoriteti etj. Për shkak të rëndësisë së madhe për qytetarët dhe shoqërinë, këto dhe vlerat e ngjashme janë të mbrojtura me të drejtën penale nacionale dhe me të drejtën penale ndërkombëtare. Këtë mbrojtje e drejta penale e ushtron duke paraparë dhe duke aplikuar me dhunë dënime dhe sanksione të tjera penale ndaj personave që kryejnë vepra të këtilla.<sup>48</sup>

E mira juridike si objekt i veprës penale na intereson së pari nga aspekti i mbrojtjes penalo-juridike, për arsye se e quajmë edhe objekt i mbrojtjes. Çdo vepër penale ka objektin e vet të mbrojtjes, ashtu që është e pakuptimtë të ekzistojë vepër pa objekt të mbrojtjes! Objekti i mbrojtjes është nocion abstrakt, gjenerik, i cili e përfshin idenë e të mirës juridike, vlerës apo interesit që mbrohet me inkriminimin konkret. Vepra penale mund të ketë më tepër objekte të mbrojtjes. Por shpeshherë si objekt i një vepre penale paraqitet e mira juridike që në vete konsumon edhe të mira tjera juridike. Ashtu p.sh. në veprën e përdhunimit (n.186), liria e gjinisë si objekt i mbrojtjes i konsumon në vete nderin dhe autoritetin, dhe në masë të caktuar integritetin trupor të viktimës!<sup>49</sup>

Gjitha llojet e veprave penale që janë të parapara në legjislacionin tonë penal, pa marrë parasysh se cila është lënda apo objekti që mbrohet nga to dhe pa dallim nga afërsia dhe ngjashmëria e tyre, janë të radhitura në grupe dhe përbëjnë kapituj më vete të veprave penale. Radhitja taksative e veprave penale në Kodin tonë Penal, është bërë në bazë të shkallës së rrezikshmërisë shoqërore dhe peshës së vlerës së objektit apo të asaj të mire juridike që i kushtohet mbrojtje nga veprat penale.

---

<sup>47</sup> Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010, fq.127.

<sup>48</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë, 2012, fq.186.

<sup>49</sup> Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010, fq.129.



## **5. Subjekti i veprës penale të dhunimit sipas nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë**

Personi që kryen veprë penale quhet subjekt i veprës penale. Në të drejtën penale bashkëkohore është përvetësuar mendimi se subjekt i veprës penale mund të jetë vetëm njeriu-personi fizik. Përveç atyre që ndërmarrin drejtpërdrejt veprimin e kryerjes, subjekte të veprës penale konsiderohen edhe shtytësit, ndihmësit dhe organizatorët e shoqatës kriminale.<sup>50</sup>

Kryerës i veprës penale çdoherë është personi fizik, kurse nën kushte të caktuara edhe personi juridik! Koncepti i së drejtës penale i bazuar në veprën, nocioni i veprës penale si sjellje e njeriut me të cilën shkelen ndalesat penalo-juridike dhe koncepti i përgjegjësisë penale individuale dhe subjektive janë kornizë e përgjithshme kriminalo-politike dhe penalo-juridike në të cilën vendoset edhe nocioni për kryerësin. Ai është nocioni ontologjik që lidh e drejtën penale me sjelljet individuale të individëve. Personi fizik njëkohësisht është subjekt aktiv i veprës penale, por edhe i pasojave të tij, në lloj dënimi apo sanksioni tjetër penalo-juridik që e godasin kryerësin e veprës.<sup>51</sup>

Subjekt aktiv i veprës penale mund të jetë cilido person fizik i aftë të ndërmerr ndonjë veprim, pa marrë parasysh gjininë apo moshën. Në të drejtën penale kryerësi hyn me 14 vjet të mbushura. Ndaj të miturit i cili në kohën e kryerjes së veprës nuk ka mbushur 14 vjet, nuk mund të zbatohen sanksione penalo-juridike. Përveç ndarjes së bazuar në moshën e kryerësit, rëndësi të posaçme penalo-juridike ka dallimi i kryerësve të përgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm. Kjo është e potencuar në legjislacionet në të cilat papërgjegjshmëria përjashton ekzistimin e veprës penale (i tillë është legjislacioni kroat). Sipas formulimit të pranueshëm në më shumë legjislacione, KPM personat e papërgjegjshëm i trajton si kryerës të veprave penale.<sup>52</sup>

KPM ka paraparë: neni 12, Përgjegjshmëria:

- (1) Nuk është i përgjegjshëm kryerësi i cili gjatë kohës së kryerjes së veprës penale nuk ka mundur ta kuptojë rëndësinë e veprës së vet apo nuk ka mundur t'i kontrollojë veprimet e

<sup>50</sup> Salihu, Ismet, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë, 2012, fq.189.

<sup>51</sup> Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010, fq.130.

<sup>52</sup> Po aty.

veta për shkak të sëmundjes së përhershme apo të përkohshme shpirtërore, për shkak të çrregullimit të përkohshëm shpirtëror ose të zhvillimit të ngecur shpirtëror (papërgjegjshmëria) ose të pengesave tjera të rënda shpirtërore.

- (2) Kryerësi i veprës penale, aftësia e të cilit për ta kuptuar rëndësinë e veprës së vetë ose aftësia për t'i kontrolluar veprimet e veta ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkak të ndonjë gjendjeje të paragrafit 1, mund të ndëshkohet më butë (përgjegjshmëri esencialisht e zvogëluar).<sup>53</sup>

E drejta penale njihet edhe një lloj tjetër subjekti, fjala vjen për subjektin pasiv. Subjekt pasiv është personi i cili është i dëmtuar apo rrezikuar nga vepra penale, apo është ndeshur me pasojën e veprës, ndryshe njihet edhe si viktimë e veprës penale.

---

<sup>53</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë neni 12.

## KAPITULLI I TRETË

### VEPRAT PENALE TË DHUNIMIT NË TERRITORIN E GJYKATËS SË APELIT NË GOSTIVAR PËR PERIUDHËN KOHORE 2014-2018

#### 1. Format e veprës penale të dhunimit

E drejta penale bashkëkohore në deceniet e fundit ka pësuar ndryshime rrënjësore lidhur me botëkuptimet se çka është e natyrshme dhe çka s'është e natyrshme në sferën e jetës seksuale. Sjelljet e kësaj sfere kanë qenë të inkriminuara dhe të dënueshme edhe në kohërat më të hershme nga legjislacionet penale, duke mos e pasur parasysh se i ka kryer individi me pëlqimin e personit tjetër apo jo. Në këtë mënyrë kanë ndryshuar qëndrimet dhe sanksionet lidhur me sjelljet e caktuara të kësaj sfere të jetës intime.

Ndryshimet qenësore në kuptimin, konceptin dhe qëndrimet ndaj jetës seksuale ka filluar pas revolucionit qytetar në shekullin XVIII, ku disa ndalesa penale janë hequr, disa veprime të turpshme janë kufizuar.<sup>54</sup>

Rregullativa bashkëkohore penalo-juridike më shumë është e koncentruar në ato sjellje të integritetit seksual të cilat ndërmerren në kundërshtim apo pa pëlqimin e palës tjetër, apo në ato sjellje të cilat cenojnë integritetin seksual të njeriut si pjesë përbërëse e integritetit të përgjithshëm personal dhe të lirive të njeriut dhe të drejtës për të zgjedhur vet partnerin. Kjo, vetëm kur trajtohen personat e rritur, ndërsa kur bëhet fjalë për fëmijët, mbrojtja penalo-juridike është më gjithëpërfshirëse dhe më e fuqishme për mbrojtjen e integritetit seksual.

Çdo shoqëri bashkëkohore që pretendon mbrojtjen e individit gjithashtu, në plan të parë ka edhe mbrojtjen e moralit dhe dinjitetit të cilëve, njëkohësisht shteti kujdeset t'u ofrojë edhe mbrojtjen penalo-juridike nëpërmjet parashikimit të veprave penale që cenojnë moralin dhe dinjitetin.<sup>55</sup> Duke u bazuar në konceptet bashkëkohore një frymë të tillë sjell edhe Kodi Penal i ynë, i cili

---

<sup>54</sup> Salihu, Ismet, Zhitia, Hilmi, Hasani, Fejzullah, Komentar i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq.605.

<sup>55</sup> Zejneli, Ismail, E Drejta Penale e Posaçme, Tetovë, 2007, fq.79.

përfshinë koncepte lidhur me të drejtën e njeriut që të vendos lirisht për jetën e tij seksuale, thënë ndryshe për dinjitetit dhe integritetin seksual.

***Vepra penale e dhunimit*** – nga vet emërtimi i kësaj vepre nënkuptojmë vepër tipike të detyrimit dhe kanosjes ndaj personit tjetër me qëllim të kryerjes së aktit seksual. Dhunimi është njëra ndër veprat më të rënda kundër integritetit seksual.

Forma themelore e kësaj vepre penale konsiston në detyrimin dhe kërcënimin e personit tjetër me qëllim të kryerjes së aktit seksual pa pëlqimin e tij. Nga përkufizimi i kësaj vepre penale themelore, bazike shihet se është vepër penal e përbërë (jo e drejtë) dhe përmban detyrimin dhe aktin seksual. Duke u bazuar në sanksionet për këtë lloj të veprës penale është e dënueshme dhuna, keqpërdormi i pozitës dhe shfrytëzimi i pozitës së pafavorshme të viktimës, me çrast mbrohet lira e vendosjes se kur dhe me kënd do të ketë marrëdhënie seksuale një person.

Në nenin 186 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, është përcaktuar përkufizimi i kësaj vepre penale, ku thuhet: *“Ai i cili tjetrit me përdorim të forcës ose kërcënimit se drejtpërdrejtë do të atakojë ndaj jetës apo trupit të tij, ose ndaj jetës dhe trupi të ndonjë të afërmi të tij, do ta detyrojë në kryerje të aktit seksual do të dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.”*

Këtë vepër penale e kryen ai që me përdorimin e forcës ose me kërcënim sulmon jetën ose trupin e tjetrit, ndërsa tjetri detyrohet në aktin seksual. Detyrimi në aktin seksual ose veprimi tjetër gjinor kryhet me përdorimin e forcës dhe të kërcënimit. *Dhunimi* domethënë mosekzistimi i dëshirës dhe vullnetit të njërit person për aktin seksual. Kundërshtimi të cilin e jep personi i dhunuar duhet të jetë serioz dhe i vazhdueshëm, pasi dhunimi nuk ekziston nëse personi me të gjitha fuqitë e tij nuk mundohet ta kundërshtojë sulmuesin. Subjekt pasiv është çdo person i gjinisë femërore ose mashkullore, mbi 14 vjet që me dhunë detyrohet në aktin seksual.<sup>56</sup> Vepra konsiderohet se është kryer nëse me përdorimin e forcës dhe kërcënimit është kryer akti seksual.

Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm se me përdorimin e forcës dhe kërcënimit është duke kryer aktin seksual.

Në paragrafin 3 (neni 186-Dhunimi) është paraparë forma më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse dikush e detyron personin tjetër me dhunë apo me kërcënim në aktin

---

<sup>56</sup> Zejneli, op. cit., fq.80.

seksual dhe me këtë rast i shkaktohet lëndim i rëndë trupor, vdekja apo pasoja tjera të rënda, apo nëse vepra penale është kryer nga më shumë persona (bashkëkryerja) ose në mënyrë të vrazhdë apo të përbuzur, kryerësi i veprës penale do të dënohet me burgim prej së paku katër (4) vjet burgim.<sup>57</sup>

Duke pasur parasysh natyrën e këtij punimi, dhe rëndësinë e veprës penale si një vepër mjaftë e rëndë dhe nënçmuese, për të pasqyruar në formë më të detajuar dhe rrënjësore kamë hulumtuar dhe analizuar të dhëna statistikore për periudhën kohore 2014-2018 në Gjykatën themelore në Gostivar dhe në Gjykatën e Apelit në Gostivar, gjithashtu në mënyrë të veçantë kamë analizuar vendimet gjyqësore, apo më mirë thënë dosjet apo lëndët që kishin arritur në Gjykatën e Apelit në Gostivar, me të gjitha shkresat për periudhën 2014-2018.

Së pari e pashë të udhës që ti kushtojmë një pasqyrë veprave penale të dhunimit në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë për periudhën kohore 2014-2018, e më pas në vazhdim do të paraqes të dhëna kryesisht nga Gjykata e Apelit në Gostivar.

**Tabela 1.** Në vijim përmes tabelës do të prezantojmë të gjitha rastet e Veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, e në veçanti të veprës penale të dhunimit në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë për periudhën kohore 2014-2018.<sup>58</sup>

	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor</b>	49	56	39	38	nuk ka të dhëna
<b>Vepra penale e dhunimit</b>	15	24	14	13	nuk ka të dhëna

Nga tabela e më sipërme vërejmë të gjitha rastet e kryera të veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor në harkun kohor 2014-2018 në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë,

<sup>57</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 186, paragrafi 3.


<sup>58</sup> www.stat.gov.mk.

dhe veçanërisht të veprës penale të dhunimit. Me këtë rast paraqesim të dhënat në vijim, edhe atë:


**Në vitin 2014,** janë kryer dyzet e nëntë (49) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, prej të cilave kanë ndodhur pesëmbëdhjetë (15) raste të veprës penale të dhunimit, **në vitin 2015,** janë kryer pesëdhjetë e gjashtë (56) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, prej të cilave kanë ndodhur njëzet e katërt (24) raste të veprës penale të dhunimit, **në vitin 2016,** janë kryer tridhjetë e tetë (38) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, prej të cilave kanë ndodhur katërmëdhjetë (14) raste të veprës penale të dhunimit, **në vitin 2017,** janë kryer tridhjetë e tetë (38) vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, prej të cilave kanë ndodhur trembëdhjetë (13) raste të veprës penale të dhunimit. Sa i përket **vitet 2018,** ende nuk janë përpunuar të dhënat nga Enti shtetëror statistikor.

Në pikëpamje grafike, në paraqitjen e më poshtme do të paraqiten në grafikun 1- rastet e veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor , të kryera në territorin e Republikës së Maqedonisë në periudhën kohore 2014-2018 të shprehura në përqindje, dhe në grafikun 2 rastet e veprave penale të dhunimit të kryera në vendin tonë për po të njëjtën periudhë kohore.

**Grafiku 1.**



**Grafiku 2.**



**Grafiku 1.** Siç vërehet nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore rezulton se në totalin e rasteve të kryera që hyjnë në domenin e veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor në pesë vjeçarin 2014-2018 prin viti 2015 me 31 (%) për qind, më pas viti 2014 me 27 (%) për qind, dhe vitet 2016 dhe 2017 me nga 21 (%) për qind. Me ç'rast vërejmë që numër më i lartë i

veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor janë kryer në vitin 2015, e më pak në vitin 2016. **Grafiku 2.** Nga paraqitja grafike e të dhënave statistikore rezulton se: në vitin 2014 janë kryer 23 (%) për qind vepra penale të dhunimit, në vitin 2015 janë kryer 36 (%) për qind vepra penale të dhunimit, në vitin 2016 janë kryer 21 (%) për qind vepra penale të dhunimit, në vitin 2017 janë kryer 20 (%) për qind vepra penale të dhunimit. Siç vërejmë numër më i madh i kryerjes së veprave penale të dhunimit janë shënuar në vitin 2015 edhe atë 36% ndërsa numër më i ulët i kryerjes së veprave penale të dhunimit janë shënuar në vitin 2017. Dhe siç cekëm më lartë për vitin 2018 ende nuk janë përpunuar të dhënat nga Enti Statistikor për atë arsye vitin 2018 është përfaqësuar me 0% që nga kjo nuk nënkupton që në vitin 2018 nuk është kryer asnjë veprë penale e dhunimit.

Më poshtë, nëpërmjet **tabelës 2**, do të paraqesim të dhëna statistikore të marra nga Gjykata themelore në Gostivar<sup>59</sup>, për rastet e pranuar në këtë gjykatë, për të cilat është ngritur aktakuzë që për lëndë kanë kryerjen e veprës penale të dhunimit, dhe po ashtu numrin e rasteve të gjykuara, raste këto që kanë mbaruar me një vendim gjyqësor në po këtë gjykatë për veprën penale të dhunimit për periudhën kohore 2014-2018, në rajonin e komunës së Gostivarit.

<b>Vepra penale e dhunimit</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>
<b>Rastet e pranuar</b>	2	3	2	2	2
<b>Rastet e gjykuara</b>	3	4	2	2	1

Nga tabela e mësipërme vërejmë procesin e rasteve të pranuar, pra të rasteve për të cilat është ngritur aktakuzë, në Gjykatën themelore në Gostivar në periudhën 2014-2018 dhe procesin e rasteve të gjykuara, për të cilat është marrë një vendim gjyqësor në Gjykatën themelore në Gostivar për po të njëjtën periudhë kohore.

**Në vitin 2014:** janë pranuar dy raste të veprës penale të dhunimit, ndërkaq janë gjykuar tre raste, **në vitin 2015** janë pranuar tre raste të veprës penale të dhunimit, ndërsa janë gjykuar katër raste, **në vitin 2016** janë pranuar dy raste të veprës penale të dhunimit ndërsa janë gjykuar dy raste, **në**

<sup>59</sup>Të dhëna të siguruara nga Gjykata themelore në Gostivar.

**vitin 2017** janë pranuar dy raste të veprës penale të dhunimit ndërsa janë gjykuar dy raste, **në vitin 2018** janë pranuar dy raste të veprës penale të dhunimit ndërsa është gjykuar vetëm një rast. Nga tabela që analizuam më lartë vërejmë që në vitin 2015 janë kryer ose thënë ndryshe në Gjykatën themelore në Gostivar janë pranuar (aktakuzë) më shumë raste të veprës penale të dhunimit edhe atë 3, dhe në po të njëjtin vit janë gjykuar më shumë raste të veprës penale të dhunimit edhe atë 4. Vitet 2014,2016,2017 dhe 2018 janë të njëjtë në pranimin e rasteve të veprës penale të dhunimit edhe atë me nga dy raste, ndërsa numër më i ulët i rasteve të gjykuara vërehet në vitin 2018 edhe atë vetëm një rast. Nga kjo rezulton se viti 2015 kryeson në listë për nga kryerja e veprave penale të dhunimit me gjithsej 3 raste të pranuar, dhe 4 të gjykuar.

Nëpërmjet **tabelës 3**, për të pasqyruar në mënyrë më të thellësuar dhe më gjithë përfshirëse, për arsye se edhe vetë tema e këtij punimi është e bazuar dhe hulumtimet do të orientohen në rrethin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, duke pasur parasysh që kjo gjykatë mbulon territorin apo është kompetente dhe mbulon disa gjykata themelore edhe atë: Gjykatën themelore në Gostivar, Gjykatën themelore në Tetovë, Gjykatën themelore në Kërçovë dhe Gjykatën themelore në Dibër, në vazhdim do të paraqes të dhëna statistikore të marra nga Gjykata e Apelit në Gostivar për veprën penale të dhunimit në periudhën kohore 2014-2018, edhe atë për numrin total të veprave penale të dhunimit të paraqitura në këtë gjykatë apo numrit të ankesave që janë adresuar në këtë gjykatë kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë, dhe llojin e vendimit të Gjykatës së Apelit.<sup>60</sup>

<b>Vepra penale e dhunimit</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>
<b>Ankesat e paraqitura kundër vendimeve të gjykatave themelore</b>	3	3	7	2	5
<b>Gjithsej lënd për periudhën kohore 2014-2018</b>	20				

<sup>60</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 2.09.2019/3.09.2019.



Nga të dhënat statistikore të paraqitura më lartë vërejmë që numri i ankesave kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë rezulton kështu: **në vitin 2014,** janë paraqitur tre raste, **në vitin 2015,** janë paraqitur tre raste, **në vitin 2016,** janë paraqitur shtatë raste, **në vitin 2017,** janë paraqitur dy raste, dhe **në vitin 2018,** janë paraqitur pesë raste. Me më shumë raste të paraqitura rezulton viti 2016-(7) raste, më pas viti 2018-(5) raste, vitet 2014 dhe 2015 me nga (3) raste, dhe me më pak raste viti 2017 edhe atë (2) raste.

**Tabela 4.** Në vijim do të paraqesim llojet e vendimeve të gjykatave të shkallës së parë, për rastet për të cilat është paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit në Gostivar.<sup>61</sup>

<b>Vepra penale e dhunimit</b>	
<b>Viti</b>	<b>Lloji i vendimit gjyqësor i gjykatave themelore</b>
2014	Aktgjykim lirues
2014	Aktgjykim lirues
2014	Aktgjykim dënues
2015	Aktgjykim dënues
2015	Aktgjykim dënues
2015	Aktgjykim dënues
2016	Aktgjykim lirues
2016	Aktgjykim lirues
2016	Aktgjykim dënues
2016	Aktgjykim dënues
2016	Aktgjykim dënues
2016	Aktgjykim lirues
2016	Aktgjykim lirues
2017	Aktgjykim lirues
2017	Aktgjykim dënues
2018	Aktgjykim dënues

<sup>61</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 2.09.2019/3.09.2019.

2018	Aktgjykim lirues
2018	Aktgjykim dënues (masa e sigurisë)
2018	Aktgjykim dënues
2018	Aktgjykim lirues

Nga tabela e mësipërme vërejmë që gjykatat themelore gjatë viteve 2014-2018 kanë marrë llojet e vendimeve gjyqësore, edhe atë si: **në vitin 2014**, dy aktgjykime liruese dhe një aktgjykim dënues; **në vitin 2015**, tre aktgjykime dënuese; **në vitin 2016**, katër aktgjykime liruese dhe tre aktgjykime dënuese; **në vitin 2017**, një aktgjykim lirues dhe një aktgjykim dënues; **në vitin 2018**, dy aktgjykime liruese dhe tre aktgjykime dënuese. Prej këtyre të dhënave mund të konstatojmë se gjatë periudhës kohore 2014-2018 janë shqiptuar apo janë marrë nëntë (9) aktgjykime liruese dhe njëmbëdhjetë (11) aktgjykime dënuese, prej gjithsej njëzet (20) rasteve të paraqitura.

**Tabela 5.** Më poshtë do të paraqesim vendimet e Gjykatës së Apelit në Gostivar për periudhën kohore 2014-2018 lidhur me vendimet e shkallës së parë, konkretisht vendimet e Gjykatës së Apelit (shkallës së dytë) lidhur me ankesë.<sup>62</sup>

<b>Vepra penale e dhunimit</b>	
<b>Viti</b>	<b>Llojet e vendime të Gjykatës së Apelit lidhur me ankesë</b>
2014	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2014	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2014	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2015	Ankesa <b>pranohet</b> , aktgjykimi i shkallës së parë kthehet në <b><u>rigjykim</u></b>
2015	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>

<sup>62</sup> Të dhëna të siguruar nga Gjykata e Apelit, më datë 2.09.2019/3.09.2019

2015	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2016	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2016	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2016	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2016	Ankesa <b>pranohet</b> , aktgjykimi i shkallës së parë kthehet në <b><u>rigjykim</u></b>
2016	Ankesa <b>pranohet</b> , gjykata e shkallës së dytë <b><u>ndryshon</u></b> aktgjykimin e shkallës së parë
2016	Ankesa <b>pranohet</b> , aktgjykimi i shkallës së parë kthehet në <b><u>rigjykim</u></b>
2016	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2017	Ankesa <b>pranohet</b> , aktgjykimi i shkallës së parë kthehet në <b><u>rigjykim</u></b>
2017	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2018	Ankesa <b>pranohet</b> , aktgjykimi i shkallës së parë kthehet në <b><u>rigjykim</u></b>
2018	Ankesa <b>pranohet</b> , gjykata e shkallës së dytë <b><u>ndryshon</u></b> aktgjykimin e shkallës së parë
2018	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2018	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>
2018	Ankesa refuzohet si <b>e pabazë</b> , aktgjykimi i shkallës së parë <b><u>vërtetohet</u></b>

Siç vërejm nga tabela më lartë Gjykata e Apelit, lidhur me vendimet me ankesë ka marrë vendim edhe atë: **në vitin 2014**, ka **refuzuar** ankesat si të pabaza dhe ka **vërtetuar** aktgjykim e shkallës së parë, tre raste (3); **në vitin 2015**, në dy (2) raste ka **refuzuar** ankesën si të pabazë dhe ka **vërtetuar** aktgjykim e shkallës së parë, ndërsa vetëm në një (1) rast ka **pranuar** ankesën dhe aktgjykimi i shkallës së parë është kthyer në **rigjykim**, **në vitin 2016**, ka **refuzuar** ankesat si të pabaza dhe ka **vërtetuar** aktgjykimin e shkallës së parë në katër (4) raste, ndërsa në një (1) rast ka **pranuar** ankesën dhe ka kthyer aktgjykimin e shkallës së parë në **rigjykim**, si dhe në një (1) rast ka **pranuar** ankesën dhe gjykata e shkallës së dytë ka **ndryshuar** aktgjykim e shkallës së parë, **në vitin 2017**, në një (1) rast ka **pranuar** ankesën dhe aktgjykimin e shkallës së parë e ka kthyer në **rigjykim**, ndërsa në një (1) rast ka **refuzuar** ankesën si të pabazë dhe ka **vërtetuar** aktgjykimin e shkallës së parë, **në vitin 2018**, në tre (3) raste ka **refuzuar** ankesën si të pabazë

dhe ka **vërtetuar** aktgjykimin e shkallës së parë, në një (1) rast ka **pranuar** ankesën dhe e ka kthyer aktgjykimin e shkallës së parë në **rigjykim**, dhe në një (1) rast ka **pranuar** ankesën dhe ka **ndryshuar** aktgjykimin e shkallës së parë.

## 2. KRYERËSIT E VEPRAVE PENALE TË DHUNIMIT

### Vështrime të përgjithshme

Në literaturën kriminologjike, si çështje që ka të bëjë me faktorin subjektiv e sidomos me personalitetin e delikuentit, konsiderohet edhe klasifikimi dhe tipologjia e tyre. Në të vërtetë, gjatë paraqitjes së faktorëve subjektivë, sidomos karakterit, temperamentit, emocioneve, shprehive, dhe sëmundjeve të ndryshme psikike, u vërejt se personat delikuent si dhe njerëzit e tjerë normal, dallohen në mes veti për nga shumë veti anatomike-fizike, bio-psikike dhe bio-sociale. Të gjitha vetitë dhe cilësitë e caktuara subjektive, e karakterizojnë një delikuent si personalitet dhe si individ të veçantë. Çështja e klasifikimit apo tipologjisë së delinkuentëve, në punimet e mëhershme kriminologjike, ka qenë në qendër të vëmendjes. Kësaj çështjeje veçmas i kanë kushtuar kujdes të madh drejtimet antropologjike, biologjike dhe psikobiologjike. Me klasifikimin e delinkuentëve dhe kriminelëve janë marrë shumë autorë, dhe këtë e kanë konsideruar si çështje me rëndësi në shpjegimin e shkaqeve të kriminalitetit, ndërsa, autorë të tjerë që kanë përkrahur konceptet juridike dhe sociologjike, me klasifikim dhe tipologji të kriminelëve janë marrë më pak dhe kësaj çështjeje nuk i kanë kushtuar rëndësi të veçantë.<sup>63</sup>

Në punimet e disa autorëve theksohet se çështja e klasifikimit dhe tipologjisë së delinkuentëve dhe kriminelëve, ka një rëndësi të veçantë teorike dhe praktike. Problemi i klasifikimit shtrohet në rend të parë për nevojat e definimit dhe të përcaktimit të përgjegjësisë penale, fajësisë apo pafajësisë dhe elementeve të tjera subjektive që kanë të bëjnë me shqiptimin dhe ekzekutimin e sanksioneve të ndryshme penale. Klasifikimi dhe tipologjia e delinkuentëve ka rëndësi të madhe për individualizimin e dënimit dhe individualizimin e tretmanit të personave të dënuar gjatë

---

<sup>63</sup> Gassin R., Criminologie, Paris, 1996, fq.411-414.

procesit të rehabilitimit dhe risocializimit të tyre. Nga ana tjetër, klasifikimi i tillë kontribuon edhe në pengimin e disa sjelljeve kriminale.<sup>64</sup>

Klasifikimi dhe tipologjia e kriminelëve ka rëndësi të madhe, pra edhe nga aspekti kriminologjik edhe nga aspekti penalogjik. Njohja e tipave të delinkuentëve dhe kriminelëve, posaçërisht vetive dhe cilësive të tyre themelore subjektive, ka rëndësi të veçantë në luftimin dhe pengimin e kriminalitetit në një vend të caktuar. Pa njohjen e tipave të ndryshëm të delinkuentëve apo personave të dënuar, nuk mund të zbatohet me sukses klasifikimi i tyre nëpër ente të caktuara ndëshkimore-përmirësuese dhe as të realizohet procesi i rehabilitimit dhe risocializimit të tyre.<sup>65</sup>

Në të drejtën penale dhe teorinë juridiko-penale, klasifikimi i kriminelëve ka pasur për qëllim të përcaktojë individualizimin e përgjegjësisë së tyre penale për veprat e kryera. Ky klasifikim, shpeshherë për bazë i ka emërtimet e veprave penale apo grupeve dhe nëngrupeve të veprave penale të parashikuara sipas dispozitave të kodeve dhe ligjeve penale pozitive. Kësisoj kemi ndarjen apo klasifikimin në: kriminel politikë, kriminel agresivë, kriminel të dhunës, kriminel seksual, kriminel kundër pronës etj.<sup>66</sup>

#### **a. Moshë e kryerësve të veprës penale të dhunimit**

Moshë është karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat e shumta statistikore dhe praktika gjyqësore si dhe nga shënimet e kërkimeve empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren personat e moshave të ndryshme. Mirëpo, edhe në këtë drejtim vërehen disa ligjshmëri dhe kategori të moshave të cilat marrin më tepër pjesë në kryerjen e sjelljeve kriminale. Siç dihet, moshë e kryerësve të veprave penale përkatësisht sjelljeve kriminale, mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Sipas ligjeve pozitive penale të vendeve të ndryshme, moshë e kryerësve të veprave penale, ndahet në moshë të personave të mitur dhe personave të rritur.<sup>67</sup> Mirëpo, brenda këtyre dy ndarjeve kryesore, kemi edhe ndarjet tjera. Moshë e mitur ndahet në të mitur të rinj, e cila përfshin moshën prej 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshin moshën 16-18 vjet. Kategoria e personave deri në

---

<sup>64</sup> Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2007, fq.235.

<sup>65</sup> Halili, op. cit., fq.381.

<sup>66</sup> Po aty.

<sup>67</sup> Josepf, F., Criminology, Wadsworth-Belmont, 2000, p.106-108.

moshën 14- vjeçare, në literaturën kriminologjike dhe juridiko penale trajtohet si moshë e fëmijëve dhe zakonisht personat e kësaj moshe nuk i nënshtrohen trajtimeve juridiko-penale. Këta persona siç dihet, nuk janë të përgjegjshëm nga aspekti juridiko-penal. Ndaj tyre, nëse kryejnë veprime delikente, zakonisht ndërmerren masa të kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ana e familjes dhe organeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtjen e fëmijëve dhe me kujdes social. Mirëpo në disa shtete, në këtë drejtim bëhen edhe përjashtime. Shpeshherë, në disa shtete të Lindjes, mosha e personave prej 14-10 vjet i nënshtrohen përgjegjësisë së caktuar penale.<sup>68</sup>

Si moshë e rritur konsiderohet mosha prej 18 vjet e deri në vdekje të individit. Mirëpo pjesëmarrja e kësaj moshe, pra moshës së rritur, nuk është njësoj në të gjitha fazat e jetës së këtyre individëve. Në literaturën kriminologjike dhe kërkimet praktike, ndarja dhe kategorizimi i moshave të personave të rritur zakonisht bëhet në dekada, p.sh. ndahen në faza prej 10 apo 20 vjetësh, apo edhe më pak. Kësisoj flitet për moshën e personave të rritur prej 18-25 vjet si moshë e veçantë, pastaj mosha prej 25-30, mosha 30-40 vjet, mosha 40-50, mosha 50-60 dhe, në fund, mosha më e vjetër se 60 vjet.<sup>69</sup>

**Tabela 6.** Në vijim përmes tabelës së mëposhtme do të paraqesim të dhënat në lidhje me moshën e kryerësve të veprës penale të dhunimit, në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar në periudhën kohore 2014-2018, si vijon:<sup>70</sup>

<b>Mosha e kryerësve të veprës penale të dhunimit</b>	
prej 20-25 vjet	1 person
prej 25-30 vjet	3 persona
prej 30-40 vjet	6 persona
prej 40-50 vjet	7 persona
prej 50-60 vjet	2 persona
mbi 60 vjet	1 persona
Gjithsej	20 persona

<sup>68</sup> Halili, op. cit., 2008, fq.130.


<sup>69</sup> Po aty.

<sup>70</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë: 2.09.2019/3.09.2019.

Në tabelën e mësipërme sikurse edhe vihet re, në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar në periudhën kohore 2014-2018 ka pasur gjithsejtë njëzet (20) kryerës të veprës penale të dhunimit, kategorizimi i grupmoshave është bërë në bazë të të dhënave të fituara, duke kapur kufijtë e arsyeshëm për këtë lloj kategorizimi, dhe pragun e poshtëm e kemi marrë moshën njëzet (20) vjeçare, nga hulumtimet e bëra kemi përfunduar që: moshë nga njëzet (20) deri në moshën njëzet e pesë (25) ka qenë e përfshirë vetëm në një (1) rast, grupmosha nga njëzet e pesë (25) deri në moshën tridhjetë (30) ka qenë e përfshirë në tre (3) raste, moshë prej tridhjetë (30) deri në moshën dyzet (40) ka qenë e përfshirë në gjashtë (6) raste, moshë nga dyzet (40) deri në moshën pesëdhjetë (50) ka qenë e përfshirë në shtatë (7) raste, moshë prej pesëdhjetë (50) deri në moshën gjashtëdhjetë (60) ka qenë e përfshirë në dy (2) raste, dhe grupmosha mbi gjashtëdhjetë (60) vjet ka qenë e përfshirë vetëm në një (1) rast.

Nga hulumtimet dhe analizat e bëra, mund të përfundojmë së grupmosha më aktive dhe me pjesëmarrje më të lartë në kryerjen e veprës penale të dhunimit ka qenë moshë prej dyzet (40) deri në moshën pesëdhjetë (50) vjet, më pas kryeson grupmosha prej tridhjetë (30) deri në moshën dyzet (40) vjet, grupmoshat njëzet e pesë (25) deri në moshën tridhjetë (30) vjet marrin pjesë në tre (3) raste, ndërsa pjesëmarrje më të ulët kanë grupmoshat njëzet (20) deri njëzet e pesë (25) vjet dhe grupmoshat mbi gjashtëdhjetë (60) vjet.

**Grafiku 3.** Nga pikëpamja grafike, në grafikun e mëposhtëm do të paraqesim të dhënat statistikore, të shprehura me përqindje, për moshën e kryerësve të veprës penale të dhunimit, në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, për periudhën kohore 2014-2018.



Nga grafikoni i shprehur më lartë janë paraqitur të dhënat në lidhje me grupmoshat e kryerësve të veprës penale të dhunimit. Në këtë analizë bazë kemi marrë grupmoshën njëzet (20) vjeçare, dhe kemi fituar rezultatet e shprehura në përqindje siç vijon: grupmosha njëzet (20) deri njëzet e pesë (25) vjeçare ka qenë e përfshirë në pesë (5%) për qind, grupmosha prej njëzet e pesë (25) deri në moshën tridhjetë (30) vjeçare ka qenë e përfshirë me pesëmbëdhjetë (15%) për qind, grupmosha prej tridhjetë (30) vjeç deri në moshën dyzet (40) vjeç ka qenë e përfshirë tridhjetë (30%) për qind, grupmosha prej dyzet (40) deri pesëdhjetë (50) vjeç ka qenë e përfshirë tridhjetë e pesë (35%) për qind, grupmosha prej pesëdhjetë (50) deri në moshën gjashtëdhjetë (60) vjeçare ka qenë e përfshirë me dhjetë (10%) për qind, dhe grupmosha mbi gjashtëdhjetë (60) vjeçare ka qenë e përfshirë me pesë (5%) për qind. Nga kjo mund të konkludojmë se grupmosha më aktive e shprehur në përqindje për pjesëmarrjen në kryerjen e veprës penale të dhunimit është grupmosha prej dyzet (40) deri në moshën pesëdhjetë (50) vjeç me tridhjetë e pesë (35%) për qind, dhe grupmosha tridhjetë (30) deri në moshën dyzet (40) vjeç me tridhjetë (30%) për qind, e me pjesëmarrje më të ulët në kryerjen e veprës penale të dhunimit është grupmosha njëzet (20) deri njëzet e pesë (25) vjeç dhe grupmosha mbi gjashtëdhjetë vjeçare me nga pesë (5%) për qind, pjesëmarrje.

## **b. Gjina e kryerësve të veprës penale të dhunimit**

Në pjesëmarrjen e kriminalitetit, gjithashtu vështrohet në literaturën kriminologjike dhe interpretohet nga këndvështrime të ndryshme. Ekzistojnë një përshtypje e përgjithshme, në bazë të të dhënave statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore. Sipas kërkimeve kriminologjike të bëra në shumë vende të botës në SHBA, Gjermani, Francë, Angli, Japoni, dhe vende të tjera, deri në kohën më të re, gjinia mashkullore, përkatësisht kryerësit e veprave kriminale të gjinisë mashkullore, kanë dominuar në mënyrë absolute. Mirëpo tani në shoqërinë bashkëkohore, gjendja ka ndryshuar dukshëm ngase edhe femrat, gjithnjë e më tepër, po marrin pjesë në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale.<sup>71</sup> Femra merr pjesë më pak në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale ngase ajo në të kaluarën

---

<sup>71</sup> Ignjatović, D. Bekarijine ideje o krivicnom pravu, Arhiv, Beograd, 1998, nr.4., Kriminologija, Beograd, 2001, st. 191-192.



ka qenë më pak e përfshirë në aktivitetet e ndryshme në shoqëri. Ato më tepër kanë qenë të preokupuara në lindjen, rritjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve dhe anëtarëve të familjes e më pak janë marrë me aktivitete dhe punë jashtë familjes, të cilat domosdo do ti futnin në situata të ndryshme që do të sjellin deri te kriminaliteti i tyre. Me emancipimin dhe kyçje gjithnjë e më të madhe të femrës në të gjitha sferat e jetës dhe të punës, vërehet edhe shtimi dhe rritja pjesëmarrjes së saj në aktivitetet kriminale. Kështu që, dukshëm vihen në pyetje disa konstatime teorike në kriminologji se gjoja kriminaliteti është dukuri tipike e meshkujve dhe se femrat për shkak të konstruksionit të tyre biofizik dhe biopsikik, objektivist, kryejnë më pak krime.<sup>72</sup>

**Tabela 7.** Nëpërmjet tabelës së më poshtme do të paraqesim të dhëna në lidhje me gjininë e kryerësve të veprës penale të dhunimit, në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, për periudhën kohore 2014-2018.<sup>73</sup>

<b>Gjinia e kryerësve të veprës penale të dhunimit</b>	
Gjinia femërore	0 persona
Gjinia mashkullore	20 persona

Nga tabela e mësipërme, vërejmë që nga gjithsejtë njëzet kryerës të veprës penale në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar në periudhën kohore 2014-2018, nga analiza e detajuar rast pas rasti, rezulton se në kryerjen e veprës penale të dhunimit kanë qenë të përfshirë njëzet (20) persona të gjinisë mashkullore, dhe asnjë person i gjinisë femërore. Nga këto të dhëna statistikore mund të përfundojmë se gjinia mashkullore dominon në kryerjen e veprave penale të dhunimit, ndërsa gjinia femërore është me pjesëmarrje zero.

Nëse duam të shprehim në përqindje pjesëmarrjen e kryerësve të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore, është lehtë e kuptueshme dhe rezultati do të del 100% me 0%, pra lehtë mund të përfundojmë se gjinia femërore nuk është aspak e pranishme në kryerjen e veprës penale të dhunimit, ndërsa kjo vepër penale kryhet veçmas nga kryerësit që i përkasin gjinisë mashkullore.

<sup>72</sup> Halili, op. cit., fq.132.

<sup>73</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 2.09.2019/3.09.2019.

### **c. Përgatitja shkollore e kryerësve të veprës penale të dhunimit**

Arsimimi luan rol të rëndësishëm në parandalimin e krimit nëpërmjet edukimit, përmes plan-programeve mësimore, qasjes ndër-programore dhe aktiviteteve të ndryshme jashtë-programore. Përgatitja shkollore është një faktor me rëndësi në formimin dhe aftësimin e personalitetit të njeriut për jetë më të sigurt dhe më të suksesshme. Enriko Feri thekson se kriminaliteti zvogëlohet në shoqëri krahas rritjes së shkallës së arsimimit të popullsisë zvogëlohet injoranca, mosdija, zhduken veset e këqija etj. Përkundër tij qëndron autori Rafaelo Garafalo, i cili thekson se arsimimi i armatos me dijeni dhe i aftëson individët delikuent që më lehtë pa vështirësi të kryejnë sjellje të ndryshme kriminale. Sipas literaturës kriminologjike janë shpreh pikëpamjet që moti për çështjen e marrëdhënies ndërmjet arsimit si kriter aktivitetit kriminal duke u nisur kryesisht nga përgatitja shkollore dhe shkalla e arsimimit si kriter të personit që ka arsim e kulturë, është i edukuar se me anë të arsimimit të njerëzve luftohen shumë të këqija shoqërore.<sup>74</sup> Me rritjen e arsimimit dhe të shkallës së civilizimit e të qytetërimit, kriminaliteti në forma të ndryshme zvogëlohet. Kjo ide dominon në literaturën e Enriko Ferit, Fergusonit, Mannheimit, Gibbstit, Glueckit etj. Fergusonit shkon aq larg sa mendon se shkalla e ulët e përgatitjes shkollore përbën “faktorin më të fuqishëm të sjelljes delikente që e përbën shkalla e ulët e përgatitjes shkollore”. Autorë të tjerë nuk i japin arsimimit të lartë rëndësi antikriminale, por, përkundrazi mendojnë se arsimimi i lartë mund të jetë faktorë i kriminalitetit me veprimtari antiligjore në forma të ndryshme. Po ashtu, sipas disa autorëve, mjedisi arsimor e pajis personin me njohuri dhe dije të nevojshme për të zhvilluar format e ndryshme të kriminalitetit në disa forma shumë të rrezikshme, ndërsa rrymat optimiste mendojnë se shkalla e arsimimit dhe përgatitjes shkollore ka rëndësi themelore madje të dorës së parë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit, pasi arsimimi sensibilizon njeriun se cilat janë veprimet inkriminuese, kush janë shkaktarët e sjelljeve devijuese dhe të kriminalitetit në përgjithësi në format e saj.<sup>75</sup>

---

<sup>74</sup> Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq.260.

<sup>75</sup> Ibid.

**Tabela 8.** Në vijim përmes tabelës do të prezantojmë të dhëna statistikore për përgaditjen shkollore të kryerësve të veprës penale të dhunimit, në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, për periudhën kohore 2014-2018, nga analizimi dhe studimi i rast pas rasti kemi marrë këto të dhëna si vijon.<sup>76</sup>

<b>Përgatitja shkollore e kryerësve të veprës penale të dhunimit</b>	
Analfabet	3 persona
Arsim fillor	7 persona
Arsim i mesëm	4 persona
Arsim i lartë (Fakultet)	1 person
I panjohur	5 persona

Nga tabela e mësipërme vërejmë, se nga të dhënat statistikore dhe analizimi i çdo rast pas rasti të kryerësve të veprës penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, për periudhën kohore 2014-2018 është pasqyruar se përgatitja shkollore e kryerësve të veprës penale të dhunimit prej gjithsej njëzet (20) kryerësve është si në vijim, edhe atë: tre (3) persona kanë qenë analfabet, shtatë (7) persona kanë pasur të kryer shkollën fillore, katër (4) persona kanë pasur të kryer shkollën e mesme dhe një (1) person ka pasur të kryer nivelin e lartë arsimor apo fakultetin, ndërsa për pesë (5) persona është e panjohur përgatitja shkollore e tyre. Nga këto të dhëna numerike mund të konkludojmë se në pjesëmarrjen e kryerjes së veprës penale të dhunimit më shumë persona janë me nivel të ulët arsimor apo kanë të kryer shkollën fillore edhe atë shtatë (7) persona dhe katër (4) persona kanë të kryer shkollën e mesme. Me pjesëmarrje të ulët në bazë të këtyre të dhënave janë personat me përgatitje të lartë të nivelit arsimor apo që kanë kryer fakultet edhe atë një (1) person. Lehtë mund të arrijmë në përfundim se kryerësit e veprës penale të dhunimit janë persona pa përgatitje shkollore edhe atë vetëm me nivelin e ulët të arsimimit apo kanë të mbaruar vetëm shkollën fillore.

<sup>76</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 2.09.2019/3.09.2019.

#### d. Nacionalitetit i kryerësve të veprës penale të dhunimit

Fillimisht, fjala nacionalitet vjen nga gjuha latine, që domethënë “prejardhje”. Nacionaliteti definohet si dukuri mbi të cilën ndikojnë shumë faktorë, ndërsa edhe ato psikologjik, kulturorë dhe politik. Fillet e para të kësaj dukurie i gjejmë tek revolucioni borgjez në Francë, e cila njihet si burim i saj. Nacionaliteti si mozaik i paramenduar, funksionon në dy kahje të ndryshme, në atë nacional dhe multi-kulturorë. Para së gjithash, kjo dukuri, është e përqëndruar në pjesën emocionale e cila luan rol të rëndësishëm tek individët. Ngritja e këtij faktori, shpesh dëmton mendimet racionale. Gjithashtu, ndodh që kjo dukuri kalon në ekstrem, saqë shkatërron lirinë, idetë liberale, tolerancën etj. Shtetësia, përfaqëson identitetin nacional, e cila njëlloj mund të ndryshohet me vetë dëshirë. Me këtë, ne përfundojmë se teza e nacionalitetit, dallon nga etniteti, dukuri e cila ka për qëllim bashkimin e personave me identitet të njëjtë, e që shpesh shfrytëzojnë politikën si mjet për formimin e një shteti nacional, federatë apo qoftë edhe për fitimin e autonomisë. Ky term (etnitet) ka prejardhje anglofone, megjithëse në fillet e saj nuk mund të definohej. Etniciteti, sipas personave që ndjekin këtë ideologji, apo dukuri, nuk përfitohet, por arrihet nëpërmjet asaj që të kesh lindur në një grup të caktuar etnik. Këtë virtut mund ta humbasësh, në qoftë se harron gjuhën, traditat, zakonet, doket etj, të vendit nga i cili vjen, apo në qoftë se i braktisë ato.<sup>77</sup>

**Tabela 9.** Nëpërmjet tabelës së më poshtme do të paraqesim të dhëna statistikore, në lidhje me nacionalitetin apo përkatësinë etnike të kryerësve të veprës penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, për periudhën kohore 2014-2018.<sup>78</sup>

Nacionaliteti i kryerësve të veprës penale të dhunimit	
Shqipëtar	9 persona
Maqedonas	2 persona
Turq	3 persona
Rom	6 persona

<sup>77</sup> <http://potalb.mk/42477-nacinaliteti-etniteti-dhe-nacionalizmi/>.

<sup>78</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 2.09.2019/3.09.2019.

Nga tabela e mësipërme nga gjithsej njëzet (20) numri i kryerësve të veprës penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së apelit në Gostivar për periudhën kohore 2014-2018, nga kjo analizë ka rezultuar se: nëntë (9) persona kryerës të veprës penale të dhunimit kanë qenë shqiptarë, dy (2) persona kryerës të veprës penale të dhunimit kanë qenë me përkatësi etnike maqedonase, tre (3) persona kryerës të veprës penale të dhunimit kanë qenë me përkatësi etnike turke, dhe gjashtë (6) persona kryerës të veprës penale të dhunimit kanë qenë të përkatësisë etnike rome. Nga këto shifra numerike vërehet se numri i personave të nacionalitetit shqiptar janë më dominant edhe atë nëntë (9) persona, dhe më pak prezentë janë personat e nacionalitetit maqedonas. Duke mos dashur të tingëllojë me ton nacionalist apo diskriminues, dhe duke ruajtur objektivitetin deri në fund, vlen të theksohet që këto shifra mund të komentohen në bazë të numrit të popullsisë që jetojnë në këto vise, ku është fakt që numri më i madh të popullsisë në këto vende janë me nacionalitetit shqiptar.

### **3. Karakteristikat e veprës penale të dhunimit**

Për viktimat që kanë mbijetuar dhunën seksuale ekziston faktori i rrezikut nga problemet shëndetësore psiko-sociale.<sup>79</sup> Të kuptuarit e pasojave të mundshme nga dhuna seksuale do t'iu ndihmojë aktorëve institucional që zhvillojnë strategji të përshtatshme, dedikuar reagimit ndaj këtyre pasojave dhe pengimin e shkaktit të një dhune dhe vuajtjeje plotësuese. Nëse i referohemi sektorit shëndetësor, kur është në pyetje çfarëdo lloji i dhunës seksuale, ekziston mundësia që të lindin pasoja serioze shëndetësore, që mund të jenë të rrezikshme për jetën. Si përfundime fatale: vrasja, vetëvrasja, vdekja e nënës, vdekja e fëmijës, vdekja si pasojë e AIDS-it. Përfundime jo fatale (akute fizike): lëndimi, shoku, sëmundja, infeksioni. Kronike fizike: invaliditeti, ankesat nga vështirësitë në stomak, infeksione kronike, sëmundje kronike, problemet e lukthit dhe zorrëve, çrregullimet në ushqim (bulimia dhe anoreksia), çrregullimet e gjumit, përdorimi i alkoolit/drogës. Reproductive: dështimi natyror, shtatzëni e padëshiruar, abortimi i pasiguruar, sëmundjet e bartura, përfshirë edhe HIV/sidën, çrregullimet menstruale, komplikimet në shtatzëni, çrregullimet gjinekologjike, çrregullimet seksuale. Nëse i referohemi sektorit psiko-

---

<sup>79</sup> <http://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain/opendocpdf.pdf?reldoc=y&docid=4fcd4fc2>.

social, atëherë pasojat emocionale dhe psikologjike përfshijnë: stresi post-traumatik, depresioni, shqetësimi, frika, tërbimi/zemërimi, ndjenja e turpits, pasiguria, urrejtja ndaj vetes, padia ndaj vetes, sëmundja shpirtërore, mendimet vdekjeprurëse, sjellja. Pasojat shoqërore: akuzimi i viktimave, humbja e funksionit në shoqëri, njollosja shoqërore, përjashtimi dhe izolimi nga shoqëria, shtimi i pabarazisë ndërmjet gjinive.<sup>80</sup>

“Akuzimi i viktimës”, do të thotë se viktimat e krimit në tërësi apo vetëm pjesërisht është përgjegjëse për atë që ju ka ndodhur. Kjo i referohet mendimit popullor se sjellja specifike e viktimës ka inkurajuar dhunuesin dhe ka çuar që ngjarja të përfundojë me dhunim. Në disa kultura, akuzimi i viktimës është i zakonshëm, duke e justifikuar mendimin e tyre se personi i dhunuar është sjellë në mënyrë të papërshtatshme dhe ka provokuar dhunimin. Pra, në këto kultura, një viktimë e dhunimit konsiderohet e pandershme, dhe personi i dhunuar si rezultat i këtij rezonimi shoqëror humb reputacionin në shoqëri, duke përjetuar një turp të pakuptimtë si për viktimën ashtu edhe për familjen ku jeton viktimja. Një keqkuptim i madh i këtij perceptimi në lidhje me dhunimin, ndjehet edhe në trevat tona, duke u pëshpëritur në biseda rrethe të ndryshme familjare dhe shoqërore se gjoja deri te dhunimi ka ardhur për shkak të provokimeve të viktimës, ku kryerësi ka humbur kontrollin dhe ka ardhur deri te zhvillimi i ngjarjes. Ky mit është i ngulitur edhe në mendjen e kryerësit, por, për fat të keq edhe në mendjen e shoqërisë. Mirëpo, “objekt i kësaj vepre penale mund të jetë secili person. Për ekzistimin e kësaj vepre penale nuk ka rëndësi se a është apo nuk është i martuar personi, as nuk ka rëndësi morali i personit femër”.<sup>81</sup>

Nga hulumtimet e ndryshme shkencore dhe literaturat e ndryshme, si dhe nga përkufizimet ligjore mund të përfundojmë se karakteristikë e veprës penale të dhunimit është *dhuna*, në detyrimin e kryerjes së aktit seksual.

Sipas Begejës<sup>82</sup>, karakteristikat e marrëdhënies seksuale me dhunë, janë:

-kryerësi, kur ndodhet në një takim feste (mbrëmje, martesë, ditëlindje etj.) ose në një vend publik (disco-klub, restorant, plazh etj.) shfrytëzon besimin ose, shpesh, gjendjen euforike të së dëmtuarës, të shkaktuar nga pija alkoolike, e çon atë në një vend të fshehtë, pa njerëz dhe kryen aktin seksual me dhunë;

---

<sup>80</sup> Ibid, fq.32.

<sup>81</sup> Korajliq, op.cit., FSK/S-15/06.

<sup>82</sup> Begeja, Skender, Kriminalistika, Tiranë, 1997, fq.575.

-kryerësi, i pajisur me mjet transporti (automjet, motoçikletë, motoskaf) pasi e takon të dëmtuarën, propozon të shkojnë së bashku në një vend të caktuar dhe pastaj, pavarësisht nga vullneti i saj, e çon në një vend ku nuk ka njerëz dhe e përdhunon atë;

-kryerësi, e takon rastësisht të dëmtuarën në një vend pa njerëz (pyll, park etj.) dhe e sulmon papritur për të kryer marrëdhënie seksuale;

-kryerësi, e takon rastësisht, e ndjek qëllimisht të dëmtuarën e mitur (në oborre, në institucione shkollore ose të fëmijës, në rrugë etj.) dhe duke e mashtruar (gënjyer) e çon në një vend të veçuar, shumë të largët, të humbur dhe kryen marrëdhënie seksuale.

#### **4. Mjetet që përdoren për kryerjen e veprës penale të dhunimit**

Veprimi i kryerjes qëndron në përdorimin e forcës (dhunës) apo të kanosjes me qëllim të kryerjes së aktit seksual. Përdorimi i forcës shprehet duke ushtruar forcën fizike. Si veprime të forcës mund të jenë grushtimi i viktimës, asfiskimi, zhveshja e rrobave, mbyllja e gojës tërheqja zvarrë e viktimës, tërheqja për flokë etj. Lidhur me këtë vepër penale, dhuna dhe kanosja shërbejnë si mjet për kryerjen e aktit seksual. Kjo vepër penale ekziston edhe në rastet kur dhuna apo kanosja nuk janë të drejtuara në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj viktimës, por edhe ndaj të afërmeve të viktimës. Kështu p.sh. dhuna apo kanosja e drejtuar ndaj fëmijës apo ndonjë personi të afërm mund të ndikojë në vullnetin e viktimës që të thyhet rezistenca e saj. Dhuna e cila ushtrohet me qëllim të kryerjes së aktit seksual mund të jetë absolute, siç është ta zëmë përdorimi i forcës fizike, por dhuna mund të ushtrohet edhe duke e sjellë viktimën kundër vullnetit të saj në gjendje të pavetëdijshme apo në gjendje në të cilën nuk është e aftë të rezistojë, me anë të hipnozës apo me mjete joshëse (me alkool, droga dehëse, me medikamente etj.).<sup>83</sup>

Metodat më të përhapura që i shfrytëzojnë fajtorët për përgatitjen, kryerjen dhe mbulimin e krimeve seksuale me dhunë janë: kthimi i së dëmtuarës në gjendje pazotësie për tu mbrojtur, duke përdorur tri mënyra: me anë të dehjes, me anë të përdorimit të barërave narkotike, të lëndëve psikotrope, me anë të sugjestionimit, të hipnotizimit, me rrahje, me goditje, lidhje duarsh e këmbësh, shtrirje për toke, kapje për flokësh, etj, me anë të mashtrimit, duke i dhënë para, dhurata, etj. Mposhtja e kundërshtimit të së dëmtuarës nga dhunuesi bëhet edhe duke e kanosur,

---

<sup>83</sup> Salihu, Ismet, E drejta penale-Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009, fq. 209.

kërcënuar ose frikësuar atë me armë (zjarri ose të ftohta), aty për aty, për ta detyruar atë që t'i nënshtrohet qëllimit të tij.<sup>84</sup>

**Tabela 10.** Nëpërmjet tabelës në vijim, do të paraqesim të dhëna në lidhje me mjetet e përdorura gjatë kryerjes së veprës penale të dhunimit, në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, gjatë periudhës kohore 2014-2018.<sup>85</sup>

<b>Mjetet e përdorura gjatë kryerjes së veprës penale të dhunimit</b>	
Shtëpi private (e viktimës)	3 raste
Banesë	1 rast
Hotel	3 raste
Restoran	2 raste
Shitore	2 raste
Taksi	1 rast
Forcë fizike	1 rast
Bërtitje (kërcënim)	1 rast
Nuk përmenden	6 rast

Nga tabela e mësipërme siç mund të vërehet janë paraqitur mjetet e përdorura gjatë kryerjes së veprës penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, në periudhën kohore 2014-2018. Nga analiza e rasteve të gjykuara, rezulton se në gjashtë (6) raste nuk përmenden mjetet e përdorura gjatë kryerjes së veprës penale të dhunimit, në tre (3) raste është përdorur shtëpia private apo shtëpia e viktimës, tre (3) raste është përdorur hoteli për kryerjen e veprës penale të dhunimit, në dy (2) raste është përdorur restoranti si mjet, gjithashtu në dy (2) raste është përdorur shitorja në të cilën kishte punuar kryerësi, dhe nga një (1) rast është përdorur banesa, taksi, forca fizike dhe bërtitja.

<sup>84</sup> Latifi, Vesel, Kriminalistika, Prishtinë, 2014, fq.434.

<sup>85</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 2.09.2019/3.09.2019.



## 5. Viktimat e veprave penale të dhunimit

Fjala viktimë nënkupton personin apo grupin e caktuar që ka pësuar, që është dëmtuar. Pësimi apo viktimizimi ka të bëjë me privimin nga jeta, me dëmtimin e integritetit trupor, me shkatërrimin e shëndetit fizik dhe mendor, me ngeljen me pasoja të rënda fizike dhe psikike afatshkurta ose afatgjate. Pësimi dhe dëmtimi nënkupton edhe shkatërrimin e pasurisë dhe të mirave të tjera morale dhe materiale, shkeljen, cenimin dhe rrezikimin e të drejtave dhe lirive individuale dhe kolektive të njeriut etj. Zakonisht, si viktimë është njeriu dhe të drejtat e të mirat e tij.<sup>86</sup>

Një nga shpjegimet e prirjes së njerëzve për të fajësuar viktimën lidhet me dëshirën e brendshme aluduese të individit për mundësitë që ka pasur në të kaluarën. Pasi ndodhi ngjarja, qoftë ajo edhe e rrallë, njerëzit shikojnë mbrapa, analizojnë dhe në përgjithësi e mbivlerësojnë mundësinë që ka pasur për ta parashikuar ndodhjen e saj, duke besuar se e dinin që më parë se do të ndodhte ashtu. Me pakë fjalë, është prirja për të perceptuar ngjarjen pasi ka ndodhur. Viktimat e krimit kanë nevojë për mbështetje sociale, ndërkohë që shoqëria nuk vepron gjithmonë kështu. Në një studim p.sh., subjektet që lexuan për sjelljen e një femre, e cila më vonë u përdhunua, e shikuan përdhunimin si të parashikueshëm dhe sjelljen e saj si të fajshme. Ndërsa, subjektet që e lexuan të njëjtën histori, pa marrë vesh se femra ishte përdhunuar, nuk i panë veprimet e sajë në kuptim negativ. Prandaj shumë femra që dëshmojnë përdhunimin e tyre në gjyq, ndihen vetë si në bankën e të akuzuarve, në vend që kjo të ndodhë me të pandehurin.<sup>87</sup>

Shpjegimi i dytë i prirjes për të fajësuar viktimën lidhet me faktin se njerëzit kanë nevojë të besojnë në botën e drejtë, në atë, se çdo njëri merr atë që meriton. Edhe gjyqtari, duke u mbrojtur nga presioni psikologjik i viktimës që po vuan, e ndjen nevojën për të qenë i drejtë ndaj çështjes, por aq më tepër ndaj viktimës, prandaj përpiqet t'i japë ngjarjes edhe kuptimin se viktimja ka bërë diçka për ta merituar atë që i ka ndodhur.<sup>88</sup>

Çdo shoqëri bashkëkohore që pretendon mbrojtjen e individit, në plan të parë ka mbrojtjen e moralit dhe dinjitetit. Shteti, individëve që u cenohet morali dhe dinjiteti, kujdeset t'u ofrojë mbrojtjen penalo-juridike nëpërmjet parashikimit të veprave penale në dispozitat e Kodit Penal.

---

<sup>86</sup> Halili, Ragip, *Viktimologjia*, Prishtinë, 2011, fq.8.

<sup>87</sup> Dragoti, op.cit., fq.391.

<sup>88</sup> Po aty.

Dhe duke paraparë sanksione penale për cenimin e moralit dhe dinjitetit, dënohet dhuna, keqpërdorimi i pozitës, si dhe mbrohet liria e individit, dhe veçanërisht mbrojtje të posaçme u kushtohet personave të mitur dhe fëmijëve.<sup>89</sup>

Kërkimet e delikteve seksuale dhe dhuna seksuale tregojnë se në pjesën më të madhe të rasteve, si viktimat paraqiten femrat. Zakonisht këto janë femra me nivel të ulët të arsimimit, me një gjendje të dobët materiale, me kushte të vështira të banimit, janë të pamartuara ose të ndara ose kanë problem me përdorimin e alkoolit, drogës ose problem të tjera shëndetësore.<sup>90</sup>

Legjislacioni ynë parashikon ruajtjen e paprekshmërisë seksuale të gruas dhe dënon kryerjen e aktit seksual pa dëshirën e saj (me dhunë). Marrëdhëniet seksuale me dhunë mund të kryhen duke përdorur forcën fizike, kanosjen, gjendjen e pamundësisë së femrës për t'u mbrojtur. Zakonisht, këqyrja fillon me marrjen e anamnezës duke i propozuar të dëmtuarës të tregojë me rrjedhshmëri, pandërprerje, gjithçka që i ka ndodhur. Pas tregimit të ngjarjes, eksperti i drejton pyetje me qëllim që të plotësojë, saktësojë dhe vërtetojë thëniet (tregimin) e të ekzaminuarës. Mjeku duhet të ketë gjithmonë parasysh mundësinë e shpifjeve ose të akuzës së rreme për përdhunim. Ai duhet të studiojë të gjitha rrethanat e çështjes, duke pasur sidomos parasysh mundësinë ose pamundësinë e këqyrjes së kontaktit seksual me dhunë në ato rrethana dhe gjendje konkrete që deponon e dëmtuara.<sup>91</sup>

**Tabela 11.** Nëpërmjet kësaj tablele do të paraqesim të dhëna të marra nga Gjykata e Apelit në Gostivar, për periudhën 2014-2018, lidhur me viktimitën sa i përket njohjes së viktimit me kryerësin.<sup>92</sup>

<b>Viktimat e veprës penale të dhunimit</b>	
Janë njohur	20 raste
Nuk janë njohur	0 raste

<sup>89</sup> Zejneli, Ismail, E drejta penale-Pjesa e posaçme, Tetovë, 2008, fq.80.

<sup>90</sup> Halili, op. cit., fq.193.

<sup>91</sup> Ramadani, Agim, Hoxha, Sabri, Mjekësia Ligjore, Tetovë, 2015, fq.335-336.

<sup>92</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë. 2.09.2019/3.09.2019.

Nga tabela e mësipërme në bazë të të dhënave kuptojmë që në të gjitha rastet e veprës penale të dhunimit nga gjithsej njëzet raste (20) në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar në periudhën 2014-2018, kryerësi dhe viktima janë njohur që më parë. Nga analiza dhe studimi i lëndëve gjyqësore erdha në përfundim se relacioni kryerës-viktimë ka qenë i njohur, vetëm në dy (2) raste kryerësi dhe viktima kishin qenë në lidhje dashurie.

**Tabela 12.** Nëpërmes tabelës në vijim, do të paraqesim gjininë e viktimave të veprës penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, për periudhën kohore 2014-2018.<sup>93</sup>

<b>Gjinia e viktimave të veprës penale të dhunimit</b>	
Gjinia femërore	20 raste
Gjinia mashkullore	0 raste

Nga tabela e sipërpërmendur, duke analizuar të dhënat numerike mund të përfundojmë, se nga gjithsej njëzet (20) raste të kryerjes së veprës penale të dhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar në periudhën 2014-2018, të gjitha viktimat e veprës penale të dhunimit i përkasin gjinisë femërore/femra , dhe asnjë viktimë e shënuar e gjinisë mashkullore. Duke u bazuar në këto të dhëna lehtë mund të vërejmë që si viktimë e veprës penale të dhunimit janë paraqitur femrat.

<sup>93</sup> Të dhëna të siguruara nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 2.09.2019/3.09.2019.

## KAPITULLI I KATËRT

### POLITIKAT NDËSHKIMORE TË VEPRAVE PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL

#### 1. Masat parandaluese të krimeve të dhunimit dhe roli i organeve të judikaturës

Termi prevencion është huazuar në mënyrë pragmatike nga vokabulari dhe praktika mjekësore. Në kuptimin e vetë të gjerë janë profiluar dy përmbajtje themelore të këtij nocioni. I pari prej tyre ka të bëjë me intervenimin si formë primare e prevencionit. Kjo qasje në esencë ka shënuar intervenimin ndaj dukurive të caktuara me mjete të përcaktuara që më parë. Përmbajtja e dytë lidhet me prefiksën pre që shënon reaksionin e parakohshëm, më saktësisht reaksionin para se të jetë manifestuar dukuria e padëshiruar. Në gjuhën latine, praeventio (prae-venio, veni, ventum, praeventus, praevenire) shënon përcaktimin dhe termin e kaloj, arrijë përpara, e kapërcej një dukuri të caktuar, ose siç do të mund të thuhej në bazë të mendjes së shëndoshë parandalim, mbrojtje paraprake, pengim, shmangie që më parë. Që nga shekulli XV në praktikën angleze socio – politike dhe kriminale – politike përdoret shprehja prevent me të cilën dëshirohet të theksohet çdo përmbajtje me të cilën në periudhën e ardhshme do të pengohen sjelljet e dënueshme në kuptim të ngushtë të përcaktimit të tyre. Nga kategorizimi i cekur më parë, mund të vërejmë se nocioni parandalim përmban në vete të gjitha masat e ndërmarra në mënyrë të planifikuar, të paramenduar dhe të organizuar me të cilat do të bëhen përpjekje të mënjanohen ose së paku të zvogëlohen shkaqet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të sjelljeve të dënueshme.<sup>94</sup>

Në domethënien e vetë pragmatike politika e parandalimit të kriminalitetit përfshin veprime të niveleve të ndryshme. Koncepti më i gjerë i veprimit përfshin aktivitetet primare (ante delictum), me të cilat bëhen përpjekje të pengohen sjelljet kriminale dhe të zvogëlohet numri i tyre para se të konkretizohet akti kriminal. Koncepti më i ngushtë nënkupton nivelin e parandalimit me instrumentet penale – juridike (post delictum) sipas të cilit vepron në mënyrë preventive pas kryerjes së veprës penale, (post judicem) pas aktgjykimit të shqiptuar të formës së prerë dhe

---

<sup>94</sup> Muratbegović, Elmedin, Prandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë/Prishtinë, prill, 2007, fq.6.

të ndihmës postpenale, d.m.th. të veprimit pas sanksionit të ekzekutuar ose të aplikuar penal – juridik.<sup>95</sup>

Parandalimi i kriminalitetit përfshin edhe aktivitetet e subjekteve të ndryshme që nënkuptojnë masat preventive. Masat e tilla të parandalimit të kriminalitetit mund të nënkuptojnë: forumet shtetërore dhe forumet me autorizime publike, organizatat joqeveritare, shoqatat, fondacionet private, institucionet e informimit publik, shtypin, media elektronike, institucionet edukative, përkatësisht arsimore, rrethin profesional në kuptimin më të gjerë të fjalës, institucionet fetare, familjen si grup fundamental social të çdo shoqërie. Aktiviteti i vetë shtetit në këtë plan fokusohet në miratimin dhe perfeksionimin e projekteve ligjore, d.m.th. me dizajnimin e legjislacionit penal, kurse më vonë me operacionalizimin përmes masave preventive të policisë dhe të shërbimeve të specializuara shtetërore, që merren me kriminalitetin në kuptim të ngushtë dhe të gjerë të domethënies së tij. Mirëpo, siç e kemi cekur parandalimi i kriminalitetit shumë shpesh ka të bëjë edhe me zbatimin e disa masave nga ana e vetë qytetarëve, qoftë në mënyrë të pavarur, qoftë nëpërmjet disa organeve, shërbimeve të specializuara, pastaj shoqatave të krijuara në mënyrë spontane ose të planifikuara, si dhe të disa sektorëve të tjerë të jetës shoqërore, siç është sektori i informimit etj.<sup>96</sup>

Politika kriminale, përfshinë apo thënë më mirë duhet të përfshijë sistemin e planifikuara dhe të koordinuar të veprimtarive shoqërore, në pikëpamje të ndryshme përmbajtjesore dhe me subjekte të ndryshme si bartës të tyre unik në qëllimin e përbashkët. Ky koordinim i masave të politikës kriminale dhe ndërlihdja e tyre e nevojshme përbëjnë parakushtin e domosdoshëm për çdo politikë shoqërore racionale dhe efikase të luftimit të kriminalitetit.<sup>97</sup> Diferencimi themelor i masave të politikës kriminale në masa preventive dhe masa të karakterit represiv tregon edhe në diferencimin e kategorive shoqërore, të cilat duhet t'i zbatojnë ato masa. Edhe pse në politikën bashkëkohore kriminale nuk mund të flitet për masat ekskluzive preventive apo ekskluzive represive, prapë se prapë për institucionet siç është policia, prokuroria, gjykatat dhe entet për ekzekutimin e sanksioneve penale mund të thuhet se fjala është për subjektet themelore, të cilat e

---

<sup>95</sup> Po aty.

<sup>96</sup> Abazović, Mirsad, Muratbegović, Elmedin, Halilović, Haris, Budimlić, Muhamed, Beqirević, Edina, Politika e luftimit të kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.33.

<sup>97</sup> Lazarević, L.J., „Legjislacioni penal si bazë për konstituimin e politikës së luftimit të kriminalitetit“.

shqiptojnë vargun e masave represive.<sup>98</sup> Këto institucione edhe gjenden në pjesën qendrore të aparatit shtetëror, i cili krijon zinxhirin e subjekteve themelore të politikës kriminale. Në anën tjetër kategoritë shoqërore të cilat në aktivitetet e veta realizojnë më tepër detyra preventive sikurse është familja, institucionet arsimore, entet për punë sociale shpesh quhen subjekte jashtë penale të politikës kriminale. Me këtë rast është me rëndësi të theksohet se politika bashkëkohore kriminale në dimensionin praktik por edhe të doktrinës së saj gjithnjë e më tepër po drejtohet kah zhvillimi i masave alternative shoqërore (të karakterit formal dhe jo formal), të cilat në fund të fundit, në luftimin e kriminalitetit duhet të ofrojnë rezultate shumë më të mira nga masat tradicionale, gjë të cilën gjithashtu do ta shpjegojmë në vijim. Krahas njohjes së primatit absolut të masave preventive në luftë kundër kriminalitetit në raport me masat represive, sidomos dënimin, teoria penale bashkëkohore dhe legjislacioni, gjegjësisht praktika gjyqësore nuk e kontestojnë legjitimitetin e dhunës penale-juridike as në formën e shqiptimit të dënimit, lirisht mund të thuhet se në këtë pikëpamje edhe në botë edhe tek ne janë kristalizuar dy mendime themelore. I pari është se dhuna penale – juridike nuk duhet të jetë themelore në luftën kundër kriminalitetit, dhe as që duhet të pranohet ajo si mënyra më efektive e luftimit të kësaj dukurie. E dyta lufta kundër kriminalitetit duhet para së gjithash të realizohet me zbatimin e një sistemi sinkronizues dhe përmbajtësor të masave të llojllojshme preventive me një koordinim të plotë të organeve që i zbatojnë ato.<sup>99</sup>

*Organet e judikaturës:* Organet e judikaturës (prokuroria publike, gjykata penale, organet për ekzekutimin e sanksioneve penale), me funksionet e veta represive kanë për detyrë t'i përcjellin dhe analizojnë dukuritë me interes për realizimin e funksioneve të veta, përkatësisht të japin propozime për pengimin e dukurive të rrezikshme shoqërore dhe të atyre që nuk janë inkriminuese, por që paraqesin shkelje ose rrezikim të të mirave ose të interesave përkatëse shoqërore. Kjo ka për qëllim forcimin e ligjshmërisë dhe të përgjegjësisë në shoqëri. Roli preventiv i organeve përkatëse të judikaturës qëndron në bashkëpunimin reciprok të funksioneve

---

<sup>98</sup> Për definimin përmbajtësor të nocionit luftim dhe kundërvënie, shih në „Parandalimin e Kriminalitetit“, „Qasje Teorike Kriminalistike“, Krivokapiq, V., FSHK, Sarajevë, 2006.

<sup>99</sup> Lazareviq, LJ.: Legjislacioni penal si bazë për konstituimin e politikës së luftimit të kriminalitetit.

të judikaturës dhe përcjelljen e dukurive të tilla shoqërore, gjë që funksionet represive, postdeliktore të atyre organeve i bën kreative.<sup>100</sup>

Në esencën e veprimit të vet represiv është i mundur pengimi i shfaqjes krimogjene dhe ndërmarrja e masave në mënjanimin e shkaqeve të sjelljeve të ndryshme devijuese dhe të erozionit të moralit. Aty bëjnë pjesë edhe masat e dënimit me kusht dhe të vërejtjes gjyqësore, masat e sigurisë, masat edukative në aplikimin e të cilave insiston politika bashkëkohore kriminale, pikërisht për shkak të veprimit të tyre të mundshëm preventiv. Masat represive të judikaturës penale për një kohë të gjatë kanë qenë masa të vetme dhe ekskluzive, kurse tek në kohë të fundit rëndësi të veçantë kanë masat e caktuara, esenca e të cilave, edhe pse post delikuate, para se gjithash është preventive. Shumë legjislacione me aplikimin e këtyre masave kanë arritur rezultate të rëndësishme në kundërvënien ndaj kriminalitetit për ç'arsye legjislacionet moderne përpiqen që t'i aplikojnë në sistemet e veta ndëshkimore. Intenca e politikës kriminale qëndron në forcimin e rolit preventiv të këtyre organeve në mënyrë që kontributi i tyre në kundërvënien ndaj kriminalitetit të bëhet edhe më i rëndësishëm. Funkzioni represiv i atyre organeve, ndërkaq, në kuptimin kushtetues, ligjor dhe praktik është predominant në raport me atë preventiv, gjë që organet nuk i bënë mjaft efikase në plan të parandalimit.<sup>101</sup>

Në këtë pjesë do t'i parashtrojmë pikëpamjet themelore mbi qëllimet, rolin dhe strukturën e subjekteve themelore të politikës kriminale, të cilat sipas karakterit të tyre realizojnë rolin e intervenimit të garantuar shtetëror në pengimin dhe luftimin e kriminalitetit dhe siç e kemi cekur, fjala këtu është për organet policore, prokuroritë, gjykatat dhe entet ndëshkimore. Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se lidhur me qëllimet e lëndës së politikës kriminale, në shpjegimet që pasojnë, vëmendje më të vogël do tu kushtojmë pikëpamjeve organizative dhe ligjore të funksionimit të këtyre institucioneve shtetërore, ndërsa vëmendja qendrore do të jetë e drejtuar në funksionet dhe aktivitetet e organeve, të cilat i kontribuojnë luftimit të kriminalitetit.<sup>102</sup>

---

<sup>100</sup> Muratbegović, Elmedin, Prandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë/Prishtinë, prill, 2007, fq.127.

<sup>101</sup> Po aty.

<sup>102</sup> Abazović, Mirsad, Muratbegović, Elmedin, Halilović, Haris, Budimliq, Muhamed, Beqireviq, Edina, Politika e luftimit të kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.65

## 2. Roli i policisë në parandalimin e veprave penale të dhunimit

Policia e Republikës së Maqedonisë vepron si organ ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), e cila kryen punë policore të parapara me ligj, nëpërmjet nëpunësve policor.<sup>103</sup> Funkzioni themelor i Policisë është mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, mbrojtja e rendit juridik, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, marrjen e masave për hetimin e kryerësve të veprave penale, si dhe mbajtjen dhe ruajtjen e qetësisë publike në shoqëri.

Aktiviteti i policisë i cili është i drejtuar në eliminimin e rrethanave dhe shkaktarëve të paraqitjes së sjelljes kriminale karakterizohet si preventiv, gjegjësisht si funksion ante delictum i saj. Pra fjala është për grupin e masave të cilat kryhen para kryerjes së delikti e më të cilat kryerësit i pamundësohet kryerja e akteve kundërligjore dhe të rrezikshme për shoqërinë. Politika moderne kriminale ka ndërtuar modelin të lidhjes funksionale të programeve të saj preventive me rezultatet e hulumtimeve konkrete etiologjike. Ky element racional praktik dominon në këtë shkencë sepse programimi i politikës represive dhe preventive, dhe realizimi i tyre i suksesshëm varen nga faktorët që shkaktojnë kriminalitetin. Luftimi shkencor i kriminalitetit i takon kohës së re. Mirëpo organizimi shkencor i luftës supozon edhe njohje të gjithanshme shkencore të fenomenit kriminal që është detyrë para së gjithash e etiologjisë kriminale.<sup>104</sup>

Për veprimin preventiv është e domosdoshme njohja paraprake me të gjitha rrethanat të cilat pas kryerjes së hulumtimit mund të kumtohen si faktorë kriminogjen të disa formave të sjelljeve kundërligjore. Gjithsesi do të ishte e padëshirueshme të planifikohen apo të kryhen aktivitete preventive pa hulumtime analitike dhe të bazuara në të dhëna shkencore lidhur me kushtet dhe shkaqet e formës së caktuar të kriminalitetit. Për këtë arsye këto hulumtime merren si një ndër kushtet më të rëndësishme për aktivitetet e suksesshme preventive.<sup>105</sup>

---

<sup>103</sup> Ligji për Policinë e Republikës së Maqedonisë, prill 2018, neni 2.

<sup>104</sup> Mlagjenović-Kupčević, R.: „Kriminologjia“ - „Svjetlost“, Sarajevë, 1982., fq. 121-122.

<sup>105</sup> Budimliq, M., „Aktualiteti i hulumtimeve kriminologjike në parandalimin e formave të reja të sjelljes kriminale“, Tema kriminalistike, Revista e kriminalistikës, kriminologjisë dhe studime për sigurinë, nr. 3-4, FSHK, Sarajevë, 2004., 213-226.



Masa të cilat i ndërmerr policia me qëllim të parandalimit të aktiviteteve kriminale janë të shumta dhe të llojllojshme. Struktura dhe vëllimi i këtyre masave në masë të madhe varet nga specifikat e rrethanave të gjera shoqërore në të cilat ato ndërmerren. Forma e organizatës shtetërore dhe shoqërore, vëllimi dhe struktura e kriminalitetit kushtet ekonomike sociale janë vetëm disa nga elementet të cilat përcaktojnë përmbajtjen e aktivitete policore në parandalimin e kriminalitetit. Si masa më të zbatuara policore që kanë karakter preventiv mund të përmenden: • Shërbimi patrullues (analizat kompjuterike); • Mbikëqyrja dhe sigurimi i objekteve; • Shërbimi paralajmërues; • Sigurimi i tubimeve publike; • Masat antidiversion; • Evidencat dhe lejet; • Verifikimi i identiteti; • Kontrolli i komunikacionit publik; • Përpunimi i të dhënave të hulumtimit analitik –statistikë; • Informimi i qytetarëve dhe puna në komunitet; • Ndërmjetësimi jo formal në zgjidhjen e konflikteve; • Kontrolli i sforcuar i të kthyerve; • Bashkëpunimi brenda organizatave policore ndërkombëtare.<sup>106</sup>

Krahas të përmendurave janë të shumta edhe aktivitetet e nëpunësve policor të cilët çdo ditë kanë ndikim direkt e të rëndësishëm për parandalimin e aktiviteteve kriminale. Ndonëse aktiviteti preventiv sot karakterizohet si perspektiv themelore për luftimin e të gjitha llojeve dhe formave të aktiviteteve kriminale, prapë aktivitetet tradicionale të policisë më së shpeshti janë të drejtuara në ato masa që kanë karakter represiv, gjegjësisht të cilat kryhen me rastin e sjelljes kundërligjore.

Detyrë themelore e policisë rreth aktiviteteve të cilat njihen si akte post delictum është të sigurojë informata kyçe dhe ndërmerr veprime të caktuara pas kryerjes së deliktit, që kanë të bëjnë me: • Zbulimin e veprës penale apo veprës tjetër kundërligjore; • Zbulimin e kryerësit të asaj vepre; • Sigurimin e pranisë së kryerësit; • Paraqitjen e dëshmive të rëndësishëm për procedurën penale; Sigurimin e disa dëshmive.<sup>107</sup>

Aktiviteti i tërësishëm paraprak të cilin e ndërmerr policia në procedurën kriminalistike –juridike pas përfundimit apo përgatitjes së veprës së caktuar penale ka si rezultat të fundit paraqitjen e veprës penale me qëllim të inicimit të procedurës penale apo pengimit të saj. Kjo veprimtari e organit të punëve të brendshme zakonisht zhvillohet me vet iniciativë në bazë të funksionit

---

<sup>106</sup> Stojanović, Z.: „Politika e luftimit të kriminalitetit“, Novi Sad, 1991., fq. 80.

<sup>107</sup> Stojanović, Z.: „Politika e luftimit të kriminalitetit“, Novi Sad, 1991., fq. 81.

vetjak të legalizuar me detyrat dhe autorizimet që i jep Ligji i Procedurës Penale (LPP) dhe aktet tjera por në bazë të funksioneve të organeve tjera shtetërore, gjykatës penale, prokurorisë.<sup>108</sup>

Që të mund ti përdorë policia disa mjete të karakterit represiv të cilat seriozisht cenojnë jetën private të të drejtave dhe lirive qytetare, është e domosdoshme të ekzistojnë:<sup>109</sup>

- Kushtet ligjore (LPP);
- Vlerësimet reale për domosdoshmërinë e tyre (vendimi i gjykatës kompetente).

Krahas rolit të cilin e realizojnë me urdhëresë të gjykatës apo prokurorisë që janë të drejtuara në dëshmimin në procedurën penale-ndëshkimore, nëpunësit policor mund të marrin pjesë edhe në realizimin të të ashtuquajturave veprime hetimore të cilat zënë vend jashtëzakonisht të rëndësishëm në zbulimin dhe ndriçimin e formave më të rënda të veprave penale. Në realizimin e detyrave represive është e rëndësishme çështja e përdorimit të agjentit provokator, mbikëqyrja elektronike, përgjimi i bisedave telefonike, inçizimi i zërit e të ngjashme, kontrolli i dërgesave postare, etj.<sup>110</sup>

*Organizimi i policisë:* Punët policore në Ministrinë e Punëve të Brendshme<sup>111</sup> i kryen Drejtoria (Byroja) për siguri publike si organ në përbërjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Drejtoria është përgjegjëse për: planifikim, monitorim, analizim të situatës së sigurisë dhe arsyet e paraqitjes së kriminalitetit dhe rrezikimit të sigurisë publike; harmonizimi, udhëzim dhe mbikëqyrje të përgjithshme dhe profesionale mbi punën e njësive organizative të Policisë; mbledhjen, përpunimi, analizimin, përdorimin, vlerësimin, transferimin, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave nga fushëveprimi i punës së Policisë, si dhe përpunimi i të dhënave personale në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj dhe me ligj të veçantë; pjesëmarrje në kryerjen e punëve komplekse në fushëveprimin e njësive organizative policore; përgjegjësi për përgatitjen e Policisë në raste të intervenimit në punët komplekse; organizimi dhe kryerja e hetimeve kriminalistike etj.

<sup>108</sup> Krivokapiq, V., FSHK, Sarajevë, 2006., fq. 271-276.

<sup>109</sup> Stojanović, Z.: „Politika e luftimit të kriminalitetit“, Novi Sad, 1991., fq. 82.

<sup>110</sup> Abazović, Mirsad, Muratbegović, Elmedin, Halilović, Haris, Budimliq, Muhamed, Beqireviq, Edina, Politika e luftimit të kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.68.

<sup>111</sup> Ligji për Policinë e Republikës së Maqedonisë, neni 15-16.

Për kryerjen e punëve policore në territorin e Republikës së Maqedonisë formohen Sektorët për punë të brendshme. Sektorët për punë të brendshme formohen varësisht nga madhësia e zonës, numrit të popullsisë, numrit të veprave penale dhe kundërvajtjeve, rëndësia e rrugëve dhe pozicioni gjeografik i komunave që mbulon Sektori i brendshëm. Në territorin e Republikës së Maqedonisë gjithsej janë të formuar tetë Sektorë të punëve të brendshme edhe atë: Shkup, Manastir, Veles, Kumanovë, Ohër, Strumicë, Tetovë dhe Shtip, si dhe 38 stacione policore.

Sektori për punë të brendshme kryen<sup>112</sup>: monitoron dhe analizon situatën e sigurisë publike dhe shkaqet që paralajmërojnë zhvillimin dhe rritjen e kriminalitetit si dhe shkaqet që rrezikojnë sigurinë publike në zonën për të cilën është formuar; organizon, koordinon, drejton dhe mbikëqyr punën e stacioneve policore; kryen hetime kriminalistike dhe punon për parandalimin e kriminalitetit; mbledh, përpunon, analizon, përdor, vlerëson, ruan dhe fshinë të dhëna nga fushëveprimi i punës së Policisë për zonën për të cilën është formuar dhe gjithashtu kryen përpunimin e të dhënave personale në kushte dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj dhe me ligj të veçantë; merr pjesë drejtpërdrejt në kryerjen e punëve komplekse nga fushëveprimi i stacioneve policore; në bazë të nevojës kryen dhe zbaton masa të përcaktuara në fushën e sigurisë së kufirit shtetëror; merr masa për mbrojtjen e personave dhe objekteve të caktuara; informon publikun për fushëveprimin e vet; kryen punë tjera të përcaktuara me ligj, akte nënligjore apo në pajtim me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare policore.

Policia e jurisprudencës: me detyrë zyrtare apo me urdhër të prokurorit publik ndërmerr masa dhe aktivitete me qëllim të zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale, parandalimit të pasojave të mëtutjeshme të veprave penale, kapjes dhe denoncimit të kryerësve të tyre, sigurimit të provave dhe masave dhe aktiviteteve tjera të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin e papenguar të procedurës penale. Policia e jurisprudencës zbaton hetime dhe veprime të urdhëruara ose të ngarkuara nga gjykata dhe prokuroria publike.<sup>113</sup>

Policia në bashkësi: Si model mjaft aktiv dhe instruktiv i veprimit preventiv të policisë në nivel të bashkësive lokale në planin kombëtar, por edhe ndërkombëtar paraqet e ashtuquajtura Community policing (policia në bashkësi), model të ngjashëm aplikon dhe përdor edhe policia e

---

<sup>112</sup> Ligji për Policinë i Republikës së Maqedonisë, nëni 21.

<sup>113</sup> Ligji për procedurën penale i Republikës së Maqedonisë, neni 46.

Republikës së Maqedonisë. Ky model i operacionalizuar në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, paraqitet me qëllim parësor që ta shtyjë unitarizmin dhe centralizmin në veprimtarinë policore që e bënin jofunksional aktivitetin e gjithëmbarshtëm të policisë. Me modelin e tillë është e mundur që me anë të komunikimit të drejtpërdrejtë të policisë dhe të qytetarëve, në regjion të ngushtë lokal, të kontribuohet në zgjidhjen më të suksesshme të çështjeve të shumta të bashkësisë lokale në përgjithësi. Natyrisht, interesimi parësor ka të bëjë me parandalimin e kriminalitetit dhe të dukurive të ngjashme asociale. Fjala është për qasjen e orientuar preventive që e promovon bashkëpunimin e bashkësisë me zyrtarët policorë, të ndikojë në mënyrë direkte në shkaqet e kriminalitetit dhe në vetë ndjenjën e frikës nga kriminaliteti në përgjithësi midis qytetarëve të bashkësisë së caktuar. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, qëllimi themelor i veprimit policor paraqet synimin për ngritjen e shkallës së sigurisë dhe në përgjithësi të kualitetit të jetesës së qytetarëve në bashkësitë e cekura lokale. Që të arrihet kjo, është e domosdoshme të realizohet bashkëpunimi efektiv dhe i përshtatshëm i policisë dhe i bashkësisë lokale.<sup>114</sup>

Ndër aktivitetet të cilat i zbaton policia në aplikimin e kësaj strategjie më së shpeshti përmenden:

- Kacafytja me shkaqet e kriminalitetit (nisma për ndihmë familjes, programi për fëmijë, programet zhvillimore të bashkësive dhe nismat e tyre, programet preventive parashkollore, skemat për ata që keqpërdorin drogën dhe alkoolin, arsimimi dhe programet e mbështetura shkollore, puna me delikuentet dhe familjet e tyre, punësimi dhe programet e aftësimin si dhe këshillat);
- Zvogëlimi i rastit të kryerjes së krimit (përmasimi i sigurisë së shtëpive, ndërtesave publike dhe vend parkingjeve, përmirësimi i ndriçimit të rrugëve dhe hapësirave publike, shtimi i sigurisë dhe dizajnimi i kulartëve banesore, bërthamave të qytetit dhe vend parkimeve, marrja në konsiderim të kërkesave të sigurisë me rastin e planifikimit të transportit publik dhe dhënies së lejeve në përgjithësi, mënjanimi i mirë me rastin e serviseve lokale dhe niveli adekuat i patrullimit preventiv);
- Marrja me problemet specifike të krimit (thyerja e banesave, dhuna në familje, kriminaliteti lidhur me vetura, krimet në baza racore, krimet ndaj fëmijëve dhe ndaj pleqve);
- Ndihma viktimeve të krimit dhe zvogëlimi i frikës nga kriminaliteti (skemat për

---

<sup>114</sup> Muratbegović, Elmedin, Prandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë/Prishtinë, prill, 2007, fq.77.

ndihmë viktimave, nismat për vetë mbrojtje, sigurimi i publicitetit pozitiv për nisma të suksesshme).<sup>115</sup>

Në aktivitetin preventiv të policisë ekzistojnë parime të caktuara të cilave ajo duhet t'u përmbahet vazhdimisht. I pari prej atyre parimeve është që në kuadër të parandalimit të kriminalitetit popullsia të njihet me problemet aktuale të kriminalitetit dhe të nxitet për ndryshimin e shprehive të caktuara që mund të kontribuojnë në paraqitjen e kriminalitetit. Kjo fushë e veprimtarisë së policisë është shumë delikate dhe ka rëndësi vendimtare për parandalimin e suksesshëm të kriminalitetit. Të ndikosh në popullsinë që të pranojë nevojën për parandalim, përkatësisht për mbrojtje nga kriminaliteti dhe të mendojë në atë drejtim, t'i ndryshojë shprehitë e fituara dhe të aplikojë shprehitë e reja në jetën e vetë, është veprimtari shumë komplekse, sepse në realizimin e saj hasen një varg pengesash, ndër të cilat sidomos vihet në dukje frika nga kriminaliteti dhe kriminelët, që çdo ditë është gjithnjë e më i madh; pritja se kriminaliteti do ta godasë dikë tjetër; dëshira për të mos u përzier në punët e huaja dhe dyshimi tek disa individë ndaj policisë. Parandalimi i suksesshëm nënkupton kontaktimin e policisë me një numër të madh qytetarësh, në raport me popullatën e gjithëmbarshme të një vendi të caktuar. Tek policët ekziston tendenca që kryesisht të kontaktojnë me kriminelët, viktimat e kriminalitetit dhe pjesërisht me viktimat potenciale, kështu që pjesa më e madhe e popullsisë qëndrojnë anash në mënyrë pasive.<sup>116</sup>

Çështjet më aktuale të parandalimit të kriminalitetit nga ana e policisë sot kryesisht lidhen me parandalimin që organizohet në nivel të bashkësisë lokale, përkatësisht në të ashtuquajturin sektorin policor. Prej disa modeleve të mundshme të veprimit preventiv të qytetarëve dhe të policisë në regjionin lokal në punë janë pasqyruar dy modele themelore për të cilat sot me të madhe debatohet në botë dhe tek ne. Modelet në rend të parë kanë të bëjnë me: kontrollin kriminalistik si segment i operativës kriminalistike të orientuar në hartimin e planeve preventive, në veprimin e pavarur preventiv të qytetarëve në bashkësinë lokale. Këto dy modele, që në esencë përjashtohen reciprokisht por i plotësojnë disa segmente të veprimtarisë së vet, paraqesin

---

<sup>115</sup> Morgan, R., Newburn, T.: The Future of Policing, Oxford, 1997., marrë nga Ignjatoviq, GJ., „Kriminologjia“, J.P. „Fleta Zyrtare“, Beograd, 2005., fq. 344-345.

<sup>116</sup> Muratbegoviq, Elmedin, Prandalimi i Kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë/Prishtinë, prill, 2007, fq.71.

bazën kualitative për parandalimin e kriminalitetit. Modelet e cekura, secili për vete, ofrojnë edhe mundësinë e përcaktimit sipas kushteve konkrete të aplikimit.<sup>117</sup>

Në kuadër të fushëveprimit të përgjegjësisë dhe të detyrave të policisë kriminalistike me siguri radhitet edhe veprimtaria preventive. Qëllimi i kësaj veprimtarie është pengimi i kryerjes së veprave penale nga ana e atyre personave në sjelljen e të cilëve mund të prognozohet sjellja kriminale, devijuese ose madje edhe para delikente. Interesimin më të shpeshtë të policisë kriminalistike tërheqin kategoritë specifike të kriminelëve dhe më së shpeshti flasim për recidivistët e shumëfishtë. Pasi që është fjala për pjesën dinamike të një strukture komplekse organizative të policisë, në veprimtarinë e këtij shërbimi numërohen edhe të ashtuquajturat obligimet e grumbullimit të të gjitha njoftimeve dhe informatave që vejnë në dukje gjendjet përkatëse interesante për sigurinë. Pasi që kriminalistika për një kohë të gjatë është lidhur ekskluzivisht me veprimin reaktiv (represiv) përmes prizmit të vetë heuristik dhe silogistik, do të jetë e domosdoshme të definohet në mënyrë primare segmenti preventiv i kësaj shkence, përkatësisht aktivitetet preventive që është e mundur të realizohen në kuadër të kësaj veprimtarie.<sup>118</sup>

Përvojat paraprake pozitive dhe negative, problemet në punë kërkesat e publikut dhe rezultatet e analizave të metodave të shfrytëzuar në njërën anë si dhe zhvillimi dinamik i të gjitha segmenteve të jetës shoqërore të civilizimit sot në anën tjetër po e shtyn policinë në forma të reja të aktivitetit dhe të organizimit.<sup>119</sup>

### **3. Roli i prokurorisë publike në parandalimin e veprave penale të dhunimit**

Duke u bazuar në parimin akuzator, sipas të cilit nuk ka gjykim pa paditës *nemo iudex sine actore*, procedura penale nuk mund të zhvillohet pa akuzë të paditësit të autorizuar.<sup>120</sup>

Në të drejtën e Republikës së Maqedonisë, Prokuroria publike është i vetmi organ shtetëror unik dhe i pavarur, i cili ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave tjera ndëshkuese të përcaktuara me ligj, dhe kryen punë të tjera të parashikuara me ligj. Prokuroria publike

<sup>117</sup> Krivokapiq, V.: “Preventiva e kriminalitetit”,- “Akademia Policore”, Beograd, 2002, fq.9-31.

<sup>118</sup> Muratbegović, op. cit., fq.70-72.

<sup>119</sup> Abazović, Mirsad, Muratbegović, Elmedin, Halilović, Haris, Budimliq, Muhamed, Beqireviq, Edina, Politika e luftimit të kriminalitetit, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.74.

<sup>120</sup> Zejneli, Ismail, Sahiti, Ejup, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.91.

funksionet e saj i kryen në bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e vendit. Funkzioni e Prokurorisë Publike e kryen Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokurorët publik. Prokurori publik e kryen funksionin e tij në bazë ligjore, të paanshme dhe objektive, respekton dhe mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe të drejtat e personave tjerë juridik, dhe brenda kufijve të kompetencave të veta, në emër të shoqërisë përkujdeset për efikasitetin e sistemit të së drejtës penale. Prokurori Publik siguron barazinë e qytetarëve para ligjit në realizimin e të drejtave të tyre, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, përkatësia etnike, statusi social, bindja politike ose besimet fetare dhe pronësia.<sup>121</sup>

Organet e judikaturës (prokuroria publike, gjykata penale, organet për ekzekutimin e sanksioneve penale), me funksionet e veta represive kanë për detyrë t'i përcjellin dhe analizojnë dukuritë me interes për realizimin e funksioneve të veta, përkatësisht të japin propozime për pengimin e dukurive të rrezikshme shoqërore dhe të atyre që nuk janë inkriminuese, por që paraqesin shkelje ose rrezikim të të mirave ose të interesave përkatëse shoqërore. Kjo ka për qëllim forcimin e ligjshmërisë dhe të përgjegjësisë në shoqëri. Roli preventiv i organeve përkatëse të judikaturës qëndron në bashkëpunimin reciprok të funksioneve të judikaturës dhe përcjelljen e dukurive të tilla shoqërore, gjë që funksionet represive, postdeliktore të atyre organeve i bën kreative. Në esencën e veprimit të vet represiv është i mundur pengimi i shfaqjes krimogjene dhe ndërmarrja e masave në mënjanimin e shkaqeve të sjelljeve të ndryshme devijuese dhe të erozionit të moralit.<sup>122</sup>

Funksioni represiv i prokurorit në sistemin tonë juridik është rregulluar në mënyrë precize me anë të ligjit. Prokurorit publik – si një nga tri subjektet themelore në procedurën penale – për funksionin e vet ka ndjekjen penale, që ka rëndësi të madhe kriminale – politike, sepse paraqet garancion për ruajtjen e interesit publik dhe privat në rast të shkeljes ose të rrezikimit të tij. Ky funksion me këtë realizon edhe një pjesë të rëndësishme të strategjisë kriminale – politike të shoqërisë tendenca themelore e të cilës është lufta efikase kundër kriminalitetit.<sup>123</sup>

---

<sup>121</sup> Ligji për Prokurorinë Publike i Republikës së Maqedonisë, nenet 2-5.

<sup>122</sup> Muratbegoviq, op.cit., fq.126.

<sup>123</sup> Muratbegoviq, op.cit., fq.127.

Duke vlerësuar interesat e caktuara shoqërore, kushtet ligjore dhe kushtet e tjera, prokurori publik merr vendimin mbi iniciativën për fillimin e procedurës penale. Iniciativa e prokurorit publik për fillimin e procedurës penale, kur ekziston dyshimi i bazuar se i dyshuari ka kryer veprën penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare, përbën bazën në të cilën ndërtohet funksioni mjaft kompleks dhe i rëndësishëm shtetëror i atij organi. Këtë rol të prokurorit nuk duhet vështruar në mënyrë pasive dhe pavarësisht nga mundësia e veprimit të tij vetë iniciativë dhe kreativ, duke pasur parasysh faktin se funksioni i prokurorit në masë të konsiderueshme nënkupton jo vetëm parimin e legalitetit, por edhe parimin e oportunitetit. Ky parim i dytë paraqet mundësinë që prokurori të mos iniciojë procedurën penale ndaj kryerësit të veprës penale nëse rrethanat e veprës dhe të kryerësit e bëjnë ndjekjen penale joracionale dhe jo oportune.<sup>124</sup>

Në kuadër të politikës së luftimit të kriminalitetit rëndësi të veçantë ka harmonizimi, përkatësisht harmonia që realizohet në raportet midis politikës ndëshkimore të ligjdhënësit dhe të politikës ndëshkimore të gjykatave. Prokuroria publike nuk mund të jetë anash këtyre raporteve, por politikën e vet të ndjekjes penale në një pjesë të konsiderueshme duhet ta harmonizojë me politikën ndëshkimore. Prokuroria ka mundësinë që, me mjete juridike, në çdo rast individual, të shprehë mospajtimin e vet me vendimin gjyqësor, me ç'rast si edhe gjykata duhet t'u përmbahet normave të ligjit mbi procedurën penale dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me punën e atyre organeve.

Mbrojtja e interesit publik nga ana e prokurorisë nuk shterohet ekskluzivisht përmes funksionit të ndjekjes penale, përkatësisht mbrojtja e interesit shoqëror që ka të bëjë me ndjekjen penale dhe dënimin e kryerësit të veprës penale është vetëm një pjesë e funksionit të rëndësishëm të prokurorit publik. Roli tjetër jo më pak i rëndësishëm është funksioni i tij preventiv që konsiston në pengimin e kriminalitetit. Funksioni preventiv i prokurorisë publike është jashtë procesor, por në këtë organ, edhe pse minimal, gjithmonë ka qenë në obligimin kushtetues dhe ligjor, bashkë me atë represiv që konsiston në ndjekjen penale dhe që është shumë më voluminoz.<sup>125</sup>

Funksioni themelor i prokurorit publik ofron mundësinë që ato organe të njihen me dukuritë e shumta dhe faktorët që janë të pashmangshëm në krijimin e politikës kriminale dhe të strategjisë shoqërore të kundërvënies ndaj kriminalitetit. Në këtë shikim dhe analizë të kriminalitetit janë

---

<sup>124</sup> Po aty.

<sup>125</sup> Krivokapiq, V., FSHK, Sarajevë, 2006., fq. 238-240.



shumë të rëndësishme aspektet e tij etiologjike dhe fenomenologjike, ndër të cilat vend të veçantë kanë sjelljet që nuk janë inkriminuar me ligj, por janë mjaft të dëmshme për shoqërinë nëse shkelen ose rrezikohen të mirat dhe vlerat shoqërore ose kërcënohen në këtë drejtim.<sup>126</sup>

Obligimi preventiv i prokurorisë konsiston në përcjelljen dhe analizën e dukurive të caktuara në shoqëri, para së gjithash të atyre kriminogjene, të cilat me manifestimet e veta kërcënojnë t'i rrezikojnë të mirat dhe vlerat shoqërore, përkatësisht të shkaktojnë shfaqjen kriminale. Hapi tjetër në paraqitjen preventive të prokurorit publik është që përmbajtjet e tilla analitike, me shikimin e shumanshëm të kriminalitetit, si dhe tendencat që e përcjellin t'i orientojë drejt subjekteve përkatëse të politikës së kriminalitetit. Kjo detyrë e rëndësishme e prokurorit publik finalizohet me dhënien e propozimeve dhe të sugjerimeve përkatëse konstruktive me qëllim të luftimit të trendëve të caktuara kriminale dhe të faktorëve kriminogjenë. Problemet që paraqiten me rastin e aplikimit të ligjit, si dhe tejkalimi i zgjidhjeve ligjore, obligojnë prokurorinë publike dhe gjykatën që, lidhur me këtë, të fillojnë iniciativën për ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve dhe të praktikës ligjore. Me këtë prokurori publik - si organ shtetëror në mbrojtjen e interesave të bashkësisë shtetërore – pa dyshim ndikon edhe në politikën ndëshkimore që zhvillohet në shoqëri.<sup>127</sup>

Krahas funksionit themelor të prokurorit ky organ shtetërorë është i autorizuar në një masë të konsiderueshme i obliguar të kryej edhe funksione tjera në luftimin e kriminalitetit. Ndonëse potencialet kryesore të prokurorisë janë të orientuara në funksionin themelor, nuk guxon të ndodh të lehen pas dore punët të cilat në esencë kanë karakter preventiv. Shkasë për një lëshim të tillë është fakti se pikërisht prokuroria si organ që posedon të dhënat më kualitative për kriminalitetin në një bashkësi, e bënë atë të obligueshme që ato të dhëna ti shfrytëzojë edhe në aktivitetet qëllimi i të cilave është pengimi i kryerjes së veprave penale. Funksionet e prokurorisë për të cilat pohohet se kanë elemente preventive ndër të tjera janë: a) përcjellja dhe analizimi i dukurive të caktuara në shoqëri (kriminogjene), të cilat me manifestimin e vet kërcënojnë ti rrezikojnë të mirat dhe vlerat shoqërore gjegjësisht të sjellin deri tek manifestimi kriminal; b) përmbajtjet e tilla analitike si dhe tendencat që e përcjellin atë ti drejtojnë kah disa subjekte të

---

<sup>126</sup> Krivokapiq, op.cit., fq.240.

<sup>127</sup> Ibid, fq.238.

politikës kriminale (propozimet dhe sugjerimet për luftimin e trendeve të caktuara kriminale dhe faktorëve kriminogjen).<sup>128</sup>

*Përgjegjësitë e Prokurorit publik:* Prokurori publik ka për detyrë të shqyrtojë provat e një rasti të dhunës seksuale për të përcaktuar nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme për të justifikuar dhe mbështetur ndjekjen penale të rastit. Prokurori ka kompetencë të iniciojë procedurë penale sipas detyrës zyrtare (ex officio), prokurori duhet të veprojë brenda autorizimeve ligjore me qëllim që ti ofrojë siguri viktimës së dhunës seksuale.

Në ushtrimin e funksionit të ndjekjes penale, prokurori publik: ka autorizime të cilat i posedon edhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe organet tjera shtetërore për zbulimin e krimeve dhe kryerësve të tyre, dhe mbledhjen e provave për ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale; në procedurën para hetimore ka autorizim të japë urdhra për caktimin e masave të veçanta hetimore; e udhëheq procedurën paraprake dhe i ka në shërbim personat e autorizuar zyrtar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë Financiare dhe Drejtorinë Kufitare në përputhje me ligjin; mund të ndërmarrë çdo veprim për zbulimin dhe ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale për të cilën sipas ligjit është e autorizuar Ministria e Punëve të Brendshme, Policia Financiare dhe Drejtoria kufitare; të vendos për fillimin ose vazhdimin e ndjekjes penale të kryerësve të veprave penale; të ngrej dhe të përfaqësoj aktakuza para gjykatave; të paraqes mjete të rregullta juridike ose mjete të jashtëzakonshme kundër vendimeve të gjykatës; të dorëzojë kërkesë për nisjen e procedurës kundërvajtëse; të kryejë punë të tjera të përcaktuara me ligj. Prokurori publik kryen edhe veprime tjera të përcaktuara me ligj për funksionimin efikas të ligjit, sistemit të drejtësisë penale dhe parandalimit të krimit.<sup>129</sup>

Gjykata, prokuroria publike dhe policia janë të obliguara ta këshillojnë viktimën për të drejtat e saj më së voni para marrjes në pyetje për herë të parë për të cilën hartojnë shënim zyrtar ose procesverbal, edhe atë si: para hetimit të bisedojë me këshilltar pa pagesë ose me persona të autorizuar, nëse në procedurë merr pjesë si i dëmtuar; të merret në pyetje nga personi i të njejtës gjini në polici dhe në prokurorinë publike; të mos përgjigjet në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me jetën personale të viktimës, ndërsa nuk janë të lidhura me veprën penale; të kërkojë marrjen në

---

<sup>128</sup> Stojanoviq, Z.: „Politika e luftimit të kriminalitetit“, Novi Sad, 1991, fq. 84.

<sup>129</sup> Ligji për Prokurorinë Publike i Republikës së Maqedonisë; neni: 30.

pyetje me ndihmën e mjeteve audio-vizuele të zërit në mënyrë të përcaktuar me ligj dhe të kërkojë mënjanimin e publikut nga seancat kryesore.<sup>130</sup>

#### **4. Roli i gjykatave në parandalimin e veprave penale të dhunimit**

Gjykatat janë organe shtetërore të pavarura të cilave u përket pushteti gjyqësor. Gjykatat mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, të drejtat e përcaktuara me ligj dhe interesat e subjekteve juridike dhe sigurojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Pra, krahas bartësve të pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, gjykatave u takon funksioni i tretë themelor i bazuar në rendin juridik i shtetit të themeluar bashkëkohor demokratik. Gjykatat në njërin anë realizojnë mbrojtjen e rolit sipas të drejtave të garantuara me ligj interesat dhe liritë e qytetarëve, në anën tjetër plotësojnë rolin e garantimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë si themel i sundimit të ligjit.<sup>131</sup>

Parimi i Shtetit të së Drejtës është i lidhur ngushtë me mirëfunksionimin e pavarur të pushtetit gjyqësor, i cili si një prej funksioneve të shtetit, garanton mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e akteve normative të vendosura në sajë të funksionit ligjvënës. Duke iu referuar konstitucionalistit francez Moris Duverger,<sup>132</sup> mund të sjellim në vëmendje funksionin e trefishtë të gjykatave, që vijon me respektimin e hierarkisë së normave, interpretimin dhe zbatimin e normave, interpretimin dhe zbatimin e së drejtës. Në këtë veprimtari, interpretimi i normës juridike, ka kufijtë e gjerë të përzgjedhjes, pasi jo gjithmonë përmbajtja e normës është e njëkuptimshme. Shpeshherë, mund të lindin kundërshtime gjatë interpretimit të saj. Prandaj, është e nevojshme që shteti të zotëroj instrumentet e tij për të siguruar vullnetin normativ të vlefshëm për çdo rast konkret, gjë që lidhet sidomos me ekzistencën e gjyqësorit.

*Organizimi i gjykatave:* Gjykata është subjekt themelor i procedurës penale. Ajo në procedurë penale e ushtron funksionin e gjykimit, mirëpo funksioni i saj nuk kufizohet vetëm në funksionin e gjykimit.<sup>133</sup>

---

<sup>130</sup> Ligji për Procedurë Penale i Republikës së Maqedonisë; neni 55.

<sup>131</sup> Krivokapiq, V., FSHK, Sarajevë, 2006, fq. 240.

<sup>132</sup> Omari, Luan, Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese, botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2011, fq. 82-83.

<sup>133</sup> Zejneli, Ismail, Sahiti, Ejup, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.68.

Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat janë të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën. Janë të ndaluara gjykatat e jashtëzakonshme. Llojet kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedurat para tyre, rregullohen me ligj, i cili miratohet me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.<sup>134</sup>

Qëllimet dhe funksionet e gjyqësorit përfshijnë: ushtrim i paanshëm i së drejtës pavarësisht statusit dhe pronës së palëve; mbrojtjen, respektimin, promovimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut; sigurimin e njëshmërisë, barazisë mos diskriminimit në çfarëdo mënyre; dhe mbrojtjen e sigurisë juridike duke u bazuar në sundimin e ligjit.

Gjykata vendos në procedurë të përcaktuar me ligj: të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe interesat e bazuara në ligj; mosmarrëveshjet ndërmjet qytetarëve dhe personave tjerë juridik; për vepra penale dhe kundërvajtje; për çështje tjera që janë nën juridiksionin e gjykatës.<sup>135</sup>

Pushtetin gjyqësor në Republikën e Maqedonisë e ushtrojnë gjykatat themelore, gjykatat e apelit, Gjykata Administrative dhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë. Gjykatat themelore, themelohen për një ose më shumë komuna dhe kanë kompetencë lëndore themelore ose të zgjeruar. Në kornizën e disa gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar themelohen seksione gjyqësore të specializuara që veprojnë në konteste të llojeve të caktuara. Gjykatat themelore mund të kenë seksione gjyqësore, mund të gjykojnë jashtë selisë së gjykatës, si dhe mund të kenë ditë gjyqësore jashtë selisë së gjykatës.<sup>136</sup>

Gjykatat e apelit themelohen për rrethin e më shumë gjykatave themelore të caktuara sipas ligjit. Selitë e gjykatave të apelit janë në : Manastir, Gostivar, Shkup dhe Shtip. Gjykata Administrative dhe Gjykata Supreme janë themeluar dhe kryejnë funksionin gjyqësor për të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, me seli në Shkup.<sup>137</sup>

Procedura para gjykatës është e rregulluar me ligj dhe udhëhiqet në bazë të parimeve në vijim: ligjëshmërisë dhe legjitimitetit; i barazisë së palëve; gjykimit në kohë të arsyeshme; drejtësisë; i

---

<sup>134</sup> Shasivari, Jeton, E Drejta Kushtetuese, Shkup, 2015, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 98.

<sup>135</sup> Ligji për Gjykatat i Republikës së Maqedonisë; nenet 3-4.

<sup>136</sup> Ligji për Gjykatat i Republikës së Maqedonisë, nenet 22-23.

<sup>137</sup> Ligji për Gjykatat i Republikës së Maqedonisë, nenet 24-26.

publicitetit dhe transparent; kontradiktor; shumëshkallësh; gojor; me shkrim; drejtpërdrejt; mbrojtjes; çmuarjes së provave sipas bindjes së lirë; dhe ekonomikitetit.<sup>138</sup>

Me që ekzistojnë vepra penale të llojllojshme për nga rëndësia e tyre dhe gjykata të ndryshme si për nga lloji ashtu edhe për nga numri i tyre, është e domosdoshme që ndërmjet gjykatave të bëhet ndarja e punës në çështjet penale në mënyrë që të dihet se cila gjykatë duhet të veprojë në një çështje penale konkrete. Për përcaktimin e kompetencës së gjykatës penale ekzistojnë kritere të ndryshme. Marrë në përgjithësi, kompetenca e gjykatave paraqet të drejtë dhe detyrë të një gjykate që ta zbardh dhe ta zgjidhë një çështje penale duke e pasur parasysh llojin dhe rëndësinë e veprës penale, raportin mes çështjes penale dhe vendit të kryerjes së saj, cilësinë e kryerësit të saj, dhe llojin e veprimit procedural penal. Në bazë të kësaj që u tha shihet se ekzistojnë disa kritere për përcaktimin e kompetencës së gjykatës penale: a. lloji dhe rëndësia e veprës penale, b. vendi në të cilin gjykata e ushtron funksionin e gjykimit, c. cilësia e kryerësit të veprës penale, dhe d. lloji i veprimeve procedural-penale.<sup>139</sup>

Gjykatat në Republikën e Maqedonisë përmbajnë tre lloje kompetencash, edhe atë kompetencë lëndore, kompetencë territoriale dhe kompetencë personale dhe funksionale.

Në vijim do të paraqesim konkretisht kompetencën lëndore në lëmin penal të gjykatave në Republikën e Maqedonisë. Në Republikën e Maqedonisë procedohen të gjitha çështjet penale në gjykatë themelore si gjykatë e shkallës së parë, disa gjykata themelore kanë kompetencë themelore, kurse të tjerat kompetencë të zgjeruar.

Gjykatat themelore kanë kompetencë lëndore themelore të vendosin:

1. për vepra penale për të cilat me ligj është paraparë si dënim kryesor dënimi me burgim deri në pesë vjet, nëse për disa vepra penale nuk është paraparë kompetencë e gjykatës tjetër;
2. për veprat penale për të cilat me ligj të veçantë është përcaktuar kompetencë e gjykatës me kompetencë themelore;
3. për ankesa dhe kundërshtime për të cilat janë kompetente këto gjykata.

---

<sup>138</sup> Ligji për Gjykatat i Republikës së Maqedonisë, neni 10.

<sup>139</sup> Zejneli, Ismail, Sahiti, Ejup, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017, fq.79.

Ndërsa gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, përveç gjykimit të veprave penale të sipër theksuara, janë kompetente të vendosin edhe:

1. për veprat penale për të cilat me ligj është paraparë dënim me burgim mbi pesë vjet dhe për veprat penale të kryera nga personat e mitur;
2. të vendosin për ankesat dhe kundërshtimet në procedurat për të cilat janë kompetente;
3. të vendosin për procedurat për ndihmë juridike ndërkombëtare të përcaktuar me ligj;
4. të veprojnë në çështjet e ekstradimit.<sup>140</sup>

Gjykatat e apelit janë kompetente:

1. të vendosin për ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore në territorin e vet, (çka do të thotë se gjykata e apelit gjykon në shkallë të dytë);
2. të vendosin për ndeshje kompetencash midis gjykatave të shkallës së parë në territorin e tyre; dhe
3. të kryejnë punë tjera të përcaktuara me ligj.<sup>141</sup>

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë është kompetente:

1. të vendosë në shkallë të dytë kundër vendimeve të kolegjeve kur ajo është përcaktuar me ligj;
2. të vendos në shkallë të tretë dhe të fundit ndaj ankesave kundër vendimeve të gjykatës së apelit;
3. të vendos për mjetet e jashtëzakonshme juridike të paraqitura kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe vendimeve të kolegjeve të veta, siç është paraparë me ligj;
4. të vendos për ndeshje të kompetencave midis gjykatave themelore nga territori i gjykatave të ndryshme të apelit, për ndeshje të kompetencave midis gjykatave të apelit, dhe të vendosë për bartjen e kompetencës vendore te këto gjykata;

---

<sup>140</sup> Po aty, fq.80.

<sup>141</sup> Ligji për Gjykatat i Republikës së Maqedonisë, neni 33.

5. të vendosë për kërkesat e palëve dhe të pjesëmarrësve tjerë procedural të paraqitur për shkak të cenimit të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë;
6. të kryejë punë të tjera të përcaktuara me ligj.<sup>142</sup>

Normat e legjislacionit penal paraqesin mjet të domosdoshëm të funksionimit të legjislacionit penal i cili e realizon detyrën e vet duke vepruar sipas këtyre normave. Në një numër të madh shtetesh normat themelore ligjore sipas dispozitave të cilave gjykatat vepronë janë ligji penal (material) dhe ligji mbi procedurën penale. Me të parin janë të inkriminuara të gjitha ato sjellje të cilat bashkësia e caktuar i konsideron vepra penale të formës më të rëndë kundërligjore dhe sjelljet e rrezikshme shoqërore, pastaj dispozitat mbi fajësinë dhe dispozitat e përgjithshme mbi sanksionet penale të cilat mund të shqiptohen kryerësve të atyre veprave. Ligji i dytë ka të bëjë me të gjitha elementet e procedurës penale të karakterit procedural.<sup>143</sup>

Kontributi i gjykatës në përcaktimin e të vërtetës në procedurën penale është i pazëvendësueshëm. Procedura kontradiktore i këtyre dy palëve (i akuzuari dhe prokurori) në kontest zhvillohet para gjykatës si arbitër. Kur konstaton se gjendja faktike është vërtetuar mjaft dhe se mund të deklarohet për atë se vepra konkrete a mund të futet nën normën e përgjithshme për të cilën prokurori ka sugjeruar, gjyqi vepron në nxjerrjen e veprimit në të cilin deklarohet për procedurën e veprës penale, fajësinë e të akuzuarit dhe përcaktohet për sanksionin të cilin sipas tij duhet zbatuar. Pikërisht ky vendim me të cilin gjykata vendos për sanksionin të cilin do ta shqiptojë ndaj të gjykuarit për vepër penale, shprehet instrumenti themelor me të cilin ky organ shtetëror vendoset në pozitën e njërit nga bartësit kyç të politikës së luftimit të kriminalitetit. Aktgjykimi me të cilin në një masë të caktuar të gjykuarit i pezullohet njëra ndër të drejtat dhe liritë e garantuara, shpreh funksionin represiv të cilin e realizon gjykata. Megjithatë kjo masë represive ka edhe karakterin e saj preventiv sepse çdo sanksion i shqiptuar penal duhet të jetë në pajtim me qëllimin e paramenduar si ndaj kryerësit ashtu edhe ndaj rrethit të ngushtë dhe të gjerë. Në të vërtetë sanksionet e shqiptuara penale-juridike duhet të realizohen përmes dy dimensioneve ndikuese. Njëra ka të bëjë me kryerësin të cilit i shqiptohet sanksioni dhe ka për qëllim që atë ta pengojë nga kryerja e mëtejme e veprave penale dhe me të cilin ndikohet në

---

<sup>142</sup> LGJRM, neni 37.

<sup>143</sup> Milutinović, M.: „Politika Kriminalistike“ – „Savremena administracija“, Beograd, 1984., fq. 197-208.

edukimin e tij kurse e dyta ka të bëjë me bashkësinë ndaj së cilës sanksioni i njëjtë i shqiptuar duhet të ushtrojë ndikim në të tjerët që ta respektojnë sistemin juridik dhe të mos kryejnë vepra penale. Në terminologjinë penalo-juridike dhe kriminologjike e para quhet preventivë speciale kurse e dyta preventivë e përgjithshme (gjenerale).<sup>144</sup>

Proceset gjyqësore karakterizohen me faktin se veprimet procedurale dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve janë rregulluar detajisht me norma ligjore procedurale. Normat procedural urdhërojnë, ndalojnë, ose autorizojnë. Megjithatë, duke i rregulluar me ligj veprimet procedurale dhe marrëdhëniet procedurale ende nuk sigurohet drejtshmëria e vendimit të cilin gjykata do ta sjellë. S'ka dyshim se ndodhitë psikike në procedurë penale janë më intensive se sa në procedurat tjera gjyqësore, efektet psikologjike të këtij procesi janë më të forta se sa në procedurat tjera.<sup>145</sup>

Gjyqi në vetvete i ngjanë një drame, ku përfshihen jo vetëm personat e skenës, por edhe ata që e kanë përgatitur, që e kanë vënë në skenë madje edhe spektatorët, ata që e ndjekin, e shikojnë dhe e vlerësojnë. Gjyqtarët bëjnë deklarinimin e hapjes së procesit gjyqësor, dëshmitarët u përgjigjen pyetjeve, avokatët japin argumentet e tyre, gjyqtarët udhëzojnë jurinë (kur është e pranishme) e pastaj shqiptojnë aktgjykimin. Në këtë proces të gjatë ka shumë probleme, duke filluar me pasaktësinë e provave e deri tek tendencioziteti e ndikimet e gjyqtarëve, që përpunohen e vlerësohen në këtë ndërmarrje të madhe njerëzore.<sup>146</sup>

Në ato raste kur ligjet shtetërore nuk ofrojnë mbrojtje të duhur apo më mirë thënë mbrojtje adekuate dhe efikase nga dhuna seksuale ose kur në praktikën gjyqësore dhe në organet e punëve të brendshme hasim elemente diskriminuese dhe nënçmuese, kjo lloj “dhune” mund të riprodhohet nga organet shtetërore pa ndonjë rrezik nga pasojat. Ndikimet e jashtme si mos përfillja e viktimës, paragjykimet e rrethit në bashkësinë e caktuar, fajësimi i viktimës mund të jenë indikatorë që luajnë rol në marrjen e vendimeve të gjykatës, e cila shprehet me mos aprovimin e disa veprave penale që bien në kreun e veprave penale kundër integritetit seksual, kryerësve u shqiptohen dënime të vogla apo masa tjera alternative, ku në atë rast shprehet viktimizimi sekondar i viktimës dhe rritja e dëmit që asaj/atij i shkaktohet dhe arrihet e shkelja

---

<sup>144</sup> Lazareviq, LJ.: Legjislacioni penal si bazë për konstituimin e politikës së luftimit të kriminalitetit.

<sup>145</sup> Sahiti, Ejup, Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë, 2007, fq.8.

<sup>146</sup> Dragoti, fq.523.



plotësuese e të drejtave dhe lirive të saj/tij, duke përfshirë dëmin emocional që asnjëherë nuk mund të rikuperohet.

Dukuritë të cilat zvogëlojnë efektet dhe pjesëmarrja e gjykatave në luftimin e kriminalitetit:<sup>147</sup> *Stërngarkimi* paraqet një dukuri negative që dukshëm zvogëlon efektet dhe pjesëmarrjen e gjykatave në luftimin e kriminalitetit. Stërngarkimi i gjykatave është pothuajse një dukuri universale sepse paraqitet në të gjitha sistemet bashkëkohore gjyqësore. Zgjidhja e këtij problemi vështirë mund të shihet në rastet e shtimit të vazhdueshëm të numrit të gjyqtarëve dhe personelit tjetër, atë duhet kërkuar në përzgjedhjen e lëndëve penale (që duhet të arrihet si me zvogëlimin e numrit të inkriminimeve gjegjësisht ngushtimin e zonës kriminale të cilën e përfshijnë ato si dhe me rregullimin e kritereve ligjore për selektimin dhe zbatimin e të drejtës penale) sikurse edhe në organizimin më të mirë të gjykatave.

*Zgjatja e procedurës gjyqësore gjegjësisht vazhdimi i gjatë i procedurës së shkallës së parë është njëra ndër të metat themelore në punën e gjykatave. Edhe vet organet gjyqësore janë të vetëdijshme se për kryerjen e mirë të funksionit gjyqësor rëndësi të madhe ka zgjatja e procedurës gjegjësisht procedura të zvogëlohet në kufijtë e arsyeshëm.*<sup>148</sup>

*Pavarësia në ushtrimin e pushtetit gjyqësor – mëvetësia, gjykata duhet të jetë deri në fund e pavarur dhe autonome, e liruar nga “direktivat e politikës ditore dhe praktikizmi” si dhe nga presionet të cilat mund ta sjellin në pyetje ushtrimin e mirë të funksionit gjyqësor dhe ta shkatërrojnë autoritetin e gjykatës në popull. Gjykata nuk guxon të jetë nën presion dhe të gjykojë nën presion. Duhet që në çështjen konkrete penale gjykata të nxjerrë vendimin në bazë të ligjit dhe bindjes së saj gjyqësore në mënyrë të pavarur nga çfarëdo ndikimi anësor.*<sup>149</sup>

## **5. Rëndësia preventive e ekzekutimit të sanksioneve penale**

Ekzekutimi i sanksioneve penale paraqet fazën përfundimtare në realizimin e së cilës valorizohen tri fazat paraprake: zbulimi dhe paraqitja, ndjekja penale dhe gjykimi i çështjes penale. Aq më tepër, në këtë fazë realizohet efekti preventiv i sanksioneve penale të realizuara

<sup>147</sup> Abazović, Muratbegović, Budimliq, Beqireviq, op.cit., fq.79.

<sup>148</sup> Ignjatović, G.J.: „Kriminologija“, J.P. „Fleta Zyrtares“, Beograd, 2005., fq. 365.

<sup>149</sup> Milutinović, M.: „Politika Kriminalistike“ – „Savremena administracija“, Beograd, 1984., fq. 170.

përmes aplikimit të tyre, por edhe procedura kriminale – politike, ligjore dhe gjyqësore në shqiptimin dhe aplikimin e sanksioneve penale. Politika ndëshkimore e ligdhënësit dhe e gjykatave në këtë mënyrë ka verifikimin dhe arsyeshmërinë e vet të plotë. Me një fjalë, duke u nisur nga qëllimi i sanksioneve penale (ligdhënësi), dhe i caktimit dhe shqiptimit (gjykata penale), deri te aplikimi (organi për ekzekutim), përkatësisht deri te efekti i fundit mund të vlerësojmë në çfarë mase sanksioni penal në përgjithësi plotëson funksionin e vet preventiv. Për këtë arsye rezultatet preventive që realizohen në këtë plan, e që në mënyrën më të plotë mund të maten me shkallën e recidivizmit, janë kompetent edhe për vlerësimin e kontributit të përgjithshëm të politikës kriminale në pengimin dhe luftimin e kriminalitetit.<sup>150</sup>

Rezultatet preventive të sanksionit të përcaktuar dhe të aplikuar penal pasqyrohen në efektet e preventimit të përgjithshëm dhe individual dhe ato si të tilla kanë rëndësi të veçantë kriminale – politike. Ato efekte preventive kanë të bëjnë si me llojin e caktuar të kriminalitetit, ashtu edhe me kryerësin. Rëndësia e tillë pluraliste preventive e sanksioneve është meritore për politikën e kundërvënies ndaj kriminalitetit në tërësi. Interesi kriminal – politik, qoftë i përcaktimit, qoftë i aplikimit, padyshim është i madh, me ç'rast kujdes të veçantë duhet kushtuar pikërisht aplikimit të sanksionit dhe të efekteve të tij.<sup>151</sup>

Kur është fjala për kryerësin, është plotësisht e sigurt se efektet preventive të sanksionit nuk realizohen me aplikimin e tij abstrakt, por ajo do të bazohet në individualizimin dhe në ndërmarrjen e masave të caktuara me qëllim të rehabilitimit sa më të suksesshëm social, të masave dhe të veprimeve të ndryshme mjekësore, psikologjike, pedagogjike, në mënyrë që të gjitha këto të harmonizuara reciprokisht të zvogëlonin mundësinë që personi ndaj të cilit aplikohen masat të kryej vepra të reja penale. Parimi i prevencionit individual përcakton që të aplikohet individualizimi i procedurës sipas të të dënuarit me rastin e aplikimit të sanksionit, e në pajtim me karakteristikat e personalitetit, në mënyrë që të realizohet kështu efekti preventiv sa më i plotë që është i mundur. Qëllimi i atyre masave, nëse konsistojnë në heqjen e lirisë, nuk është izolimi i delinkuentit nga shoqëria dhe nga obligimet dhe funksionet e tij sociale, por krijimi i kushteve që ai të inkuadrohet në to pas vuajtjes së sanksionit. Prandaj, individualizimi, institucionalizimi dhe prevencioni individual (special) janë parime të kushtëzuara ngushtësisht

---

<sup>150</sup> Muratbegoviq, op.cit. fq.127.

<sup>151</sup> Po aty.

dhe të varura reciprokisht. Ato kalojnë përmes disa procedurash në faza që, gjithashtu janë të kushtëzuara reciprokisht në aspektin funksional. Nga aspekti i prevencionit, ato faza nisen nga prevencioni i përgjithshëm që përmbahet në normën ligjore, pastaj përmes prevencionit gjyqësor që konsiston në shqiptimin e sanksionit, dhe më në fund me aplikimin e vetë sanksionit, në të cilin duhet të shprehen efektet e prevencionit individual.<sup>152</sup>

Me një fjalë, fakti që ekziston norma ligjore paraqet vetëm bazën abstrakte normative në të cilën tek do të realizohen supozimet për prevencionin individual, përmes fazës së gjykimit dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale. Që të rezultojë me efektin e rëndësishëm preventiv, ky rol i ndarë i gjykatës dhe i organit të ekzekutimit të sanksioneve penale duhet të mbështetet në individualizimin që nënkupton dy aspekte: përshtatjen e sanksionit sipas personalitetit të kryesit, veçorive dhe karakteristikave të tij psikologjike, penologjike, sociale dhe të tjera, nga një anë, dhe aplikimit të harmonizuar sipas kësaj të sanksionit penal ndaj të gjykuarit, nga ana tjetër.<sup>153</sup>

Pa marrë parasysh atë se ekzekutimi i sanksioneve penale ka pësuar ndryshime të rëndësishme në kuptimin progresiv në plan të humanizimit, efektet preventive në tërësi nuk janë evidente. Arsyet për këtë janë të shumta. Mirëpo, ato mund të kufizohen në dy faktorë rëndues: i pari është faktori i brendshëm psikologjik, që vepron në mënyrë frustuese dhe për shkak të të cilit ish i dënuari mjaft me vështirësi i përshtatet jetës në liri, përkatësisht konventave shoqërore.

Ky faktor është në lidhje të ngushtë me kushtet sociale që dalin nga rrethi shoqëror, që sipas rregullës, vepron negativisht, përkatësisht në mënyrë rënduese në gjendjen psikologjike të të dënuarit kur të gjendet në liri. Mjedisi social shfaq qëndrim diskriminues, jo vetëm ndaj të të dënuarit, por edhe ndaj personave të tij të afërm. Paragjykimet e shoqërisë ndaj atyre personave si ndaj “pacientëve të ardhshëm” të policisë, të organeve të judikaturës dhe të organeve kundërvajtëse, janë më të mëdha se tek disa organe humanitare dhe sociale ose shërbime të ngjashme. Ajo që zakonisht nuk ekziston është ndihma sociale, psikologjike, emotive, materiale e të tjera.<sup>154</sup>

---

<sup>152</sup> Muratbegović, op.cit. fq.128.

<sup>153</sup> Muratbegović, op.cit. fq.129.

<sup>154</sup> Muratbegović, op.cit. fq.131.

## **PËRFUNDIM**

Dhuna, si një fenomen mjaftë serioz dhe i shpeshtë në mbarë botën paraqitet në qendër të vëmendjes së hulumtimeve të shumta të realizuara në këtë drejtim. Edhe përkundrejt faktit që e njëjta trajtohet si një fenomen mjaftë i analizuar, por edhe në ditët e sodit vërejmë që ende dhe ndoshta kurrë nuk do të jetë i mjaftueshëm studimi dhe analizimi i këtij fenomeni kompleks dhe me pasoja shkatërruese.

Përgjatë vështrimit dhe analizimit të lëndëve penale të veprës penale të dhunimit, në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, ka rezultuar se: gjithsej në këtë gjykatë janë paraqitur njëzet (20) raste, për periudhën kohore 2014-2018. Nga gjithsej njëzet raste, sa i përket gjinisë pjesëmarrës kanë qenë vetëm gjinia mashkullore, edhe atë njëzet (20) persona të gjinisë mashkullore, dhe asnjë person i gjinisë femërore. Si rrjedhojë mund të konkludojmë se gjinia mashkullore është me pjesëmarrje më të lartë në kryerjen e veprës penale të dhunimit, ndërsa ajo femërore me pjesëmarrje zero, mund të arsyetohet me rolin dhe pozitën e femrës që ajo e mban në shoqëri, duke qenë edhe sot e kësaj dite më e diskriminuar në krahasim me gjinia mashkullore. Sa i përket subjektit pasiv, apo viktimës, të gjitha rastet kanë të bëjnë me dhunimin e femrës, që do të thotë se pjesëmarrës janë vetëm gjinia femërore me gjithsej njëzet (20) raste, dhe asnjë rast viktimë e dhunës seksuale gjinia mashkullore. Është një fakt pothuajse universal, që cak i sulmeve seksuale, janë kryesisht gjinia femërore, edhe atë jo vetëm në Maqedoni, por edhe në vendet tjera për rreth e më gjerë. Çështja e gjinive, duke u bazuar nga këto të dhëna statistikore na lë hapësirë për të diskutuar, e sidomos fakti ku kemi njëzet (20) kryerës të veprës penale të dhunimit, të gjinisë mashkullore, dhe njëzet (20) viktima të veprës penale të dhunimit, të gjinisë femërore. Për bazë marrim kufijtë nacional dhe transnacional që krimet seksuale i kanë kaluar, dhe më cak i këtyre sulmeve nuk janë vetëm femrat dhe fëmijët, por edhe meshkujt, kjo lë hapësirë që ndoshta shoqëria jonë nuk është zhveshur nga komplekset dhe traditat zakonore, dhe ende vuan nga paragjykimet dhe pëshpëritjet e të tjerëve se si do ta pranojnë një ngjarje të tillë. Jemi të vetëdijshëm, që këto të dhëna janë vetëm simbolike sa i përket veprës penale të dhunimit, numri i errët është disa herë më i madh nga ato raste të cilat janë paraqitur apo janë proceduar. Është për të ardhur keq, që ende ka persona që nuk mund të marrin guximin dhe të paraqesin në institucionet e drejtësisë një akt të shëmtuar kriminal, si ai i dhunimit. Edhe pse viktimat si

zakonisht kanë arsyet e veta për mosparaqitjen e krimit, e më së shpeshti këtu hynë mosbesimi në institucionet e drejtësisë, varësia nga kryerësi, frika nga kryerësi për veten dhe familjen e sajë, turpi etj, por prapëseprapë në asnjë mënyrë nuk arsyetohet dhe nuk përkrah mos denoncimin e këtyre veprave.

Pikërisht në kontestin e pabarazisë dhe diskriminimit ndërmjet gjinive që është nga katalizatorët e shkaktimit të dhunës seksuale, është e domosdoshme përpilimi dhe implementimi i programeve për parandalimin e dhunës seksuale mbi themelet e barazisë gjinore, programe të cilat mund të përmbajnë transformime pozitive afatgjate të relacioneve në mes të gjinive brenda bashkësisë. Këto programe gjithashtu duhet domosdoshmërisht të posedojnë edhe plane veprimi konkrete me aksione edukuese preventive që potencialisht kontribuojnë në zvogëlimin dhe zhdukjen e zakoneve të dëmshme tradicionale, siç jemi mësuar t'i shohim ende në disa zona, që lidhen drejtpërdrejtë me të drejtat e njeriut.

Mosha, edhe në këtë drejtim, gjatë kërkimeve empirike, nga të dhënat statistikore vërehet se cila grup-moshë është më aktive në kryerjen e veprës penale që bien në domenin e veprave penale të dhunimit. Siç është e ditur, mosha e kryerësve të veprës penale, mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Sipas kësaj të fundit, në shumë vende të botës, mosha e kryerësve të veprës penale, në aspektin gjeneral ndahet në moshë të personave të mitur (të mitur të rinj 14-16 vjeç, të mitur të rritur 16-18 vjeç) dhe personave të rritur konsiderohet mosha nga 18 vjet e deri në vdekje të individit. Gjatë analizës kemi marrë për bazë moshën e personave të rritur, pasi që ajo e të miturve nuk ishte cak i hulumtimit të kësaj teze, por edhe gjatë analizimit të dosjeve penale nuk kishte raste të shënuara. Në kategorizimin e grup-moshave, si grup-moshë më të ulët kamë marrë moshën prej 20-25 vjet ku pjesëmarrës të kësaj grup-moshe ka pasur vetëm një (1) person, grup-mosha prej 25-30 vjet është pjesëmarrëse me tre (3) persona, si grup-mosha me pjesëmarrje më të lartë janë grup-moshat prej 30-40 vjet dhe 40-50 vjet, edhe atë 30-40 vjet janë përfshirë gjashtë (6) persona, 40-50 vjet janë përfshirë shtatë (7) persona. Grup-moshat mbi 60 vjet është përfshirë vetëm me një person. Nga këto të dhëna, kemi ardhur në përfundim se mosha prej 30-40 vjet dhe ajo prej 40-50 vjet, është mosha më aktive dhe e inkriminuar në veprat penale të dhunimit. Sepse është në fakt grupi i popullatës më aktive në jetën e përditshme në shoqërinë e territorit të Gjykatës së Apelit në Gostivar, andaj, lirisht mund të themi se kjo grup-moshë është më aktive në çdo shoqëri. Për këtë arsye ata vijnë në situata më të shpeshta për të qenë të

inkriminuar në vepra penale të ndryshme, përfshirë edhe veprat penale që bien në domenin e veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor.

Duke qenë një nga fenomenet tejet kompleks i përmasave gjigante nga natyra e llojit të vet, parandalimi apo ndërhyrjet për të kuruar këtë fenomen janë sa individuale aq edhe të përgjithshme. Sepse reagimi ndaj dhunës seksuale, para së gjithash drejtohet në adresë të individit, relacionet e afërta të tij, ndërvarësia me bashkësinë/komunitetin dhe shoqëria në përgjithësi. Dhuna seksuale është një akt individual me pasoja më shumë kolektive sepse pasojat i vuan në mënyrë të tmerrshme jo vetëm viktimën, por edhe familja e viktimës si dhe e kryerësit të veprës gjithashtu. Kur jemi te individualiteti, përdhunuesi tipik as nuk gjendet as nuk mund të përshkruhet me tipare të veçanta sipas të cilit ai mund të identifikohet, me fjalë të tjera ai person është në mes njerëzve dhe nuk ka shenja ose tipare specifike që mund t'i drejtohet gishti se ai është kryerës i veprës penale të dhunimit, prandaj përfundimi i nxjerrë që përdhunuesi i mundshëm (potencial) përgjithësisht nuk identifikohet në shikim të parë dhe nuk ka parametra bazikë për ta identifikuar me saktësi të plotë.

Përdhunuesi është në mesin tonë, është një person që rri mes nesh, shoqërohet me ne, socializohet me ne dhe është pjesë e përditshmërisë sonë ndaj edhe me të drejtë thuhet që shumica e veprave penale të dhunës seksuale janë kryer nga dikush, që viktimën i njeh. Se sa janë pjesë integrale e shoqërisë dhe sa afër ndodhen kryerësit e veprës penale të dhunimit vërteton se nganjëherë kryerësit e veprës janë po ata, nga të cilët, viktimat varen për ndihma dhe mbrojtje.

Nga hulumtimi i bërë, nga analiza e bërë rasteve që kanë ndodhur në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar ka rezultuar se nga të gjitha njëzet (20) rastet, në po të gjitha kryerësi dhe viktimën janë njohur që më parë. Vlen të përmenden që bukur mirë janë të pranishme rastet ku kryerësi dhe viktimën kanë qenë në lidhje dashurie, e po këto raste janë mu ato që më së shumti keqpërdoren nga ana e viktimës për ta përdorur rastin në favor të vet, duke bërë denoncime të rrejshme apo duke përgënjeshtuar ngjarjen me të vetmin qëllim të kërcënoj kryerësin që ti ofrojë martesë viktimës. Gjithsesi, nga kjo analizë vijmë në përfundim se në të shumtën e rasteve, në pjesën dërmuese të tyre kryerësi ka njohur viktimën e tij paraprakisht, rrjedhimisht del se kryerësi ka një pasqyrë paraprake në lidhje me vetitë dhe cilësitë e viktimës dhe të njëjtat i shfrytëzon në favor të tij drejt realizimit të qëllimit final që ka.

Burime të shumta e definojnë dhunën seksuale apo përdhunimin si formë e arritjes së kënaqësisë që e realizon kryerësi i veprës pa pëlqimin e viktimës dhe deri diku pothuajse të gjithë definicionet sillen rreth boshtit të marrjes apo mosmarrjes së pëlqimit nga viktimja për kryerjen e aktit seksual. Pavarësisht pëlqimit, qëllimi parësor i kryerësit të veprës mbetet shprehja e dominimit dhe fuqisë mbi personin e sulmuar. Në përfundim të kësaj analize, parë në kuadër të përgjithshëm krahasues, arrijmë në konkluzion që, legjislacioni i Republikës së Maqedonisë mbi krimet seksuale është një legjislacion modern në harmonizim me kërkesat dhe nevojat e kohës bashkëkohore, dhe në linjë me legjislacionet e analizuara në këtë punim të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës.

Dhuna seksuale dhe/apo kryerja e veprës penale të dhunimit/përdhunimit në kontekstin maqedonas, respektivisht shikuar në prizmin e këtij hulumtimi, që është trajtuar kjo dukuri shoqërore, fatkeqësisht akoma shihet në kornizën e trajtimit si një çështje tabu, dhe kjo për faktin e thjeshtë, sepse mendohet që numri i çështjeve të mos-raportuara nuk është i vogël, por ka edhe prej tyre që për arsye të tyre nuk pranojnë të dokumentojnë rastin dhe çështja prapëseprapë mbyllet heshtazi. Për rrjedhojë të dhënat apo statistikave dallojnë me një marzhë pasaktësie që jo vetëm në kontestin e kësaj pune kërkimore mbi dhunën seksuale dhe/apo shkaktimi i veprës penale të dhunimit/përdhunimit në territorin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, por edhe në kontekstin maqedonas në përgjithësi, shifrat e paraqitura të kësaj kategorie janë vetëm për rastet e raportuara dhe të proceduara sipas legjislacionit të vendit, sepse realisht të dhëna që ekzistojnë (të dokumentuara), nuk paraqesin shifrën reale të shtrirjes (ekzistencës) së kësaj dukurie kriminale në shoqërinë tonë, mirëpo, duhet pranuar se mos raportimi ndodh në çdo shoqëri madje edhe në shoqëritë me zhvillim të lartë ekonomik e shoqëror.

Nëse shikohet struktura e veprave penale të dhunimit të kryera në harkun kohor 2014-2018 në rrethin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, sipas statistikave prin viti 2016 me shtatë (7) raste, më pas viti 2018 pesë (5) raste viti 2014 dhe 2015 me nga tre (3) raste, dhe me numër më të ulët është viti 2017 vetëm me dy (2) raste.

Ndërsa, struktura e veprave penale të dhunimit të kryera në po të njëjtën periudhë, në nivel republikan, pra në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, sipas statistikave prin viti 2015 me pesëdhjetë e gjashtë (56) raste, viti 2014 me dyzet e nëntë (49) raste dhe më pak raste të shënuara në vitin 2017 tridhjetë e tetë (38) raste.

Gjykata e Apelit në Gostivar, është gjykatë e shkallës së dytë, apo thënë ndryshe katalizator i vendimeve të gjykatave themelore, Gjykata e Apelit mbulon disa gjykata themelore, apo është kompetente për një territor më të gjerë krahasuar me ato të gjykatave themelore. Në këtë rast Gjykata e Apelit në Gostivar, është kompetente për gjykatën themelore në Gostivar, gjykatën themelore në Tetovë, gjykatën themelore në Kërçovë dhe gjykatën themelore në Dibër. Për këtë arsye, duke pasur parasysh që Republika e Maqedonisë është një shtet multi-etnik, edhe në këto vende që u cekën më lartë popullsia e tyre është e përbërë nga një mozaik nacionalitetesh, në këtë punim magjistrature i'u është kushtuar një analizë edhe nacionalitetit të kryerësve, apo përkatësisë etnike, sipas të dhënave statistikore rezulton se: nëntë (9) persona që kanë qenë të inkriminuar kanë qenë të nacionalitetit shqiptar, gjashtë (6) persona të komunitetit rom, tre (3) persona të komunitetit turk, dhe dy (2) persona të nacionalitetit maqedonas. Prania më e madhe e nacionalitetit shqiptar, mund të arsyetohet me numrin më të lartë të popullsisë që jetojnë në këto vise, por çdoherë duke ruajtur objektivitetin e këtij punimi dhe duke qëndruar larg toneve diskriminuese.

Gjatë punës kërkimore, jemi fokusuar edhe te përgatitja shkollore e kryerësve të veprës penale të dhunimit, ku ka rezultuar se: tre (3) persona kanë qenë analfabet, shtatë (7) persona kanë pasur të kryer arsimin fillor, katër (4) persona kanë pasur të kryer arsimin e mesëm dhe vetëm një (1) person ka pasur të kryer arsimin e lartë/fakultet. Është e konstatuar se brezi dominant është i atyre që kanë të kryer shkollën fillore dhe të mesme me pjesëmarrje të gjithsej njëmbëdhjetë (11) persona. Nga kjo mund të konkludojmë se janë të rrallë personat me arsim të lartë që kryejnë vepra penale të kësaj natyre, këtë konstatim e vërtetojnë edhe hulumtimet dhe kërkimet empirike që janë kryer në vendet e ndryshme botërore. Kësisoj pasqyrohet se edhe në rrethin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, numrin më të madh të veprave penale të dhunimit e kryejnë personat me arsim të ulët (fillor dhe të mesëm) dhe në anën tjetër janë të rrallë personat me arsim të lartë që kryejnë vepra penale dhe në përgjithësi të prirë për kriminalitet seksual.

Qasja ndaj fenomenit kompleks të dhunës seksuale, duhet të jetë me patjetër multipreventive duke angazhuar direkt edhe liderët apo personalitete me reputacion në komunitet përmes mesazheve të drejtuara kah bashkësia specifike, duke përfshirë në mënyrë direkte femrat,



meshkujt, rininë, fëmijët, grupacionet fetare, shkollat, punonjësit arsimorë, njerëzit afaristë e të tjerë.

Fushatat vetëdijësuese janë themeli i preventivës ndaj çdo fenomeni qoftë, edhe i përmasave siç është dhuna seksuale, përdhunimi, apo fenomene të tjera të natyrave të ngjashme apo të ndryshme. Në rastin konkret, fushata vetëdijësuese duhet të jetë e mbështetur në themelet në sferën e arsimit dhe edukimit seksual që të mundësojë të rinjve të marrin informata relevante, njohuri dhe aftësi se si të ballafaqohen dhe të avancojnë shëndetin e tyre seksual dhe reprodutiv; t'i respektojnë dallimet; të informohen për të drejtat e tyre seksuale dhe reprodutive; t'i rrënojnë mitet dhe stereotipat; të jenë të gatshëm për marrëdhënie dhe lidhje seksuale, emotive, pa dhunë dhe keqpërdorim dhe t'i angazhojnë për barazi gjinore.

Në kontestin e gamës që përfshin ky punim magjistrature, theks i veçantë bie mbi sanksionin penal të paraparë për veprën penale të dhunimit, përgjatë gjithë hulumtimeve dhe analizave që i kamë bërë për këtë punim kërkimor, veçanti i është kushtuar analizës specifike të vendimeve gjyqësore, në pjesën e sanksionit penal për çdo rast veç e veç.

Nga analizimi dhe hulumtimi i dosjeve penale, në Gjykatën e Apelit në Gostivar në periudhën kohore 2014-2018, rezulton se: gjykatat themelore kanë marrë vendim apo shqiptuar njëmbëdhjetë (11) aktgjykime dënuese, dhe nëntë (9) aktgjykime liruese. Gjykata e Apelit në Gostivar si gjykatë e shkallës së dytë, për vendimet e gjykatës së shkallës së parë apo vendimet e goditura me ankesë, rezulton se: në trembëdhjetë (13) raste ka refuzuar ankesën si të pabazë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, në pesë (5) raste ka pranuar ankesën dhe aktgjykimi i shkallës së parë është kthyer në rigjykim, dhe në dy (2) raste ka pranuar ankesën dhe vetë gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë. Ajo që mund të them nga analizimi i dosjeve penale dhe vendimeve gjyqësore, është që sanksionet penale ishin nga më të ndryshmet, dhe ndryshojnë në numra të ndryshëm. Dënimet më të shpeshta ishin ato të ulëta, me një (1) vjet e gjashtë (6) muaj burgim, apo një (1) vjet e tetë (8) muaj burgim, si dënime më të larta kam hasur dënimin me burgim tre (3) vjet burgim për një rast dhe më i larti ishte rasti me pesë (5) vjet burgim. Sanksioni më specifik ishte ai i masës së sigurisë, ku gjykata kishte shqiptuar sanksionin Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor. Në bazë të këtyre të dhënave mund të përfundojmë që dënimet janë relativisht të ulëta, edhe përkundër faktit që në Kodin Penal minimumi për këtë veprë penale është tre (3) vjet, por

gjithsesi duhet të kemi parasysh faktin që legjislacioni penal ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme gjatë decenieve të fundit, dhe fakt tjetër i pamohueshëm është që asnjë rast nuk është identik me tjetrin, por gjykata në bazë të bindjes së lirë dhe çdoherë duke u bazuar në fakte dhe prova relevante ka marrë vendim për secilin rast në veçanti, duke shfrytëzuar një sërë parimesh dhe duke çuar në vend atë që thotë ligji. Kur është fjala për kryerësin, është plotësisht e sigurtë se efektet preventive të sanksionit nuk realizohen me aplikimin e tij abstrakt, por ajo do të bazohet në individualizimin dhe në ndërmarrjen e masave të caktuara, me qëllim të rehabilitimit sa më të suksesshëm social, të masave dhe të veprimeve të ndryshme mjekësore, psikologjike, pedagogjike, në mënyrë që të gjitha këto të harmonizuara reciprokisht të zvogëlonin mundësinë që personi ndaj të cilit aplikohen masat të kryejë vepra të reja. Parimi i prevencionit individual përcakton që të aplikohet individualizimi i procedurës sipas të të dënuarit me rastin e aplikimit të sanksionit, e në pajtim me karakteristikat e personalitetit, që në këtë rast duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë të kaluarës kriminale të tij, në mënyrë që të realizohet kështu efekti preventiv sa më i plotë që është i mundur.

Vetë akti i dhunimit seksual është një akt tejet kompleks, që ngërthen një rrjet pasojash me përmasa të mëdha, andaj, edhe qasja ndaj këtij fenomeni dhe luftimi i po të njëjtit kërkon një zhytje të thellë për t'iu qasur problemit. Së pari, për të luftuar parandalimin e krimeve të dhunës seksuale është mjaftë e rëndësishme zbulimi dhe gjetja e faktorëve kriminogjen që ndikojnë në përhapjen dhe shkaktimin e këtyre krimeve, siç është fjala për faktorët ekonomik, social, kulturor e shumë të tjerë jo më pak të rëndësishëm. Në plan kombëtar, duhet të hartohen ligje për një rigorozitet më të madh sa i përket përcaktimit dhe parashikimit të krimeve të dhunës seksuale, duke parashikuar dënime më të larta, e sidomos për kryerësit të cilët ndeshen disa herë me kryerjen e kësaj vepre penale. Theks të veçantë, në luftimin dhe parandalimin e dhunës seksuale, është dhe nevoja për një ndihmë më efikase dhe më gjithëpërfshirëse viktimave të dhunës seksuale, duke u nisur që nga ajo financiare, e më e rëndësishmja ndihmë psikologjike dhe morale viktimave të dhunës seksuale, pasi që këto dy të fundit janë më të rëndat dhe rrallë herë arrihen të rikuperohen tek viktimat.

Organet e drejtësisë, duke filluar që nga policia e shtetit, prokuroria publike e deri tek gjykatat, janë aktorët kryesor për të parandaluar dhe luftuar krimet e dhunës seksuale, e sidomos edhe për

të ndëshkuar kryerësit e një akti të tmerrshëm, si ai i dhunës seksuale, andaj, rezultatet do të arrihen vetëm atëherë kur këto organe do ti qasen rastit me zero tolerancë, duke mos diskriminuar dhe nën vlerësuar asnjë rast që është goditur me dhunë seksuale, me këtë do të arrihej si prevencioni individual po ashtu edhe ai gjeneral. Jo më pak e rëndësishme është edhe faza e ekzekutimit të sanksionit penal, ku këto institucione duhet të bëjnë çmos, që kryerësi të arrij risocializimin e tij, e jo të luajnë rolin e vatrave kriminale.

Megjithatë, kjo qasje duhet të formësohet drejt krijimit të një strategjie kombëtare në forcimin dhe vetëdijesimin e shoqërisë në parandalimin e dhunës seksuale.

## LITERATURA

### I. Libra, komentar dhe artikuj

Abzaovič, Mirsad, Elmedin, Halilović, Haris, Budimlić, Muhamed, dhe Beqirevič, Edina, “Politika e luftimit të kriminalitetit”, Sarajevë/ Prishtinë 2006 FSK/S – 09/06.

Ajzenber (Einsenberg, N.) dhe Lenon (Lennon, R.), 1983. Sex differences in empathy and related capacities. Psychological Bulletin, 94, 100-131.

Vesel, Latifi, Kriminalistika, Prishtinë 2014.

Siegel, J.L., “Criminology Thomson Learning”, Belmont (USA), 2006, sipas Šabani, Alisabri, Budimlić, Muhamed, Kriminologjia, (Përktheu nga kroatishtja Mustafë Reçica) Sarajevë/Prishtinë, 2007.

Muratbegović, Elmedin, Parandalimi i kriminalitetit (Compendium of Crime Prevention and Crime Control), Sarajevë/Prishtinë, 2007.

Korjalič, Neđad, Metodika kriminalistike (deliktet e gjakut, seksuale, pasurore) Sarajevë/Prishtinë, FSK/S-15/06, 2007.

Brownmiller S., Against our will. Men, women and rape. Ballantine Publishing group, 1975.

Malmuth M., Rape proclivity among males, in Jurnal of social issues, volume 57, no. 4, 1981.

Zejneli, Ismail, E drejta penale- Pjesa e posaçme, Tetovë, 2007.

Surdulli, Zejnullah, Studime të doktoratës, “Vepra penale e dhunimit në territorin e Gjykatës themelore në Gjilan 2004-2013”, 2018.

Salihu, Ismet, E drejta penale- Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009.

Cipi, Bardhyl, dhe Meksi, Sokrat, Mjekësia Ligjore, Tiranë, 2005.

Petrovič, Borisllav, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, FSK/S-14/06.

Osmani, Afrim, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, (Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik) Shkup, 2010.

- Stankovič, Nedjelko, Krivično pravo- Posebni dio, Brčko, 2017.
- Kambovski, Vllado, E drejta penale-Pjesa e përgjithëshme, Shkup, 2010.
- Baçiq, dr Frawo, E drejta penale- Pjesa e përgjithëshme, Shkup.
- Salihu, Ismet, Zhitia, Hilmi, Hasani, Fejzullah, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, botimi i parë, Prishtinë, mars 2014.
- Gssin R., Criminologie, Paris, 1996.
- Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2007.
- Josepf F., Criminology, Wadsworth-Belmont, 2000.
- Ignjatovič, Đ. Bekarijine ideje o krivičnom pravu, Arhiv, Beograd, 1998, nr.4., Kriminologjia, Beograd, 2001.
- Begeja, Skender, Kriminalistika, Tiranë, 1997.
- Halili, Ragip, Viktimologjia, Prishtinë, 2011.
- Dragoti, Edmond, "Psikologjia sociale", Ribotim, Tiranë, 2012.
- Ramadani, Agim, dhe Hoxha, Sabri, Mjekësia Ligjore, Tetovë, 2015.
- Lazarevič, LJ., "Legjislacioni penal si bazë për konstituimin e politikës së luftimit të kriminalitetit", "Judikatura penale si Bazë Konstituimin e Politikës së Luftimit të Kriminalitetit", "Informatori Juridik", nr.10, "Intermex", Beograd, 2003.
- Krivokapič, V., "Preventiva e Kriminalitetit"- qasje teorike kriminalistike, FSHK, Sarajevë, 2006.
- Krivokapič, V., "Preventiva e Kriminalitetit"- „Akademia Policore“, Beograd, 2002.
- Mladenovič, 'Kupečević, R.: "Kriminologjia"- "Svjetlost", Sarajevë, 1982.

Budimlić, M., „Aktualiteti i hulumtimeve, kriminologjike në parandalimin e formave të reja të sjelljes kriminale”, Tema Kriminalistike, Revista e kriminalistikës, kriminologjisë, dhe studime për sigurinë, nr. 3-4, FSHK, Sarajevë, 2004.

Stojanović, Z., „Politika e luftimit të kriminalitetit”, Novi Sad, 1991.

Morgan, R., Newburn, T.: The future of Policing, Oxford, 1997., marrë nga Ignjatović, GJ., “Kriminologjia”, J.P. “Fleta Zyrtare”, Beograd, 2005.

Omari, Luan, Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese, botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2011.

Zejneli, Ismail, dhe Sahiti, Ejup, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017.

Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, Shkup, 2015.

Militinović, Milan.,:”Politika Kriminalistike”-“Savremena administracija”, Beograd, 1984.

Sahiti, Ejup, Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë, 2007.

Jonathan, Herring, “E drejta penale- Teori, kazuse dhe materiale” me parathënie nga Ngjela, Spartak, botimi V, Tiranë, 2013.

Kambovski, Vllado dhe Zejneli, Ismail, E drejta penale (e përgjithëshme), Tetovë, 2018.

Zejneli, Ismail, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018.

## **II. Kushtetuta, ligje dhe dokumente ndërkombëtare**

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 17 nëntor 1991/11 janar 2019 (amendamentet XXXIII, XXXIV, dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë).

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 142, datë 13.11.2012/10.11.2015, Kreu XIX –“Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor”.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, (i përditësuar) janar 2016, Seksioni VI-“Krime Seksuale”.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Prishtinë, 2013.

Ligji për Policinë i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.114/06/148/08, mars 2015.

Ligji për Prokurorinë Publike i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.111, datë 03.09.2008.

Ligji për Gjykatat i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.58/2006, 35/2008, 15/10, 83/18, dhe 198/18, datë 17.05.2019.

Ligji për Procedurën Penale i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.150, datë 18.11.2010.

Ligji për Ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 08-752/1, datë 30.01.2018.

Deklarata universale e të drejtave të njeriut, e aprovuar nga Ansambleja e Përgjithëshme e OKB’së, dhjetorë 1948.

Deklarata për të Drejtat e Gruas dhe Qytetares Femër, 1798.

Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Akademia e Shkencave Republika e Shqipërisë, Tiranë, 2006.

Protokoll i përbashkët në raste të dhunës në familje, Republika e Maqedonisë.

\*Të dhëna zyrtare, të marra dhe të dorëzuara, nga Gjykata e Apelit në Gostivar, më datë 02.09.2019/03.09.2019.

### **III. Burime tjera**

Ahmed EM. Violence against women: the legal system and institutional responses. Lahore, AGHS Legal Aid Cell, 1998.

Crowell NA, Burgess AW, eds. Understanding violence against women. Washington, DC, National Academy Press, 1996.

Dickson N et al. First sexual intercourse: age, coercion, and later regrets reported by a birth cohort. *British Medical Journal*, 1998, 316:29–33.

Drieschner K, Lange A. A review of cognitive factors in the aetiology of rape: theories, empirical studies and implications. *Clinical Psychology Review*, 1999, 19:57–77.

Grisso JA et al. Violent injuries among women in an urban area. *New England Journal of Medicine*, 1999, 341:1899–1905.

Heise L. Violence against women: the missing agenda. In: Koblinsky M, Timyan J, Gay J, eds. *The health of women: a global perspective*. Boulder, CO, Westview Press, 1993.

Jewkes R, Penn-Kekana L, Levin J. Risk factors for domestic violence: findings from a South African cross-sectional study. *Social Science and Medicine* (in press).

Kelly L, Radford J. Sexual violence against women and girls: an approach to an international overview. In: Dobash E, Dobash R, eds. *Rethinking violence against women*. London, Sage, 1998.

Kilpatrick DG, Edmonds CN, Seymour AK. *Rape in America: a report to the nation*. Arlington, VA, National Victim Center, 1992.

Mehrotra A et al. *A life free of violence: it's our right*. New York, NY, United Nations Development Fund for Women, 2000.



Omaar R, de Eaal A. Crimes without punishment: sexual harassment and violence against female students in schools and universities in Africa. African Rights, July 1994 (Discussion Paper No. 4).

Risberg G, Lundgren E, Westman G. Prevalence of sexualized violence among women: a populationbased study in a primary healthcare district Scandinavian Journal of Public Health, 1999, 27:247–253

Rozee PD. Forbidden or forgiven? Rape in crosscultural perspective. Psychology of Women Quarterly, 1993, 17:499–514.

Schwartz IL. Sexual violence against women: prevalence, consequences, societal factors and prevention. American Journal of Preventive Medicine, 1991, 7:363–373.

Sexual and gender-based violence programme in Guinea. Geneva, Office of the United Nations High Commissioner for Refugees, 2001.

Sierra Leone: rape and other forms of sexual violence against girls and women. London, Amnesty International, 2000

[www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)

#### **IV. SHKURTESAT**

KPRM- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë.

KPRSH- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

KPRK- Kodi Penal i Republikës së Kosovës

LPPM- Ligji i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë

LGJRM- Ligji mbi Gjykata i Republikës së Maqedonisë

LPP- Ligji i Procedurës Penale

LP- Ligji Penal

MBP- Ministria e Punëve të Brendëshme e Republikës së Maqedonisë

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

RM- Republika e Maqedonisë